

Blerina Rogova Gaxha (1982) është poete, eseiste, studiuese e letërsisë dhe hulumtuese e rrymave kulturore. Është diplomuar në Universitetin e Prishtinës dhe ka PhD në shkencat letrare. Është laureate e Çmimit Ndërkombëtar për letërsinë 'Crystal Vilenica Award 2015' në Slloveni, dhe e Çmimeve Kombëtare për Veprën më të mirë Poetike për vitin 2020 dhe veprën më të mirë në Kritikë letrare dhe Eseistikë në vitin 2021, të ndarë nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës. Libri i saj i fundit, "Memorie dhe Traumë, kujtesa e luftës 1998-1999 në letërsinë shqipe në Kosovë" është tema kryesore e kësaj bisede.

## BLERINA ROGOVA GAXHA

Një testament i ri letrar,  
drejt një autori  
që kujton dhe rrëfen

Bisedoi **Andreas Dushi**



foto: Ridvan Slivova ©

## PSE LETËRSIA JONË PËR FËMIJË ËSHTË ENDE NDËRGJEGJJA JONË E PIKËLLUAR?

Nga **Anton Nikë Berisha** (fq. 6)

## INDRIT HAMITI, ARKITEKTI I GODINAVE IKONIKE!

Dr. **Bledar Kurti** (fq. 20)

## SHËNIME MBI LIBRAT

"Alipashaida" e Irakli Koçollarit  
NJË BOTIM I ÇMUAR  
PËR KULTURËN DHE  
HISTORINË TONË

Nga **Shpendi Topollaj** (fq. 5)

"Vikama e tingullit", kujtimet e Vera Ibrahimit  
VIKAMA E TINGULLIT – NJË  
KRESHENDO DASHURIE

Nga **Leonard Qyteza** (fq. 13)


"Lindur së prapthi" i Rita Petros"

PËR TË PRISHUR  
MAGJITË E SHOQËRISË

Nga **Mërgim Bekteshi** (fq. 9)

"Dritarja e Marin Shkrelit" i Ndue Ukajt  
NJË MIMESIS  
I FUQISHËM I KUJTESËS

Nga **Elsa Skënderi** (fq. 18)



## DASMA DARDHARE NË VËSHTRIMIN E PROFESOR ALBERT DOJËS

Nga **Zhuljeta Kadilli** (fq. 10)

Shënime për botimin në anglisht të librit  
"Kur sunduesit grinden"

## SHTËPIA E PASOYRAVE TË KADARESË: ANKTHET E NJË TITANI LETRAR

Nga **Bronwyn Scott-McCharen**

Përktheu: **Granit Zela** (fq. 22)



## In memoriam ADEM GASHI

U përudh tue e lanë veten  
t'strehuem mirë nëpër  
poezitë e tij

Nga **Vlora Ademi**

Thonë se poetët parandjejnë. Sikurse ia kishte dallue n'fytër ikjen e tij, miku tij, Primoja. E kishte pa me shumë vërejte, n'festë dhe mbas feste m'tha: Ia kam pa një vijë të verdhë Ademit sonte, si asnjherë ma parë.

(fq. 8)

## BIBLIOTEKË

— Shqiptar Oseku (fq. 19)

*Kung fu Lona*

— Arbër Selmani (fq. 14)

*E premtë, sulm në zemër*

— Klara Kodra (fq. 15)

*Këngë apo elegji?*

— Adem Gashi (fq. 14)

*Me të dashtë*

— Rudolf Marku (fq. 16)

*Kam lindur në brigje homerike*

— Shpresa Qeriqi (fq. 23)

*Ah*

— W. H. Auden (fq. 18)

*I shtator 1939*

— Ballsor Hoxha (fq. 17)

*Coha e kaltër në baule*

BOTOHET NË ARABISHT  
ROMANI "DËMTUAR  
GJATË RRUGËS"  
I BESNIK MUSTAJ

Nga **Fatrit Beqiri** (fq. 12)

*Ka pak që ka dalë për lexuesit dhe studiuesit libri juaj "Memorie dhe Traumë, kujtesa e luftës 1998-1999 në letërsinë shqipe në Kosovë". Ai fillon me një kapitull të titulluar "Letërsia si dëshmi". Nga një optikë e gjerë prej studiueseje letërsie, jo vetëm duke u ndalur te ky libër, a i shërben letërsisë si shprehje artistike bashkimi ose njësimi me dëshminë?*

Konceptin e letërsisë si dëshmi nuk mund ta trajtojmë të kufizuar në qasjen puriste letrare, por duke e vënë në kontekst të studimeve interdisiplinare dhe kulturore. Letërsia si dëshmi i referohet kryesisht letërsisë si medium i kujtesës kulturore dhe peshës së artit të fjalës për ta transmetuar dhe qarkulluar memorien kolektive, qoftë kjo brenda studimeve kulturore të Memories e qoftë përbrenda studimeve letrare. *Memorie dhe Traumë: Kujtesa e luftës 1998-1999 në letërsinë shqipe në Kosovë* sugjeron të vërtetat e luftës, dëshmitë, për të vetmën arsye se atë që e bën letërsia, s'e bën dot historia, dhe sepse lufta e ka më se të nevojshme kujtesën fiktive, interpretimin shpirtëror dhe emocional. Si rrjedhojë, autori i letrave në Kosovë, përveç se krijues, ai është autor/dëshmitar, autor/narrator, autor/personazh, lufta pra, duke qenë reale e jo një projekcion fiksional, e përjetuar dhe jo e vëzhguar, shndërrohet në fakt autorial e tekst autoreferencial, si në lirikë ashtu edhe në zhanret ku dominon autobiografizmi e dokumentariteti. Grisja e pëlhurës së shkrimit letrar të dëshmisë së këtij fillimshkulli, kthen vëmendjen kah një *testament i ri letrar* dhe një poetikë me paradigme historinë e të vërtetën e saj dhe drejt një autori që *kujton dhe rrëfen*. Një metanarrativë, rrëfim mbi rrëfimet e përvojës dhe kuptimit të luftës. Nga kjo perspektivë, besoj, se studimi dhe kthimi drejt këtij testamenti të ri letrar, është borxhi im personal karshi borxhit të madh kolektiv, i cili na mbyl nëse e harrojmë, ndaj kjo vepër fton që të kujtojmë, të mos harrojmë.

*Është shumë interesant titulli i librit. Përmban dy fjalë, memorie dhe traumë. Ju i përkisni asaj pale e cila e fitoi luftën. Kjo, natyrshëm mendoj, do të sillte një letërsi fitimtare, jo traumatike, por në rastin e Kosovës, ndodh ndryshe. Pse mendoni se mes traumës dhe triumfit, më shumë gjurmë ka lënë trauma në memorien kolektive?*

Veprat e zgjedhura për analizë dhe interpretim flasin për ekzistencën, jo për rezistencën. Qasja ime është

Blerina Rogova Gaxha (1982) është poete, eseiste, studiuese e letërsisë dhe hulumtuese e rrymave kulturore. Është diplomuar në Universitetin e Prishtinës dhe ka PhD në shkencat letrare. Është laureate e Çmimit Ndërkombëtar për letërsinë 'Crystal Vilenica Award 2015' në Slloveni, dhe e Çmimeve Kombëtare për Veprën më të mirë Poetike për vitin 2020 dhe veprën më të mirë në Kritikë letrare dhe Eseistikë në vitin 2021, të ndarë nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës. Libri i saj i fundit, "Memorie dhe Traumë, kujtesa e luftës 1998-1999 në letërsinë shqipe në Kosovë" është tema kryesore e kësaj bisede.


## BLERINA ROGOVA

# Një testament i ri letrar, drejt një autori që kujton dhe rrëfen

Bisedoi Andreas Dushi

jashtë të gjitha ideologemave nacionale, për të ndjekur e mbrojtur vetëm vlerën estetike. Derisa lufta vazhdon jetën e saj, edhe letërsia bën jetën e vet të pavaruar. Truri poetik ka regjistruar kryqëzimin e madh historik në Kosovë në vitet e 90-ta: represionin politik, social e ekonomik, luftën, lirinë, tranzicionin - kryqëzimet e mëdha nuk mund të mos e bartin efektin e vet edhe në letërsi. Viti 1999 ndryshoi rrjedhën historike të Kosovës, dhe shënoi

triumfin përmbi okupimin e gjatë të Serbisë, por taksa e këtij populli ishte tejet e lartë, u pagua shtrenjt. Lufta shkatërron, rrënon një jetë të tërë - si mund ta pretendojmë të shkuarën nëse jo nëpërmjet rrëfimeve? Shkrimtarët e kapin të vërtetën në thelb, në palcë, dhe jo rezultatet finale të saj. I dalë nga lufta, njeriu i Kosovës ishte i dërrmuar, i mundur fizikisht, shpirtërisht, ekonomikisht, i përhumur, dhe letërsia kapi këtë esencë - të vërtetën e gjuhës së



traumës, të vërtetën e plagës së kullon. Si studiuese, nuk pretendoja një poetikë të letërsisë së luftës, as filozofi mbi artin e dhimbjes, synimi im ishte trashëgimia letrare e luftës dhe një qasje autentike ndaj letërsisë që doli nga mitra e luftës, krejtësisht e munguar në studimet tona letrare.

*Sa herë kam lexuar letërsi bashkëkohore shqipe të shkruar nga autorë që jetojnë në Kosovë, ku trajtohet tematika e luftës, më ka çuditur josimetria mes rrëfimit të luftës në personazhet e tyre dhe monumenteve e busteve të heronjëve kudo në Kosovë. Prespektiva e personazheve është ashtu sikurse e diskutuam pak më lart, traumatike, ndërsa ajo e busteve dhe shtatoreve, krejt tjetër. Të dyja janë forma arti që rrëfjen luftën, po pse ndodh ky ndryshim kaq i madh në rrëfim?*

Në shoqërinë e pasluftës në Kosovë ka dominuar narrativa heroike e luftës. Kosova është e mbushur gjithandej me momumente të heronjëve, buste e pllaka përkujtimore, të cilat kuptohet se e kanë dhe e meritojnë vendin e vet, por kjo është vetëm një pamje e luftës - numri i viktimave civile të luftës është tejet më i lartë, por mungojnë hapësirat apo monumentet e memorizimit të fëmijëve, grave, burrave e pleqve të vrarë në mënyrë brutale apo të zhdukur me dhunë. Memorizimi dhe memorializimi i luftës në Kosovë, ka rrugë dhe forma të ndryshme, letërsia është një nga ato, por mediumi më i fuqishëm dhe më monumental. Heroizmi i busteve dhe shtatoreve është makiazhi metaforik i një shoqërie post-traumatike; grimosja e fytyrës së njeriut të shkatërruar, të rrënuar, letërsia ndërkaq nuk e zbukuron vdekjen, pos që portretin fytyrën reale të saj.

*Qasjet teorike i ilustroni, fillimisht me disa poezi të Xhevdet Barjajt. Pse*



*pikërisht me të? Çfarë të veçante ka poezia e tij e zbërthyer sipas leximit të propozuar nga ju?*

Në këndështrimin tim, Bajraj është poeti ikonë i poezisë së luftës dhe i pasojës së saj në shoqëri, e poashtu poezia e tij bëhet model i transformimit të katastrofës në krijimtari. Toni pikëllues i imagjinatës poetike është i përhershëm në poezinë e tij të pasluftës; ai është vaji i Bajrajt për fatin individual dhe fatin e njeriut të Kosovës në luftë, thelbi i një poezie që mbërthen konceptin e shtëpisë, vatrës, mërgimit, kujtimit dhe traumës. Vargjet në poezinë e Bajrajt janë kryesisht të errëta, ato dëftojnë vdekjen në atdhe, sepse atdheu që la pas ishte në luftë dhe digjej. Drama lirike e autorit, e shtresuar me mjeshtri, shpreh kështu revoltën e heshtur të pa armë ndaj atyre që ia kurdisën fatin, ia vodhën shtëpinë, njerëzit, atdheun. Po kaq fort sa te Bajraj, interpretimi i pamjes tjetër të luftës realizohet në poezinë e Shqiptar Osekut, Arben Idrizit, Donika Dabishevcit apo Halil Matoshit.

*Duke u ndalur te "Trupi" si armë luftar, citoni Kësulkuqja, përrallë për të rritur të Ag Apollonit lidhur me traumën e përdhunimeve e cila shfaqet si prezencë aktive. Është çliruar përfundimisht Kosova nga kthimi i viktimës në fajtor për këto raste dhe a është krejt e hapur t'i flasë, t'i shkruajë, t'i rrëfejë? A ka ndonjë viktimitë të këtij abuzimi që është ulur dhe e ka shkruar, si fiction apo metafiction historinë e saj? Dhe nëse jo, po të kishte ndodhur, mendoni se tabloja e letërsisë shqipe në Kosovë do të paraqitej ndryshe?*

Nëse të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, do ta kishin shkruar dëshminë (faktike a fikzionale) të torturës seksuale të ushtruar mbi ta, narrativa e përdhunimit në luftë, do të kishte pasur një drejtim krejt tjetër, sot, 25 vjet më vonë. Duke qenë të stigmatizuar nga familja, rrethi, shoqëria, të mbijetuarit e përdhunimit, kanë zgjedhur heshtjen dhe vazhdojnë të heshtin edhe sot. Nxitur nga fshehja e së vërtetës së kësaj plage të mbyllur brenda trupit e shpirtit të të mbijetuarve, autorët zgjedhën t'i japin zë asaj, ta përfojnë zërin e atyre që vetë s'patën guximin ta bëjnë. Hulumtimi në dëshmitë autentike anonime të të mbijetuarve të dhunës seksuale, të godet fort e drejt në zemër. Dhe kjo është plaga më e thellë e shoqërisë kosovare të pasluftës. Të gjitha këto dëshmi të kthyer në



letërsi, siç ndodh te Ag Apolloni, Gazmend Bërlajolli, Imer Topanica, Adem Gashi, Donika Dabishevcit, Flora Brovina, Ilire Zajmi, Vlora Konushevcit, Diçe Demiri, Sibel Halimi, Ardiana Shala, etj, i kam lexuar si letërsi. Nuk jam në dijeni të teksteve të mirëfillta letrare të shkruara nga vetë të mbijetuarit, ato që ekzistojnë janë tekste anonime, dëshmi anonime, të cilat i kanë provokuar autorët t'i trajtojnë, ashtu siç më kanë provokuar dhe mua si

studiuere. Dhe është ky palimpsest traumatik letrar, që e shndërron letërsinë në dëshmi fikzionale të një të vërtete faktike, e cila vazhdon të mbahet si sekret publik. Rrëfimi për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë në poezi e në prozë, do të duhejt të nxishte diskutimin publik mbi një pjesë të së kaluarës e cila nuk guxon të vazhdojë të mbahet sekret publik, por është e rëndësishme të shpohet në mënyrë që ta fitojë të drejtën për

pjesëmarrje në ndërtimin e kujtesës kolektive dhe ta dokumentojë e ta diversifikojë historinë e re të Kosovës.

*Dhe meqë jemi këtu, duke lexuar librin, vura re se kanë shkruar më shumë këtë lloj letërsie burra sesa gra. Cila mund të jetë arsyeja?*

Emri i autores grua, ndonëse më i paktë në total, është më i pranishëm mu në temën e përdhunimeve në luftë, mbase si një përpjekje për të thirrur analogji me dhimbjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale, që shënon në vetvete një shenjë bashkëpërjetimi, një marrëveshje të heshtur humane. Megjithatë, poezia e autores grua nuk manifestohet vetëm në reprezentimin e traumës së përdhunimit seksual, por ajo prek edhe dimensionin social dhe ngre zërin revoltues ndaj vrasjes së shumëfishtë të të mbijetuarës, jo tashmë vetëm nga dhunuesi-tjetri pushtues, por edhe nga njeriu i vet-tjetri i brendshëm, siç i flet në raste të tjera qenies së traumatizuar në shoqërinë në tranzicion.

*A besoni se nëpërmjet zbërthimit letrar të luftës, ajo mund të kuptohet edhe më mirë nga ata, nga ne që nuk e kemi jetuar atë?*

Trajtimi i letërsisë së këtyre dy dekadave dëfton se sa e egër është lufta, sa e brishtë është kujtesa dhe sa e fuqishme është letërsia - arkivi i mendjes për ta mbajtur gjallë memorien. Prandaj, ky studim provon e dikton se nëse historia shkruan të vërtetën e një lufte të një vendi, një kohe, ajo mbetet një





përvojë e histori nacionale, por e përkthyer në letërsi, shndërrohet në dëshmi universale të humbjes, terrorit dhe vdekjes. Përtej diskursit të ftohtë historik, politik apo diplomatik, letërsia është e aftë ta jap klithmën e viktimës, të eksperimentojë e të hulumtojë

skutave të errëta të qenies në zgrip të ekzistencës, duke arritur kështu ta heshtë e ta trondisë lexuesin e ndryshëm. E vërteta e dhimbjes e shplimi i saj përtej kufijve, ishte dhe misioni im si autore, përtej pasionit letrar.



*Personazhi kryesor i letërsisë së pas luftës, "heroi" si të thuash, kryesisht nuk del i tillë, por e kundërta, pra anit-hero. Kujtoj Ollurin me "Bartësi i shpirtrave të përzënë", fjala bie, po dhe të tjerë, Mehmet Kraja për shembull me "Prishtina" dhe "Liria ime". Të jetë kjo pasojë e ndonjë zhgënjimi të ardhur pas mbarimit të luftës? Pritej diçka tjetër pas saj, por në fakt, realiteti që ndryshe?*

Personazhi i kësaj letërsie është viktima civile e luftës. Kërcënimi i vazhdueshëm i dhunës, liria e brishtë dhe realiteti i ashpër i pasluftës, kanë gjeneruar poezinë e prozën në të cilën e kaluara traumatike rrjedh në të tashmen. Ndja, bëhet e pamshmanjshme letërsia si paraqitje e një jete të rrënuar dhe e një njeriu në margjina, i cili shpallë qenien njerëzore në kompleksitetin e saj, një qenie e revoltuar, shpesh e zhgënjyer dhe dëshpëruar.

Olluri provon të rindërtojë arkitekturën e një jete të brendshme të personazhit të përhumbur nën dhunë, i cili i ndryrë në muret e parrënuar të së shkuarës, dëfton metafiziken e njerëzores nën shtypjen e pushtetit që transformohet në frikën individuale, në kohë lufte apo në kohë paqeje. Kraja ndërkaq, zë pikën e përqendrimit në zonën e ndërmjetme të kapërcimit nga lufta në liri. Mbyllja e një epoke dhe fillimi i një tjetre mund të rrumbullakohet si botë më vete, një tëiligh zone, në të cilën nuk sosin rrëfimet e euforisë, shthurjes dhe bizariteteve. Romani "Edhe të çmendurit fluturojnë" apo "Prishtina", të vënë në zonën e papërcaktuar të luftës dhe të pasluftës, ofrojnë një reprezentim të shkëlqyeshëm, psikanalitik, social e kulturor të njeriut të Kosovës, të sapo dalë nga epoka e errët. Koha e ndërmjetme, si një dramë e shëmtuar kolektive që prodhon një kohë e pa ligj dhe një vend i pa zot, shtron dramën e të përhumburve dimensioneve të indiferencës, imunitetit ndaj rënive humane, por arrin ta portretojë me saktësi individin e pasluftës, agresionin e turmës që e përdhunon lirinë, vdekjen dhe ephsin e njeriut që rron sipas rastit e çastit në ditët e para të lirisë, para se të vetëshembet.

*Praktikisht, teksa i afrohem mbylljes së kësaj bisede, në rastin e Kosovës, a ja ka dalë letërsia ta paraqesë, ta rrëfejë shoqërinë?*

Letrat e kujtesës së luftës në Kosovë, janë dëftuese të rrugëve në të cilat letërsia si art i fjalës jo vetëm që e risjell dhe e rindërton të kaluarën, por gjithashtu reflekton në kuptimin e realitetit të ri dhe ndjenjën e

përkatësisë, siç ofron edhe mundësinë e eksplorimit të një bote që ringrihet mbi rrënojat e së shkuarës. Vepra letrare e trajtuar në këtë kornizë mbetet brenda poetikës së kujtesës, por njëkohshëm shkruan dhe biografinë e njeriut të shkelur kosovar si mikrokozmos i njerëzimit. Me dëshmi efektive (auto) biografike dhe poetike të krimeve kundër njerëzimit, poezia dhe proza kanë amplifikuar zërin drejtuar kundër idesë së luftës dhe çdo lloj terrori; interpretimi shpirtëror dhe emocional i luftës që shkon paralelisht me të vërtetën, u ofron lexuesve një këndvështrim tjetër mbi kuptimet dhe interpretimet, për faktin se "aftësia jonë për t'i dokumentuar përvojat e kaluara, i mbron themelet e individualitetit njerëzor".

*A është realizuar me sukses rikrijimi letrar i së shkuarës?*

Letërsia e studiuar ofron një tjetër perspektivë ndaj luftës së viteve 1998-99 në Kosovë dhe ndikimit të saj. Veprat e studiara shpalosin mikroperspektivën e historisë së luftës nga këndvështrime dhe qasje të ndryshme, herë duke i dhënë zë viktimave, e herë duke e përforcuar zërin e njeriut në tranzicion dhe luftën e tij për mbijetesë dhe fuqizim. Kjo letërsi po aq sa rikrijon të shkuarën, po aq sa shkruan dëshminë letrare të luftës, flet edhe për sfidat e drejtësisë tranzicionale dhe integritetit social në Kosovë, duke dëftuar rolin e viktimave dhe të të mbijetuarve të të gjitha kategorive në kuptimin e luftës dhe ndërtimin e memories kolektive.

*Kur do të jetë koha, sipas jush, e cilit brez letrar e njerëzor, në të cilën letërsia shqipe në Kosovë do ta tejkalojë memorien dhe traumën e shkaktuar prej luftës?*

Letrat e kujtesës kanë peshën e madhe të kundërpërgjigjes ndaj harresës: ato nxisin e inspirojnë krijimin e rrëfimeve autentike të cilat nga një dëshmi autoriale, bëhen dëshmi e të tjerëve, meqë mbërthejnë një kuptim më gjithëpërfshirës dhe ekzistencial të aspekteve universale të ekzistencës. Është e evidente se transmetimi i memories kolektive dhe individuale të luftës dhe i traumës si pasojë, është ende në fazat e para të reprezentimit letrar dhe lufta e viteve 1998-1999 në Kosovë do të ketë padyshim interpretime të reja e të ndryshme në ligjërimin letrar në vazhdim. Mbase, dekada më vonë, kur plagët të mos kullojnë e koha t'i shërojë sadopak, letërsia do të vështrojë nga lufta me rrallë, por jehona e saj do ta ndjekë gjatë.

Në historinë e Shqipërisë të pas Skënderbeut, figura e Ali Pashë Tepelenës, të mbiquajtur "Luani i Janinës", mund të themi pa asnjë dyshim, se ka qenë më e përfolura dhe e shoqëruar me vlerësime të autorëve vendas e të huaj, por edhe nga çka na ka mbërritur nga trashëgimia jonë gojore, nga më kontradiktoret. Sido që të jetë, qofshin ata që e kanë parë atë me anët e tij të mira, si trim, të mençur, largpamës, burrështetas autoritar, që duke udhëhequr me dorë të hekurt pashallëkun e tij, i bëri karshillëk edhe vetë Portës së Madhe, apo dhe ata që kanë parë tek ai, sundimtarin e egër mizor, gjakatar, dinak e hakmarrës, nga i cili dridhej edhe foshnja në bark të nënës, në një pikë kanë qenë në një mendje: se nuk mund të kuptohet historia jonë, pa veprën e tij, të shtrirë në një periudhë prej rreth tre dekada e gjysmë. Pikërisht për hir të këtyre cilësive që vështirë të ndërthuren te një njeri i vetëm, ai ka tërhequr interesin e politikanëve, diplomatëve, strategëve, shkrimtarëve dhe historianëve të ndryshëm. Dhe gjithmonë, librat për të, janë përpër nga lexuesit e të gjitha kategorive. Por, ai që nuk u lodh duke hulumtuar, duke shkruar e duke botuar për të është Profesor doktori i respektuar Irakli Koçollari. Duke hedhur vështrimin qysh nga viti 1998 kur nisën botimet e librave të tij për tepelenasin emërmadh, që arritën kulmin me dyvolumshin "Policia Sekrete e Ali Pashës" dhe tre volumet me korrespondencën dhe dorëshkrimet e tij, e deri te ky që na bje tani në dorë me plot 800 faqe, botim dinjitoz i ONUFRIT, mund të themi se puna dhe këmbëngulja e tij do të që e denjë edhe për vetë Irakliun e mitologjisë, i cili për t' u ngjitur në Olimp përmbushi heroikisht, plot 12 stërmundime. Koha kur Aliu jetoi dhe sundoi ishte e ngarkuar me ngjarje nga më të çuditshmet që shpesh merrnin kthesa të papritura dhe që përherë përfundonin me vrasje të pabesa që shkonin deri në kasaphanë. Por ishte edhe koha për të cilën britaniku Bagalli apo amerikani Koliopolus konkludonin se shqiptarët u bënë "djepi që përkundi këtë lëvizje që shërbeu si pararendëse e lëvizjeve të armatosura për pavarësinë e Ballkanit". Përpara se të mbërrijë tek "Alipashaida" e Haxhi Shehretit, pra tek ajo që me të drejtë do të konsiderohej jo vetëm "Iliada" shqiptare, por edhe pararendësja e poezisë shqipe, autori ka preferuar ta përgatisë lexuesin si me studimet dhe analizat e tij të mençura, ashtu edhe me plot mendime të shfaqura nga personalitete tërësisht të besueshme dhe me autoritet, jo thjeshtë për kualitetet që kishin, pra për reputacionin e tyre, por edhe si njerëz që e kishin njohur nga afër atë. Por është e natyrshme që ai t' i kushtojë një vëmendje të veçantë autorit të vetë poemës dhe ta paraqesë atë jo vetëm me një kulturë superiore dhe besnik të Aliut, por si jetëshkruesin më autentik, për të mos thënë edhe kronologjik, pasi i shërbeu atij për 60 vite me radhë, tashmë në vargje, të atyre ngjarjeve dhe bëmave të tij që e bënë të pavdekshëm. Haxhi Shehreti ishte diplomati që përfaqsoonte dhe mbronte interesat e Aliut në oborrin e Sulltanit. Ai kishte lidhje dhe gëzonte miqësinë e shumë njerëzve të shquar, si p.sh. Elxhini i famshëm dhe fjala e tij dëgjohej me shumë respekt. Mjaft të shohësh informacionet dhe propozimet që ai i bënte Ali Pashës, dhe do të bindesh se ai ishte nga më konfidentët e tij. Sa sundoi, Aliu i dha rëndësi të madhe arsimit, dhe për këtë dëshmon ajo që na kumton Fred Dagllasi që thotë (perifrazoj) se ai për arsimin dhe mësimin e gjuhës ka pikëpamjet e tij gjithëpërfshirëse dhe të thella, duke sugjeruar një institucion të madh (universitet), nën kujdesin e Psalidhës, më të diturin e Greqisë të cilin sipas Panajoti Avrantinoit e porosiste që ta mësonte siç duhet rininë dhe t' u jepte shembuj të mirë se do të kishte tërë përkrahjen e tij. Dhe shton: "Këtu çdo gjuhë moderne ka mësuesin e saj. Pastërtia e diksionit, përhapja e mësimdhënies dhe e njohurive mbi botën që ndryshojnë shoqërinë e tij, e bëjnë Janinën, Athinën e Greqisë moderne". Dhe nuk është për t' u çuditur kur lexojmë historianin britanik Finlay i cili tregon se "Fëmijët e shqiptarëve myslimanë, mund t' i shohësh në të njëjtën paradhomë duke lexuar Kurandin me


## "ALIPASHAIDA" E IRAKLI KOÇOLLARIT, NJË BOTIM I ÇMUAR PËR KULTURËN DHE HISTORINË TONË

Nga Shpendi Topollaj

një osmanli të shkolluar, ndërkohë që në dhomën tjetër një djalosh kristian i së njëjtës moshë mund ta shikosh duke mësuar shkrim greqisht me një prift grek". Ja pse në Janinë veç teologjisë, mësohej edhe fizika, kimia, matematika dhe arsimit ishte i lirë, i pavarur dhe krijues. Në të tillë klimë është e kuptueshme, përse Ali Pasha, zgjidhte për t' i mbajtur pranë në punët e shtetit, njerëz si Haxhi Shehreti. Dhe në apollojinë që Irakliu i bën talentit të këtij poeti, me mjaft finesë e gjithmonë me argumente, brenda të cilave ka një llogjikë të paqortueshme, ka ditur të debatojë apo kundërshtojë ndonjë qëndrim dyshues si ai i konsullit symprehtë Martin William Leake që e quan pararendës të albanologjisë, i cili teksa aludonte për anën artistike të kësaj vepre, prej nga duhet të ketë marrë materialin kryesor për librin e tij "Biografia e Ali Pashës", shprehet se "poezia e krijuar në një vend të prapambetur tenton të bjerë në prozaizëm". Po kështu, u është përgjigjur ai, atyre historianëve grekë dashakeqës që kanë synuar t' ia ulin rëndësinë dhe vërtetësinë veprës madhore të "myslimanit" delvinjot Haxhi Shehreti. Këtyre të fundit, ai u kujton konstatimin objektiv e të guximshëm të Aristidh Koljas që shkruante: "Imagjinoni si do të konsiderohej në letërsinë greke Shehreti në se ai do të ishte i krishterë dhe do të lëvdonte betejat e suljotëve kundër

Ali Pashës. Një poemë në 10.000 vargje e shkruar në vitin 1800 do të mbetet origjinale, unike dhe pa një të dytë në llojin e saj". Koçollari nga ana e tij i ka bërë poemës së Shehretit jo një përkthim, por shqipërim sa korrekt aq edhe artistik. Si e tillë, të duket se më mirë në gjuhën tonë nuk do ta kishte shkruar as vetë autori i saj i dy shekujve më parë. E ndarë në kapituj sipas ngjarjeve, ai ka ditur të ruajë si metrikën, ku kam parasysh strukturën dymbëdhjetë rrokëshe të vargut, rimën e puthur oksitone, figuracionin e tingëllimin muzikal, ashtu dhe atmosferën e kohës. Ja si na parqitet vetë Pashai në madhësitinë e tij: "Të gëzuar gjithë njerëzia anë e mbanë në vilajete / Vijnë përulen Ali Pashës, plot para nëpër sepete. / Ditë pas ditë Ali Pashës famën, zulmet ku s' ia gjen / Emri i tij njihet dynjasë nga India në Jemen, / Dhe në shtatë Ishujt e Jonit i dëgjohej soji, fara / Dhe askush në ato anë nuk guxon t' i dalë përpara". Dhe duhet pranuar se nuk ishte as prejardhja nga gjyshi dizdar i Tepelenës, as nga i ati pasha që u vra kur ai qe ende i vogël, as se e ëma Esmiha Hanëmi vinte nga Zenelbenjllitë e Konicës apo se ajo pasi u rrëmbye me të bijën nga Kardhiqotët kur kishte shkuar të mblidhte taksat, dhe u keqtrajtua prej tyre, i la amanet atij që të hakmerrej, shkaqet që ai arriti aq lart. Duke ditur se ai nuk ishte as i shkolluar si duhet, llogjika ta do të thuash se Ali Pasha u

bë ai që njohu Evropa mbarë, së pari, falë cilësive të tij të rralla. Prandaj, të gjitha lavdërimet që Shehreti formulon për të, janë mëse të merituar dhe në të gjithë shtrirjen e poemës, nuk ka vend të mendosh për egzagjerime, simpatira personale apo ditirambe nga ato të Arionit e Pindarit ( shek. VII - V p.e.r.). Shkollë nuk kishte as Genghis Khani, i mbi 800 viteve më parë, por çdo vit shkojnë e falen mongolët tek ajo statuja e tij 40 metra e lartë, në Tsonjin - Boldog në breg të lumit Tola, pranë Ulanbaturit. Kurse ne, s' para qederosemi për t' i bërë homazhe Ali Pashait tonë të cilin Bajroni e quante "kapedan të pavarur, figura e tretë historike pas Aleksandrit të Madh dhe Skënderbeut", tek ajo statuja e tij në Tepelenë edhe pse ai për vite me radhë iu kundërvu hapur Sulltanit, duke synuar pavarësinë, çka del qartë edhe te letra që i dërgon Shehretit në Prill të 1813, ku i thotë troç se "... nëse nuk më do Sulltani që të jem i gjallë në këtë dynja, le të bëhet ç' të dojë, unë do t' ia dal...". Dhe ashtu u bë, gjersa në 24 Janar të 1822 në pabesi, pas një viti e gjysmë rezistence ndaj 50.000 ushtarëve armiq dhe i braktisur, iu pre koka, duke mbetur njëri nga shqiptarët e vetëm me dy varre, një në Kastros të Janinës e tjetri në Stamboll te Porta e Silirvisë. U nda më dysh, ai për të cilin Aleksandër Duma flet me aq admirim, dhe i madhi Viktor Hygo thosh: "Ali Pasha rri përballë Bonapartit, si tigri me luanin, ata ngajnë me njëri - tjetrin si dy pika uji, sepse të dy e filluan karrierën nga hiçi dhe u ngjitën deri në majat e perandorëve". Në librin e tij, Irakliu na tregon se janë të paktën tri poema kushtuar Aliut, por ndërsa njëra që konfirmohet nga Aravantinos, nuk gjendet, tjetra e artikulluar nga shqiptari plak emigrant në Greqi, Jani Paguni dhe sjellë nga Emile Legrandi dhe që quhet "Vaje për Ali për Pashën", në dialektin epirot, mbetet anonime. E megjithatë, ai arsyeton se edhe ajo, në të gjithë treguesit është vazhdim i veprës së Haxhi Shehretit. Ma do mendja se kështu do të mendojë kushdo lexues kur t' i ballafaqojë ato. Pavarësisht kësaj, autori i këtij libri impresionues duhet falenderuar edhe për këmbënguljen e ndjekjes së rrugëtimit të këtyre krijimtarive kaq të rëndësishme letrare të asaj kohe plot trazira. Me jetën e ndershme dhe mbylljen e saj në varfëri, duke u ndalur vetëm te shembulli i kërkesës së llogarisë ndaj argjendarit Haçaturian për zbulimin e armëve të Pashait me diamante, figura e Haxhi Shehretit mbetet një shembull i vyer për të gjithë ne sot, që përjetojmë korrupsionin që shkatërron shtetin. Po ashtu, të shkruarit si një intelektual i shquar atdhetar, nga ana e akademikut Irakli Koçollari jep edhe shembullin që duhet ndjekur nga politikanët tanë, të cilët pa asnjë detyrim e kanë dorëzuar te të huajt sovranitetin dhe dinjitetin e Shqipërisë tonë, asaj Shqipërie për popullin e të cilit miku i Bajronit, John Hobhouse shkruante se: "Tek i gjithë ky popull ekziston një shpirt indpendence dhe dashurie për vendin e tyre... Kështu, kur pyet banorët e provincave të tjera se çfarë është ai, ata do të përgjigjen "unë jam mysliman" ose "unë jam kristian". Ndërsa po të pyesësh një banor të këtij vendi (Shqipërisë), se çfarë është ai, ai do të përgjigjet - "Unë jam shqiptar". Në përfundim, nuk mund të mos theksoj se Prof. dr. Irakliu me këtë vepër ka vërtetuar më së miri fjalët e francezit Alphonse de Lamartine i cili thosh për të parët tanë: "Ata kanë një shpirt poetik, ashtu sikurse edhe zakonet e tyre. Këngët popullore... të kujtojnë këngët homerike shumë më mirë se sa këngët e plogështa të Greqisë moderne. Ato pleksin, sikurse Akili, poezinë, vallen me luftën...". E mbaron së lexuari këtë libër dhe ai tingëllimi i atij vajtim për vdekjen e Ali Pashës, të ndjek pas. I rënë duke luftuar, ai të kujton Imam Aliun që i vrrarë së bashku me të birin, Hasanin, nga Muavija i Sirisë në 661, së bashku me Perëndinë dhe Profetin Muhamet, konsiderohet trinia e shenjtë e bektashinjve. Kështu e pati quajtur Ali Pashanë tonë edhe Bajroni. I tillë del ai edhe në tërë krijimet letraro - historike të Prof. dr. Irakli Koçollari, me gjithë virtytet dhe veset që impononte ajo kohë e trazuar.



Brenda punës sime rreth studimit të letërsisë, që zë fill me punimin "Analogji e porosive të fantazmave në veprën Hamleti të Shekspirit dhe Istori e Skënderbeut të Naim Frashërit", të botuar në revistën "Fjala" të Prishtinës më 1968<sup>1</sup>, kam vështruar dhe dukuri të letërsisë për fëmijë dhe të veprave të saj. Përveç punimeve për disa vepra të veçanta të letërsisë sonë për fëmijë ose të letërsive të tjera për fëmijë, kam botuar dhe këto vepra studimore: *Poezia për fëmijë e Mark Krasniqit*. Studim monografik. "Faik Konica", Prishtinë 2002; *Letërsia për fëmijë si art i fjalës*. Shtëpia botuese "Arbëria 07", Tiranë 2013; *Veçanti të veprës letrare për fëmijë të Rifat Kukajt*. Argeta LMG, Tiranë 2020 dhe *Poetika e letërsisë për fëmijë*. Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", Prishtinë 2020.

Në punimet për veprat letrare për fëmijë si dhe në librat studimorë që i përmenda, kam dëshmuar se letërsia për fëmijë është pjesë e pandashme e artit të fjalës, letërsisë, dhe se ajo, si dhe letërsia për të rritur, letërsia gojore etj. përbërësin kryesor e kanë gjuhën dhe të shprehurit poetik. Kështu, përkundër veçantive që i kanë, siç ndodh me llojet e artit të fjalës që i përkasin poezisë, prozës ose dramës (për të mos i përmendur nënlojet brenda këtyre tri zhanreve) qëllim kryesor kanë ndikimin estetik në marrësin dhe pasurimin e tij shpirtëror.

Zhvillimi dhe pasurimi i letërsisë sonë të shkruar për fëmijë pas veprave të autorëve të letërsisë sonë të vjetër dhe veprave të letërsisë së arbëreshëve të Italisë<sup>2</sup>, që vinë pas tyre, në periudhat e më vonshme të thuash se ka ecur krahas letërsisë për të rritur. Në disa periudha letërsia jonë për fëmijë ka pasur një shtegtim dhe një rritje më të madhe, në disa të tjera, ngecje dhe rënie. Megjithatë, përherë janë hartuar e janë botuar vepra për fëmijë vlerash dhe cilësish të ndryshme.

Siç është e njohur botërisht letërsia gojore<sup>3</sup>, që i ka paraprijë letërsisë së shkruar për shekuj me radhë, ka krijuar bazën nga është nisur çdo vepër e letërsisë së shkruar, qoftë ajo për të rritur ose për fëmijë<sup>4</sup>. Edhe brenda vetë letërsisë gojore kanë ekzistuar llojet e letrare si, fjala, vjen përrallat, fabulat, këngët e fëmijëve dhe këngët për fëmijë, këngët e djepit, lojanakët etj.

Duhet përmendur këtu rëndësinë e shumëfish të, fjala vjen, përrallës gojore, që bëri jetë shumë të gjallë me shekuj para lindjes së shkrimit dhe të letërsisë së shkruar. Këtë krijim letrar gojor nuk e quajten rastësisht "*kthjelltësia e poezisë mbretërore*"<sup>5</sup>.

<sup>1</sup> Botuar në revistën "Fjala", nr. 10, Prishtinë 1968, f. 6.

<sup>2</sup> Shih për letërsinë e arbëreshëve të Italisë librin tim *Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*. Luigi Pellegrini Editore. Cosenza 2008. Botimi i dytë "F. Konica", Prishtinë 2013.

<sup>3</sup> Shih veprat e mia *Çështje të letërsisë gojore*. "Rilindja", Prishtinë 1982; *Qasje poetikës së letërsisë gojore shqipe*. (Studime e artikuj), "Rilindja", Prishtinë 1998 dhe *Hyrje në historinë e letërsisë gojore shqipe*. "Faik Konica", Prishtinë 2017.

<sup>4</sup> Për këtë dukuri kam bërë fjalë në disa punime; shih edhe veprën time *Përkime poetike*. Kritika letrare. "Rilindja", Prishtinë 1978.

<sup>5</sup> Maja Bošković-Stuli, *Narodna predajavolkssage-kamen spoticanje u podjeli vrsta usmene*

## PSE LETËRSIA JONË PËR FËMIJË ËSHTË ENDE NDËRGJEGJJA JONË E PIKËLLUAR?

Nga Anton Nikë Berisha



"Letërsia për fëmijë mund të mos përfillet me kusht që të mos përfillet as bota, në të cilën një shpirt nacional formohet dhe ruhet!"

Paul Hazard

<sup>1</sup> Paul Hazard, *Uomini, ragazzi e libri. Letteratura infantile*. Seconda edizione. Armando Editore, Roma 1969, f. 95.

Si e këtillë ajo bëri një ndikim të jashtëzakonshëm në letërsinë e shkruar, sidomos në prozën e shkruar<sup>6</sup>, por edhe në marrësin, te fëmijët dhe tek të rriturit meqenëse përrallat i treguan të rriturit dhe i dëgjuan fëmijët.

Në punimet dhe në studimet e deritashme kam ndriçuar sa afitë, përkimet, po aq dhe ndryshimin mes letërsisë për të rritur dhe letërsisë për fëmijë, që janë të natyrshme, siç janë të natyrshme dhe ndryshimet brenda vetë llojeve të prozës së shkruar: tregimit të shkurtër, novelës, romanit, po dhe ndryshimet brenda vetë llojeve të romaneve<sup>7</sup>.

Se veprat e letërsisë për të rritur dhe veprat e letërsisë për fëmijë janë shtresa të artit të fjalës, është dëshmuar nëpër rrjedhë të kohëve dhe se ato u përdorën nga të rritur dhe nga fëmijët. Për këtë dëshmojnë shumë shembuj. Po përmend këtu *fabulën*, e cila në kohën e Ezopit (shek. VII – VI para Krishtit), kur u bë shumë e njohur në letërsinë e lashtë greke, shkruhej për të rriturit, veçmas për shtresën e fisnikëve. Më vonë ajo u bë lloj mjaft i përshtatshëm dhe i përfillshëm pikërisht për fëmijë.

Esteti italian, Benedetto Croce (Benedeto Kroçe), duke folur për rregullat e zgjedhjes së librave, që duhet

proze. Në „Usmena književnost kao umjetnost riječi“. Mladost, Zagreb, 1975. f. 121.

<sup>6</sup> Shih punimin tim *Poetika e përrallës*. Në "Rilindja", dt. 21. 07. 1979 dhe punimin *Hyrje në poetikën e përrallës*. Në "Hyrje në historinë e letërsisë gojore shqipe". "Faik Konica", Prishtinë 2017, f. 229 - 276.

<sup>7</sup> Shih për këtë veprën time *Teksti poetik*. Vështrime e kritika. "Rilindja", Prishtinë 1985.

t'i lexojnë fëmijët thoshte: "Libri i mirë për fëmijë është ai që mund të shijohet, pa kufizime e pa rezerva, edhe nga të rriturit. Nuk vlen për fëmijë gjithë ajo që është shkruar për të rritur, mirëpo krejt ajo që është shkruar për fëmijë duhet të vlejë edhe për të rritur në qoftë se është vepër e artit"<sup>8</sup>.

Edhe autori ynë letrar, Vehap Shita, ka vërejtur me të drejtë: "Letërsia për fëmijë dhe ajo për të rritur nuk kanë ndonjë kufi të prerë që i ndan njërin nga tjetra, sidomos kur është fjala për krijuesit e saj. Shumë nga ata që shkruajnë për të rritur, shpeshherë shkruajnë edhe për fëmijë dhe – anasjelltas. Mandej letërsinë, fjalën e shkruar e të thënë artistike, e shijojnë njësoj, ndonëse secili në mënyrën e vet, i rrituri dhe fëmija [...] Përrallën e bukur popullore e dëgjojnë njësoj me ëndje i rrituri sikurse edhe fëmija"<sup>9</sup>.

Ç'rëndësi ka letërsia për fëmijë e kam theksuar në disa punime, po këtu mjafton të kujtoj mendimin e njërit ndër njohësit dhe studiuesit më të shquar të letërsisë për fëmijë, Paul Hazard, të vënë si moto të këtij punimi: "*Letërsia për fëmijë mund të mos përfillet me kusht që të mos përfillet as bota, në të cilën një*

<sup>8</sup> Shih Antonio Faeti, *Letteratura per l'infanzia*. La Nuova Italia Editrice. Firenze 1977, f. 13.

<sup>9</sup> Nisur nga ky përcaktim ky studiues thotë: "Fëmijët i zgjedhin nëpër raftet librat italiane që atyre u përshtatën e ata janë librat për fëmijë. Mirëpo, një letërsi për fëmijë nuk ekziston". Shih Gianni Rodari, *Scrivere oggi per i bambini*. Citatin e mora nga interneti.

<sup>10</sup> Vehap Shita, *Një vështrim mbi letërsinë tonë për fëmijë*. Në "Jeta e re", nr. 3, Prishtinë 1968, f. 616.

shpirt nacional formohet dhe ruhet"<sup>10</sup>.

Duke e pasur parasysh këtë gjë them me bindje se një popull që ka pasur apo ka një letërsi të madhe për fëmijë, ka pasur dhe ka një letërsi të madhe dhe për të rritur. Ngjet kështu për shkak se ndërtimi dhe ngritja e shpirtit artistik të një qenie njerëzore kërkon mund të madh dhe shumë kohë: fillon qysh në moshën e re e vazhdon gjatë gjithë jetës. Poeti ynë, Jeronim De Rada, duke folur për poezinë dhe të bukurën që duhet ta cilësojë atë, thoshte: "[...] *Edukimi i shpirtit me të bukurën është një punë e lodhshme dhe e gjatë sa edhe vetë jeta*"<sup>11</sup>.

Pra, shkrimtarët e mirë, përmes leximit të veprave poetike të krijuara më parë, po edhe ato në kohën e tyre, formohen duke filluar nga fëmijëria dhe pasurohen në rrjedhë të viteve. Nëse një shkrimtar nuk e ushqen (përmes leximit) vijimisht mendjen dhe shpirtin e vet me vlera letrare poetike, atëherë frytet e punës së tij do të jenë të përvuajtura.

Një letërsi, pra dhe letërsia për fëmijë, që vendnumëron dhe nuk pasurohet, është shenjë e fillimit të zhbërjes. Nëse do të ndodhte kjo, do të kishte pasoja të rënda jo vetëm në rrafshin e mbëltimit (kultivimit) të së bukurës e të fisnikërimit shpirtëror të fëmijëve, po dhe në lëmin e ditorisë, të mirësisë dhe të njerëzores. Veprat e mira letrare poetike (kur lexohen) u hapin marrësve të tyre dritare dhe shtigje të shumta, për të mos thënë të pafund; përmes tyre do ta njohin vetveten, do t'i njohin më thellësisht dukuritë dhe mjedisin ku jetojnë; do të aftësohen t'i përballojnë vështirësitë e jetës më lehtë dhe sa më me pak pasoja. Për këtë arsye është thënë me të drejtë se poezia (lexo: dhe letërsia) është më mendore dhe më vlefshme se historia (nënvizimi im), sepse poeti e shqipton atë që është e përgjithshme, e mundshme, ndërsa historiani atë që është e veçantë<sup>12</sup>.

Tashmë është e njohur se vepra letrare poetike është fryt i botës subjektive dhe i imagjinatës së shkrimtarit dhe ajo përmes tekstit e shpreh këtë botë, po njëherit, përmes artit të fjalës e përfiton një botë që mundëson njohjen e botës konkrete dhe të botës së brendshme, të vërtetës subjektive të njeriut, që janë dukuri të ndërliqshme dhe fshehtësi të mëdha.

Dy janë, ndër të tjera, kushtet të cilat duhet të plotësohen që një vepër poetike të përligjë qenësinë dhe gjallimin e saj; ai që shkruan duhet a) të përdorë një gjuhë poetike sa më të pasur e të veçantë dhe b) të rrëfejë, para së gjithash, diçka të bukur në mënyrë që ai që e lexon, mund të komunikojë me atë tekst dhe si rrjedhojë të ndikohet prej tij.

<sup>10</sup> Paul Hazard, *Uomini, ragazzi e libri. Letteratura infantile*, vep. e përm., f. 95.

<sup>11</sup> Jeronim De Rada, *Parime të estetikës*. Në Jeronim De Rada, *Vepra letrare 3*. "Naim Frashëri", Tiranë 1987, f. 276.

<sup>12</sup> Shih Zdenko Škreb, *Osnovni pojmovi poetike*. (U povijesnom slijedu). Në "Uvod u književnost", drugo dop. Izdanje, Znanje, Zagreb 1969, f. 227. Shih dhe Aristoteli, *Qasje artit poetik*. Përkthimin, studimin hyrës dhe shënimet Anton Nikë Berisha. Argeta LMG, Tiranë 2020.

Të gjitha citimet nga kroatishtja dhe nga italishtja, nëse nuk përmendet përkthyesi, janë të autorit të punimit.

Veprat letrare poetikisht të ngritura, qoftë ato origjinale, qoftë të përkthyer, për të rritur e për fëmijë, ndikojnë dhe në ndërtimin e botëkuptimit, në plotësimin e virtyteve, sidomos në domosdonë e veprimin në jetën e përditshme, pa marrë parasysh kushtet dhe rrethanat që herë – herë krijohen; ato ia mbëltojnë marrësit ndjesinë e fisnikërisë, të shoqërizimit e të nderimit të tjetrit. Pra, letërsia në përgjithësi e brenda saj dhe letërsia për fëmijë e pasur dhe artistikisht e ngritur, nëpërmjet mënyrave të ndryshme, sidomos përmes shqiptimit të lojës dhe të argëtimit, e formon shpirtin artistik dhe frymën krijuese të lexuesit të saj.


Shkrimtari italian, Xhusepe Fançulli (Giuseppe Fanciulli) e përcakton letërsinë për fëmijë si një mjet (mënyrë) për formimin e njeriut qysh në fillim të jetës së tij: “Letërsia për të rinj [...] është një instrument i formimit njerëzor; është pasqyrë dhe shprehje e një fëmijërie e caktuar të formojë shoqërinë e së nesërme. E para së gjithash një mjet i sigurt për arritjen e mirëkuptimit e të paqësimit midis popujve<sup>13</sup>”.

Veprat letrare për fëmijë bëhen të rëndësishme për shkak se në to, siç ngjet dhe në letërsinë për të rritur, dukuritë shqiptohen përmes gjuhës poetike, figurshmërisë, simbolikës dhe metaforikes, që mundësojnë përfitim të tekstit, komunikimin me të dhe ndikimin estetik, që është një nga qëllimet kryesore të çdo krijese letrare, e cila, siç pohon studiuesi i shquar, Zdenko Shkreb<sup>14</sup>, duhet të lexohet e të receptohet si vepër poetike e jo si fakt historik.

Letërsinë për fëmijë e bëjnë letërsi të magjës dhe të mrekullisë gjuha që përdoret, mënyrat e veçanta të shtjellimit të tekstit dhe të shprehurit; ngrohtësinë e rrëfimit, pastaj loja si formë argëtimi që (shpesh) gërshetohet me një humor të natyrshëm e me funksion etj. Këta përbërës zgjojnë tek fëmijët kureshtjen, kënaqësinë, fisnikërimin dhe pasurimin shpirtëror. Aldo Cibaldi (Cibaldi) thekson: “Në fjalën poetike rrjedh një jetë e imazheve (tablove) krijuese që e shndërrojnë dhe e dinamizojnë botën; arti është një lëvizje dhe një dinamikë edhe kur duket qetësisht i përmbajtur<sup>15</sup>”.

Nëse e vështrojmë dhe e çmojmë në këtë mënyrë letërsinë për fëmijë, mund të thuhet se populli që i kushton kujdesin e duhur krijimit dhe pasurimit të saj, mund të ketë përparim të mirëfilltë në fushën e artit të fjalës, po edhe në fushat e tjera të jetës. Fëmijët e sotëm bëhen nesër të rriturit, ata që do ta udhëheqin shoqërinë, siç do të ndodhë dhe me fëmijët e tyre dhe me fëmijët e fëmijëve të tyre. Një rrjedhë e pandalë.

Shumë vepra për fëmijë që përjetuan një përhapje të gjerë dhe një komunikim të madh dhe bënë një ndikim të ndjeshëm estetik në marrësin, nuk u



lexuan vetëm nga fëmijët e të rinjtë, po dhe nga të rriturit. Kjo dukuri dhe ndikimi i veprave të tilla poetike për fëmijë në rrjedhë të kohëve na bën të quajmë letërsinë për fëmijë *letërsi e mrekullisë* (nacion i Luixhi Santucci)<sup>16</sup>. Pikërisht për këto cilësi të kësaj letërsie Hazerdi thotë: “[...] librat që nuk i përgjigjen unit të tyre (të fëmijëve – v. ime), që nuk i godasin sytë e tyre në mes të figurës, dhe shpirtat e tyre me gjallërinë e formës, librat që u mësojnë atyre vetëm atë që mund të mësohet në shkollë, librat që i bëjnë të flenë e jo të ëndërrojnë, nuk i pranojnë (i hedhin)<sup>17</sup>”.

Vepra letrare e mirëfilltë për fëmijë, natyrisht, i shpreh dhe i përligj në mënyrë përkatëse veçantitë e botës së fëmijëve, që janë sa të mëvetësishme, aq edhe të ndërlikueshme. Tek fëmija ngjizën dhe dëshmojnë çështje të rëndësishme, që pastaj bëhen burimi i jetës së njeriut si qenie: “Më pak skeptik, më pak të dëshpëruar se sa ne, fëmijët gjejnë, në kontakt me këto faqe (të librit të D. De Feo, *Robinson Kruso* – v. ime), forcën dhe këndelljen e instinkteve primitive të racës sonë. Kujtimet e kohëve, në të cilat paraardhësit tanë më të largët nuk bënin gjë tjetër pos bridhnin mbi dhe? Zëra të përtejme që grishin për të dalë

nga ujdhesa jonë dhe që tërheqin drejt mbretërisë që sytë tanë nuk mund ta shohin kurrë<sup>18</sup>”.

Rreth letërsisë për fëmijë përballë letërsisë për të rritur shkrimtari Anatole France thotë ndër të tjera: “Nëse shkruani për fëmijë mos e bëni në mënyrë të veçantë; mendoni mirë, shkruani mirë: kjo është fshehtësia e vetme që t’u pëlqejë lexuesve të vegjël<sup>19</sup>”.

Rëndësinë e shumëfishtë të letërsia për fëmijë e thekson edhe L. Volpicelli, e cila do ta “[...] fusë të riun sa më shpejt që është e mundur në art, në kulturën e të rriturve, ajo do t’i zgjidhte më së miri detyrat e veta. Dhe do të kishte më të qartë konceptin e funksionit të vet që do t’ishite të shmangte (eliminonte) sa më parë që është e mundur veten e saj, domethënë nevojën e një letërsie të të rinjve për të rinjtë<sup>20</sup>”.

Në këtë rrjedhë lind pyetja: a nuk ndodhi kështu me veprat *Pinokio*, *Princi i Vogël*, *Robinson Kruso*, *Udhëtimet e Gulliverit*, *Zemra*, *Përrallat* e *Andersenit* e të ngjashme, që u lexuan në gjithë rruzullin e dheut nga miliona lexues të shtresave të ndryshme, fëmijë e të rritur.

Sipas leksikonit “Shkrimtarëve shqiptarë për fëmijë” të Odhi Grillos (ku jepen të dhëna për 530 shkrimtarë që shkruan për fëmijë në periudhë

1872 – 1995) duhet të jenë me mijëra vepra letrare për fëmijë llojesh të ndryshme, disa të cilësisë shumë të lartë, që bëjnë kulmet e artit tonë të fjalës si veprat e Rifat Kukajt “Zogu i bardhë”, “Pëshurrani i gjyshit” dhe “Dita e xhufkave”<sup>21</sup>, romani i Petro Markos “Shpella e piratëve” ose përmbledhja “Posta e porositur” e Mark Krasniqit, për të mos i përmendur të tjerat.

Është e çuditshme që gjithë kjo letërsi dhe të gjitha këto vepra letrare për fëmijë asnjëherë nuk gjetën asnjë vend në asnjë histori të letërsisë shqipe! Libri *Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë* e Astrit Bishqemit (“Sejko”, Tiranë 2001, botimi i tretë i plotësuar dhe i përmirësuar Universiteti “A. Xhuvani”. Dipartamenti i gjuhës dhe letërsisë, Tiranë 2008) më tepër është grumbullim të dhënash sesa histori e mirëfilltë e letërsisë për fëmijë si art i fjalës. Të bindesh për këtë mjafton të lexohen *Parathënia* e botimit të parë dhe *parathënia* e botimit të tretë. Autori i saj shkruan: “Botimi ynë ka destinimin e tekstit shkollor të arsimit të lartë me drejtim pedagogjik” (Botimi i tretë, f. 16). Po pse atëherë e emërton Histori të letërsisë për fëmijë? Cilat janë letërsitë e tjera për fëmijë të “*destinimeve*” të tjera?!

Duke sqaruar mënyrën se si e ka hartuar veprën e vet, duke shfrytëzuar disa ligjërata të tij të mbajtura në Institutin pedagogjik të Elbasanit dhe në Universitetin “A. Xhuvani” si dhe punimet e autorëve të ndryshëm që i paskësh shfrytëzuar në libër, Bishqemi shkruan: “[...] ai ende e ruan lehtë formën e kompilitimit e të konspektimit, domethënë është rezultat edhe i djersës së shumë studiuesve e kritikëve tanë. Këtu janë konspektuar dhjetëra e dhjetëra recensionet, është vjelur mendimi i kritikëve dhe i studiuesve tanë, që në njëfarë mënyre i konsiderojmë bashkautorë”. (f. 16).

Këto mendime ta zënë frymë, asgjë më pak.

Të mos e zgjatëm më shumë, po i kthehem titullit të punimit për të thënë se njëmend letërsia jonë për fëmijë ende është ndërjegjja jonë e pikëlluar, për të mos thënë e shëmtuar<sup>22</sup>.

Çka duhet të bëhet që një herë e mirë kjo gjendje të ndryshojë dhe letërsia jonë për fëmijë të ketë statutin dhe vendin që i përket brenda artit të fjalës, letërsisë që krijohet në gjuhën tonë shqipe?

Është detyrë që duhet të përballohet dhe të zgjidhet. Sa më shumë që të zvarritet e të vonohet pasojat do të jenë më të mëdha.

Nuk duhet të presim që këtë detyrë të na zgjidhin të tjerët e ne të vijojmë ta nëpërkëmbim, ta përbuzim e ta mohojmë letërsinë për fëmijë nga se nuk guxojmë të harrojmë se e përbuzim dhe e mohojmë veten tonë, të tashmen dhe të ardhmen.

Prishtinë, dhjetor 2023 dhe janar 2024

<sup>13</sup> G. Fanciulli, *Scrittori e libri per l'infanzia*. Società Internazionale, Torino 1973, f. 51.

<sup>14</sup> Shih Aldo Cibaldi, *Storia della letteratura per l'infanzia e l'adolescenza*, La scuola editrice, Brescia, 1967, f. 38. Shih dhe studimin tim *Poezia për fëmijë e Mark Krasniqit*. Studim monografik. Faik Konica, Prishtinë 2002, f. 27.

<sup>15</sup> Aldo Cibaldi, *Storia della letteratura per l'infanzia e l'adolescenza*, vep. e përm., f. 38.

<sup>16</sup> Luigi Santucci, *La letteratura infantile*. Con una conversazione fra Marcello Bernardi e l'Autore. Massimiliano Boni Editore, Bologna 1994, f. 7.

<sup>17</sup> P. Hazard, *Uomini, ragazzi e libri. Letteratura infantile*, vep. e përm., f. 47. Shih dhe Mark Krasniqi, *Mbështetje shkencore dhe përpjekje letrare*. Qëndrime e reagime IV. Prishtinë 1995, f. 253.

<sup>18</sup> P. Hazard, *Uomini, ragazzi e libri. Letteratura infantile*, vep. e përm., f. 53.

<sup>19</sup> Shih Luigi Santucci, *La letteratura infantile*, vep. e përm., f. 65.

<sup>20</sup> Shih L. Volpicelli, *Dall'infanzia all'adolescenza*. Brescia, La Scuola, 1952, f. 42.

<sup>21</sup> Shih librin tim *Veçanti të veprës letrare për fëmijë të Rifat Kukajt*. Argeta LMG, Tiranë 2020.

<sup>22</sup> Çështje më vete, për të mos them shëmtim, është fjala vjen, mos përfshirja e veprave të Rifat Kukajt, njëri ndër shkrimtarët tanë më të mirë për fëmijë të të gjitha kohëve, në programet shkollore në Kosovë dhe në Shqipëri.

Nuk e kam njoftë gjatë, por bacën Adem, Adem Gashin, e kam njoftë aq sa duhet me e njoftë dikë për me e pasë dëshirën dhe kënaqësinë e takimit me të. Aq sa mos me ia kthye cigaren, edhe pse ti nuk tymos. Aq sa mos me u kujtue se t'zuni e vona në biseda me të. Aq sa, nëse ke lanë takim në ora 12.00 me të, ti, edhe po qe se ke shkue 10 minuta para kohe, prap atë para teje aty e ke gjetë. Dhe mandej edhe aq sa me e ditë që, po pagove, duhesh me u idhnue fort me të.

Veç n'dy raste ia kam "kthye fjalën". As tash që s'asht ma, nuk jam pishman. Prap i them që nuk e ka mirë. Dhe nëse s'ka me e ndryshue mendjen ai, nuk kam me ndryshue qëndrim as unë.

E kam njoftë, bacën Adem, aq sa, me bisedat e gjata që i banim, herë te EDI 2 e herë te Kafe Z, m'dukej se ishim shokë. Shokë fort t'mirë, madje edhe motës. Ma mirë se kushdo, këtë e di, Emini. Emin Z Emini.

Sot, kur n'mjes e kuptova se e kishim humbë, u mërzi. Nuk qava. Nuk më rrodhi asnjë pikë lot. Nuk ishte baca Adem n'rend të dekës. U takuem fiks para një mueji, në festën e ditëlindjes të mikut të tij, Primos, dhe me gjithë atë vullnet e gaz që e bani, nuk mundesh mos me e përjetue si krejt të papritun largimin e tij.

\*

Para tre vjetve, mbas mbarimit Festivalit REPUBLIKA, të nesërmen, bashkë me pjesëmarrësit poetë të tjerë, shkuem në Bjeshkët të Opojës. U nisëm veç për një drekë e na zuni mesnata atje.

N'festën e ditëlindjes, pra para një mueji, m'tha: *Kur bre po na çon prap te ai vendi!? Belivalla knaqë jena. Auuu, çfarë shyhreti à ko. E paharrueshme ajo ditë.*

U përuddh baca Adem në një ditë të bardhë janari, bash sikur ajo e Bjeshkës së Opojës, tue e lanë veten t'strehuem mirë nëpër poezitë e tij.

\*

Cilën e lexoj unë, cilën aktori?

Të dyja shumë t'mira, por e dyta m'përloti. – Të dytën e lexoj unë pra.

Ishte poezia "Dita e parë dhe e fundit". Trupi morrnica krejt m'u ba kur e lexova. U përloa sikur shumë shpesh me vargun e tij.

...

Dhe Dita e parë, që domethënë, E fundit

Kur në fund të fjalisë dëftore vihet një Pikë (.) Dhe ti s'flet më, po flasin të tjerët për ty.

Ndoshta prandaj sot nuk qava.

\*

"Atje ka dhe një vend për varr. E kupton çdo të thotë një varr krejt i lirë në vendin tënd, midis tokës e

qiellit, ku të vizitojnë me radhë stinët dhe derdhen sipër lule bjeshke

## In memoriam ADEM GASHI

nga Vlora Ademi



të erëndshme dhe era e vendit tënd të pëshpërit në gjumin e përjetësisë: fli i qetë, im bir!"

Ky asht publikimi i tij, me 5 janar, njimbëdhjetë ditë para ikjes, fragment nga romani i tij "DITA TJETËR E JETËS".

Thonë se poetët parandjejnë. Sikurse ia kishte dallue n'fytërë ikjen e tij, miku tij, Primoja. E kishte pa me shumë vërejte, n'festë dhe mbas feste m'tha: Ia kam pa një vijë të verdhë Ademit sonte, si asnjherë ma parë. U tuta për te, Aulo.

Si duket edhe baca Adem e paska ndie ardhjen e moskthimit.

Jeta dhe veprimtaria e tij letrare kanë me mbetë kronikë e kohës, ashtu sikurse ai ka ditë me i krijue ato për veten.

Asnjherë nuk e fshehu shpirtin e tij prej liriku. Mbase as ai vetë nuk e di se sa poezi ka krijue deri tash. Madje një prej albumeve muzikore ma t'bukura "Lugina e dashurisë" e këngëtarit Ilir Shaqiri, e ka aurën e teksteve të Adem Gashit. Të përpjetave rë poezisë lirike ai u ngjitej me hap prej ujku.

*"Shprehjen artistike të Gashit e shquante lirizmi, i cili rrjedh nga paradokset e jetës individuale e shoqërore, duke vijuar me veprat e mëvonshme, ku dominon sinkretizimi*

*i formave të shprehjes artistike", shkruhet në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës*

\*

Me 2018-tën mbahet konkursi letrar KultStrofa në Prishtinë. Konkurent e kishte edhe mikun e tij të afërt, mbase ndër më të afërtit, Eminin. Në atë konkurs, baca Adem u vlerësue me vendin e dytë, por mbasi e kupton se vlerësimi me çmimin e parë i takon dikujt tjetër dhe jo Emini, ai çohet e reagon publikisht – Qysh asht e mundun unë vendin e dytë e Emini i pavlerësue!?

Ky ishte baca Adem. Nuk ka përtue me i dalë zot vlerave, të bukurës, të drejtës.

Në vitin 2022, ai nderohet me Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkrel" i cili ndahet nga Ministria e Kulturës në Kosovë. I fundit në të gjallë të tij.

\*

Asnjherë nuk i deshti urimet. Madje as fjalën falemnderit.

Në 58 vjetorin e lindjes së tij miq të shumtë e kishin urue. I zanë ngushtë, mbas disa ditëve, ai shkruen:

"Të çmuar e të dashur miq. S'ka shumë Kohë që më keni uruar ditëlindjen. I kam Lexuar një për një. Kam pasur kënaqësi të Rrallë, po nuk u bëra i gjallë. E dini pse? Nuk Më pëlqen fare shprehja "Falemnderit". E Çuditshme! Ngaqë nuk gjeta formulën që Dua, vendosa t'ju them: jam i lumtur që ju Kam borxh!"

Kësisoj largohen njerëzit si baca. Kësisoj largohen poetët si Adem Gashi.

Edhe unë jam e lumtun, që nuk i kam thanë të gjitha për të dhe, në njëfar mënyre, po i mbetem borxh.

16 janar 2024, Prishtinë



Foto nga Fahredin Spahija



Në kohën e shembjes së diktaturave, turren me vrap i madh dhe i vogël për të rrëfyer tmerret dhe ngjarjet që kanë përjetuar, në këtë mes, me një dozë të lartë të kritikës, shpeshherë të çoroditur, janë shkrimtarët të cilët përpiqen me mish e me shpirt të paraqesin edhe njeriun e revoltuar, siç do ta quante Kamy në eseistikën e tij. Ndoshta kjo është praktikë e mungesës së guximit të popujve të vegjël, por nganjëherë edhe të të mëdhenjve që ndrydhin lirinë e individit e të një shoqërie të tërë për shkak të tekeve herë-herë kanunore e grupe, duke mos reflektuar qenien shoqërore që mban vetëdije për veprimet e veta. Në një vend si Shqipëria që jo shumë kohë më parë doli nga zgjedha e kësaj ndrydhjeje të lirisë individuale e shoqërore duke krijuar më pastaj thyerje të normave shoqërore, prapë janë shkrimtarët të cilët do ta tmerrojnë lexuesin për gjendjen që kishte kaluar një popull i vogël brenda një karantine ideologjike, duke reflektuar mizori e gjithçka tjetër që mund të gjejmë në fjalorin e shqipes.

Rita Petro, të cilën më shumë e kam çmuar për vargjet poetike të guximshme, që rrahin me kamxhik pasivitetin shoqëror e shpeshherë pervers, por që kur iu shpalosen maskarallëqet, dinë të nxjerrin sy për lartësinë e moralit shoqëror, në vitin 2022, me shtëpinë e mirënjohur botuese Onufri nxori në letër romanin e saj *Lindur së prapthi*, apo siç do ta quante gjyshja nga babai i saj *Lindur anapodha*. Ajo tani provoi edhe një herë guximshëm sikur në poezi, të rrëfente për të vërteta që fshihen brenda shoqërisë e individit që mbahen për të moralshëm, por në veçanti mendja e tyre është aq fluturuese dhe e kobshme për të menduar me egon e mbushur me pislleqe. Tashmë në prozë, për lexuesin kemi për temë jetën e saj që nga lindja, pastaj fëmijëria, adoleshenca, që vështrohen dhe analizohen tani me mendjen e saj të pjekurisë. Ajo tani nuk vrapon pas ëndrrës, siç do të thoshte Borges kur analizon makthin dhe poezinë latine kur një lepurush ndjek një lepur tjetër, por një dëshpërim tjetër, që shoqëria duhet ta mësojë: se nuk ishte vetëm diktatura qendra e vëmendjes, kishte edhe tema të tjera po aq bizare e të shëmtuara, që mbulohehin, madje që mbaheshin për të virtytshme nga shoqëria.

Por çfarë ishte ky virtyt shoqëror që shkrimtarja Petro do ta manifestojë hapur duke tkurrur ekuivalencën drejt ligjit të Njutonit për të vënë në spikamë se çfarë është më saktë njeriu kur në mendje ndrydh cytjet e tij? Rita Petro ka personazh vetveten, lindjen dhe rriten e saj, të menduarit vjen me një soditje reale plot çiltërsi duke mos rrokullisur tema vetëm për shtetin brutal, por tema që rrokullisin individin dhe shoqërinë në një mjedis kur arsimitari me dije dhe veprim

## LINDUR SË PRAPTHI, PËR TË PRISHUR MAGJITË E SHOQËRISË

Nga Mërgim Bekteshi

mendon të ketë seks me nxënësen e vet apo kur ajo shpalo se çfarë ndodh me jetën e vajzës së re kur shfaqet puberteti dhe dëshira e fortë që nuk ka frenim apo edhe alternativë. Pra, vjen çasti, siç thotë Kamy te "Miti i Sizifit": duhet të zgjedhësh mes soditjes dhe veprimit, Zotit apo kohës, kryqit apo shpatës. Petro gjen ngushëllim më ndryshe, e vetëdijshme se edhe mund të therorizohet, por nuk e mban mendjen te lavdia. Ajo është vetvetja, gjithmonë e gjithnjë.

Lexuesi i devotshëm, kur lexon *Lindur së prapthi*, diçka që ka kaluar vetë në ato labirinte, sidomos gjinia femërore, ngjarje herë të pështira e herë me dozë të kënaqësisë, nuk duhet të frikësohet nga ndjenjat e përziera, sepse kur ndeshemi me arte te bukura apo, po e citoj Borgesin: *Ne ndiejmë poezinë ashtu siç ndiejmë praninë e një femre, ose fqinjërinë e një mali, a të një gjiri, tani, e përsëris, kjo nuk duhet të na frikësojë, janë të tjerët që bazën e moralit shoqëror e degradojnë në*

emër të moralit dhe pastaj po ata i bien fyellit me një vrimë, siç thotë George Orwell. Pra, zgjimi i gjumashit në emër të përparimit, krijon një dualizëm shpeshherë të çuditshëm që reflekton kritikë, kokëçarje e fyerje deri në palcë. Ndoshta këto barriera shoqëria nuk është mësuar t'i shohë me syrin e kritikut apo edhe si pozitive, por gjithmonë duke linçuar diçka si të përdalë. Ajo që nuk mund të stigmatizohet dhe gjykohet drejt pa një konkluzion të Hobbsit është e paprekshme kur reflekton te qenia homosapiens: që i forti nuk zgjedh mjete për t'ia arritur qëllimit. Në këtë pikë të diskutimit dhe distancimit kohor, Rita Petro lufton e vetme edhe si personazh në roman, po ashtu edhe si autore, shpesh ky guxim ka barrën e përgjegjësisë sikur barra e provës që kërkohet në gjykatë nga postulati romak *Më jep provat të jap të drejtën*, por kjo di të mos shkëlqejë, këtë autorja e reflekton me mjeshtëri, ta zëmë kur një poezi e saj e thurur me

mjeshtëri nuk mund të kalojë filtrat pa ngacmimin pervers të redaktorit të poezisë.

Shikuar në rrafshin letrar, romani ka një strukturë të menduar thellë, kemi prologun, pastaj për çdo titull ka një si parathënie që ndërlidhet me një etapë kohore, por fillimisht atë që mendon i rrituri ndërkohë që kujtimet hapërojnë dhe kthehen në kohën e fëmijërisë e rinisë dhe kështu vazhdon deri kur ndeshemi me epilogun. Kur flasim për gjuhën, Rita Petro i qëndron besnike standardit, edhe pse herë pas herë ka ndryshime të vogla dialektore që tregojnë njohuritë e saj gjuhësore. Temat e rrëfimit të mbajnë të lidhur, sidomos kur paraqitjet janë të çiltëra dhe rrëfohen pa asnjë fije dyshimi e ngurrimi. Rita Petro ka dëshmuar se nuk është mjeshtre vetëm në poezi, por edhe në prozë, temat që shtjellon akoma rrëqethin shoqërinë, prishin magjitë mashtruese të saj.



Lindur së prapthi

RITA PETRO

OnufriRoman

Gjatë punës kërkimore për dasmën në qytetin e Elbasanit, në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX, u ndesha me dy artikuj të shkruar nga Profesor Doja për ceremonialin e dasmës dardhë. Artikujt janë botuar në revistën "Kultura Popullore" të viteve 1986 dhe 1987. Në këta dy artikuj pashë një analizë shkencore të hollësishme. I lexova dhe rilexova të dy shkrimet. Nga mënyra se si ishin shkruar më bënë që t'a përjetoja dhe përfshihesha me emocione në këtë ceremonial. Më tërhoqën vëmendjen veçanërisht titujt e tyre. I pari: "Pasqyrimi poetik i zbukurimit në ceremonial të dasmës", kurse i dyti: "Poetika e zbukurimit në ceremonial të dasmës". Në pamje të parë të duket sikur janë e njëjta gjë, në fakt flasin për të njëjtën gjë, por në përmbajtje janë të ndryshme. Artikulli i parë "Pasqyrimi poetik i zbukurimit në ceremonial të dasmës", na tregon mënyrën e organizimit të ceremonialit, ambjentin në të cilën kryhet, pjesët përbërëse dhe ndikimi i tyre në këtë ceremonial. Këngët si pjesë e rëndësishme e ceremonialit dhe komunikimi i tyre me mjedisin dhe të sapomartuarit si mesazhe për jetën e tyre. Këta elementë tërësisht të vlerësuar në këndvështrimin filozofik. Artikulli i dytë "Poetika e zbukurimit në ceremonial të dasmës" ka si objektin të na japë aspektin estetik që kanë zbukurimet qofshin në ambjentin fizik, këngët, vallet apo ritet e ndryshme të dasmës dhe ndikimin në botën shpirtërore të njeriut. Parë në tërësinë e tyre elementët përbërës dhe interpretimi i tyre, na tregojnë dasmën dardhë në gjithë komponentët dhe dimensionet e saj.

Profesor Doja e nis artikullin me një përshkrim të kushteve fiziko-geografike të fshatit Dardhë, në rrethin e Korçës, të cilët kanë ndikuar në zhvillimet historiko-shoqërore. Fshati Dardhë, duke qenë në një reliev malor, zhvillimin ekonomik e kishte të kushtëzuar, kryesisht në blegatori. Janë pikërisht këto kushte, që rriten valën e emigrimit dhe përcaktuan rrugën e zhvillimit të fshatit dhe të krahinave juglindore e jugore të vendit. Në këtë kontekst edhe materiali folklorik i përdorur kryesisht nga Dardha dhe krahina e Devollit, do të shërbejë për nxjerrjen e përfundimeve që mund të vlejën deri diku edhe për zona të tjera të Shqipërisë Juglindore. Kjo jo vetëm si rezultat i afritë gjeografike që është mjaft i rëndësishëm, por edhe i këmbimit dhe tregtisë, i martesave dhe i së njëjtës histori zhvillimi në aspektet ekonomike dhe sociale. Kushtet natyrore kanë ndikim të padiskutueshëm në botën shpirtërore dhe jetën e njeriut.

Dasma nuk është një ceremoni e thjeshtë, që ka në qendër vetëm marrjen e nuses. Dasma është proces që zgjat në kohë, deri në kryerjen e plotë të të gjitha riteve dhe zakonëve. Profesor Doja bën një analizë të hollësishme dhe shkencore mbi këtë proces ceremonial. Ai e vlerëson dasmën si një proces të strukturuar mirë, mjaft kompleks dhe të përshkallëzuar. Këtë strukturë ishin të detyruar ta zbatonin me përpikmëri të zotërit e dasmës. Tre janë pjesët përbërëse të ceremonialit të dasmës: 1) zhvillimi hap pas hapi i ceremonive, riteve dhe praktikave dasmore, 2) këngët dhe 3) mjedisi në të cilin kryhet dasma<sup>1</sup>.

Gjithsesi, ndër të gjithë këto elementë, dy artikujt vënë në dukje për ceremonialin e dasmës, bukurinë reale, që është një bukuri e qenësishme e brendshme e saj. Sido që të jenë pjesët përbërëse të ceremonialit, dasma vetvetiu ka një bukuri të sajën, ajo pa tjetër është e bukur edhe sikur të mos ecë sipas programit. Në çdo përmasë që të kenë pjesët përbërëse të ceremonialit, në çdo shtresë shoqërore që ajo të zhvillohet ka brënda saj bukurinë reale, bukurinë e dasmës dhe bukuria reale e saj është vazhdimësia e jetës. Dhe kjo nuk ka diskutim. Krahas kësaj bukurie reale, dasma ka edhe bukurinë artistike, të bërë me dorë, që arrihet nëpërmjet zbukurimit të çdo elementi të ceremonialit dhe sigurisht, këngët dhe ritet e tjera që kryhen në të. Janë pikërisht këto, që e bëjnë të pashlyer në kujtesën e pjesëmarrësve dhe kanë një ndikim tejet pozitiv.

Profesor Doja i shpjegon në mënyrë të detajuar elementët rituale, materiale, poetike, muzikore dhe koreografike, si dhe ndikimin e tyre në ceremonial.

Banasa është vëndi kryesor ku kryhet ceremoniali, objekti i parë me të cilin ndeshin pjesëmarrësit dhe ku shfaqet efekti zbukurimor i dasmës. Për këtë arsye banasa është edhe objekti i parë i analizës. Banasa e zonës së Dardhës është kushtëzuar në radhë të parë nga relievi i thyer dhe për këtë banesat janë thaujse

1 Albert Doja, *Pasqyrimi poetik i zbukurimit në ceremonial të dasmës*, Kultura Popullore, nr. 2, 1986, f. 39.



# DASMA DARDHARE NË VËSHTRIMIN E PROFESOR ALBERT DOJËS

Nga Zhuljeta Kadilli

dykatëshe të tipit kullë. Fillimisht kanë qenë me përmasa të mëdha, prizmatike e të mbyllura. Duke qenë se kur ndërtoheshin shtëpitë të Dardhës nuk kishte arkitekturë të mirëfilltë, pra bënë pjesë në arkitekturën vernakulare, ndërtesat përveç konceptit të banimit kishin parasjth edhe konceptin e shtëpisë si strehë ritesh. Madhësia e dritareve p.sh. bënë të mundur që banorët të kenë mundësinë të shohin edhe ritet e ceremonitë të dasmave. Edhe oborri dhe kopshti me perimetër më shumë të gjerë se të gjatë, lejon edhe performancën e valleve tradicionale dhe hapësirës për të ftuarit. Me kalimin e kohës, banasa pësoi ndryshime arkitektonike me çardakun, ballkonin, qoshkun, të cilat i jepnin asaj bukuritë të rrallë. Këto banasa të mëdha, të vendosura në atë mjedis natyror e piktoresk të Dardhës, e bënin edhe më madhështore dasmën. Për këtë arsye kjo madhështi e banesave është përjetësuar edhe në këngët e ceremonialit të dasmës dhe banasa bëhej kështu pjesë e ceremonialit madhështor, imponant e monumental.

Pse ky përshkrim i banesës dhe lidhja me ceremonialin e dasmës? Sigurisht që banasa ka ballafaqimin e parë me pjesëmarrësit, njëkohësisht dhe impaktin e parë në psikologjinë e tyre. Sa më e bukur e madhe të jetë banasa, aq më të mëdha janë pritshmëritë dhe kënaqësia që ndjen kur e shikon. Kjo mendojë është arsyeja që autori e përshkruan në detaje banesën. Nga ana tjetër, banasa lidhet edhe me gjendjen ekonomike shoqërore. Ai që bën dasmën ndihet mirë kur shikon, që shtëpia ku ka dhënë vajzën, apo ka marrë nusen është e madhe, që do të thotë se dhëndri apo nusja janë në gjendje të mirë ekonomike. Kjo të krijon pozitivitet, kënaqësi dhe qetësi shpirtërore.

Në Dardhë si kudo në Shqipëri, vëreheshin dallime midis shtresave të ndryshme të shoqërisë, të cilat shprehen edhe në aspektin e përpunimit arkitekturor dhe zbukurimor, sidomos në mjediset e brendshme të shtëpisë. Dhoma e miqve, ku shijet estetike ishin më të dukshme, bënin diferencën midis shtresave të ndryshme të shoqërisë, në aspektin ekonomik e social. Banasa ka qenë problem në të kaluarën jo të largët. Gjithsesi



edhe tek këto shtresa shoqërore më të varfra kishte përpjekje të krijonin ambient të përshtatshëm për ceremonialin e dasmës. Cilado qofshin përmasat e shtëpisë, sidomos dhoma e miqve, zbukurohet për dasmë me shtroje të leshta të bukura.

Që shtëpia të ketë pamje festive nuk mjafton që ajo të jetë e madhe apo me vlera të veçanta arkitektonike. Gurët e gdhendur, tavanat e zbukuruar, musëndrat janë njëra anë. Këto janë pjesë e banesës. Për ceremonialin e dasmës ajo përgatitet në mënyrë të veçantë nga gratë dhe vajzat e shtëpisë shumë ditë përpara. Këtë situatë na e ka përshkruar me hollësi profesori deri në detaje. Ai e vlerëson zbukurimin e shtëpisë për dasmë si një nga domosdoshmëritë kryesore në zonën e Dardhës. Gratë nxirrin qilimat e velenxat në ballkon me të cilat tregojnë se këtu ka atmosferë festive. Madje shtroreshin qilima apo velenxa të reja, që ruheshin për këto raste, apo edhe të tjera. Këta qilima, velenxa, perde i kanë sjellë kurdoherë shtëpisë dhe ceremonialit një bukuri të rrallë dhe pamje të veçantë. Ky moment është paqruar edhe në këngët dardhëre<sup>2</sup>.

Një element tjetër që bie në sy gjatë përshkrimit të shtëpisë për dasmën, është flamuri në të. Bukuria e shtëpisë goftë kjo reale e kushtëzuar nga arkitektura apo edhe nga zbukurimet plotësuese për ceremonialin e dasmës, është njëra anë. Por, funksionin estetik më të veçantë e merr flamuri apo bajraku i dasmës. Flamuri ishte i kuq, me lule të bardha e ngjyra të tjera. Pavarësisht funksionit të tij në ceremonial, ai i shton bukurinë ceremonialit, sidomos kur mbahet nga ai që hap vallen e dasmës. Profesor Doja, ka bërë gjetjen e duhur për të na dhënë këtë element të veçantë të dasmës dardhëre, në kombinim harmonik me vargjet aq të njohura popullore që e himnizojnë këtë moment.

Prania e luleve në dasmë dhe përrendja e tyre në këngët e dasmës i shton edhe më shumë bukurinë reale të bërë me dorë ceremonialit. Lulja zbukuron këdo, nga oborri, kalin e dasmës, bajrakun, dhomën e nuses, pajën, duvakun e nuses, nusen, dhëndrin etj. Pamja e tyre, eleganca, aroma e këndshme i japin dasmës vlera të veçanta estetike, të cilat Profesor Doja me fjalën e tij i tregon të sintetizuara në bukurinë e tyre reale, ceremoniale dhe poetike.

Kënga është një tjetër përbërës shumë i rëndësishëm, në mos më i rëndësishmi i dasmës. Këngët që këndohen e paraqesin dasmën si një festë të madhe familjare. Në ceremoninë e dasmës ka ndonjë rit apo praktikë që që edhe mund të mos kryhej, por kënga merr përsipër të bëjë të pranishëm me detaje tërësinë e riteve dhe të transmetojë dasmën e plotë me madhësitë e saj ceremoniale. Këngët e dasmës në përgjithësi dhe ato dardhëre në veçanti, kanë elementë të rëndësishëm në përmbajtjen e tyre. Interpretimi që bën profesori për këngët e dasmës dardhëre, tregon se ato kanë një përmbajtje të pasur poetike, që i përgjigjen madhësisht ceremoniale të dasmës. Ato dallohen nga komunikimi fjalësor dhe mesazhet e qarta që japin. Këngët e dasmë sjellin një sasi të caktuar informacioni për aspekte të ndryshme të jetës në komunitet apo në bashkësitë e periudhave të mëparshme historike, nëpër të cilat është krijuar dhe është përcjellë ky lloj krijimi folklorik.

Këngët janë gjetur nga më të ndryshme në përmbajtje, që nga këngët për shtëpinë, për flamurin, ndarjen e nuses nga prindërit, lulet, pajën etj. Ato janë cilësisht ndër më të shumtat në folklorin tonë, ato shprehin një tematikë të gjerë nga disa aspekte të jetës, duke përcjellë kështu doket dhe zakonët në riteve e ndryshme dhe në anën tjetër, duke vënë në pah me nota realiste gjendjen e zhvillimit kulturor në një stad të caktuar të zhvillimit të tyre historik si dhe në ecurinë e tij të mëvonshme. Në të dy rastet Profesor Doja ka bërë përzgjedhjen e duhur të këngëve në dasmën dardhëre, që ato të përcjellin goftë informacionin për jetën apo edhe zakonët e ritet e damës.

Përmbajtja e tyre është sa emocionale aq edhe poetike. Në këngët e dasmës shprehen të gjitha bukuritë e dasmës dhe mesazhet për çiftin apo pjesëmarrësit. Poezia popullore e këngëve të dasmës si krijimtari artistike, jo vetëm pasqyrojnë vlerat e mjedisit të ceremonialit, por e ka futur të bukurën edhe aty ku nuk mund të shihet drejtpërsëdrejti. Autori analizon me hollësi mënyrën se si me forcën semantike të bukurisë fjalësore poetike, të harmonizuar konkretisht edhe me bukurinë plastike, pasqyrimet poetike të vlerave zbukurimore bëhen të plota e të qëndrueshme dhe, ndoshta konkretisht jo të pranishme, me një poezi e art aq të thellë, sa thua se e krijojnë sërishmi realitetin. Nëpërmjet këtyrë pasqyrimeve paraqiten përjetime estetike, që mjedisi vetë nuk i tregon drejtpërsëdrejti, nuk i zbulon, as i bën të diktohen me atë forcë që kënga i nxjerr sheshazi si realitet poetik.

2 Po aty, f. 46.

Në dasmë nuk mungojnë edhe këngët satirike, të cilat krijojnë situata humorit të veçanta gjatë ceremonive, duke shprehur edhe një aspekt kontradiktiv të marrëdhënëve shoqërore që varen nga faktorët ekonomik-socialë dhe që nuk mund të shprehen ndryshe veçse nëpërmjet satirës humoristike.

Sigurisht kjo përzgjedhje nuk është e rastësishme, sepse pas këtij teksti fshihet ndonjëherë ajo që është prapa ceremonialit. Gjithsesi, nga studimi vëmë re se këngët e dasmës janë të shumta dhe shprehin aspekte të jetës së popullit tonë. Me mjaft besnikëri ato japin doket dhe zakonet e popullit, në këtë rast të fshatit Dardhë. Janë këto këngë apo edhe të ceremonive të tjera që përcjellin brez pas brezi krijimtarinë popullore. Ato janë shprehëse të situatave të ndryshme, gjendjes shpirtërore dhe paraqitjes së botës reale. Në këngët e dasmës dardhare edhe pse shfrytëzohet çdo element, për t'iu nënshtruar pasqyrimit fjalësor, përsëri vendin kryesor e ze nusja. Pjesa më e madhe e këngëve i kushtohen nuses si figura qëndrore e dasmës. Ajo jo vetëm zbukuron dasmën por mban në këmbë edhe ceremonialin me hijeshinë e bukurinë e saj.

Edhe veshja e nuses dhe dhëndrit, që në fakt është një veshje festive, nuk ka kaluar pa u analizuar nga Profesor Doja. Ai jep në detaje efektin estetik që ka kostumi nga mënyra e qepjes dhe e punimit të tij. Me larminë e ngjyrave, të kombinuara në mënyrën më perfekte në pikëpamje estetike, me kombinime motivësh në qëndisje dhe qepje në forma të ndryshme i jepnin madhësi dasmës. Kostumi tradicional i dasmës për nusen e dhëndrin me elegancën e tyre krijonte një atmosferë festive në dasmë, krijojte gëzim e hare. Veshja, zbukurimi i nuses është çasti më i rëndësishëm, më prekës e më domethënës në të gjithë ceremonialin e dasmës. Veshja ka lidhje me një sërë veçorish, qofshin këto ekonomike- shoqërore apo edhe kulturore të popullit. Cilado të ishte gjëndja ekonomike e familjeve, për kostumin ceremonial të martesës të gjitha familjet do të ishin të gatshme të bënin çdo sakrificë, që fëmijët e tyre të kishin një të ri. Kjo ishte edhe çështje prestigji apo dinjteti për familjet e fëmijët. Pasqyrimet poetike dhe estetike që ka dhënë profesori në analizën e kostumeve të dasmës duket sikur i rimarrin vlerat edhe më shumë kur i lexon.

Kostumi tradicional i dasmës, ashtu si kudo, edhe në Dardhë, ishte në çdo rast varianti më i pasur dhe më i realizuar artistikisht si për nusen edhe për dhëndrin. Mënyra se si Profesor Albert Doja e ka analizuar projektimin poetik në këngët e dasmës kostumin tradicional, e bën ceremonialin e dasmës në Dardhë pjesë të trashëgimisë kulturore dhe historike.

Një vend të rëndësishëm në tërë ceremonialin e dasmës zënë ritet e ndryshme që zhvillohen gjatë ditëve të ceremonialit, të cilat kanë rëndësinë dhe domethënien e tyre. Kryerja e këtyre riteve e bën më interesante dasmën, sidomos për ato breza që nuk i njohin.

Një prej tyre ishte riti i thirrjes në dasëm të miqve, i cili kryejtë nëpërmjet thirrësve. Ata ishin fëmijë të vegjël, djem zakonisht, që me një plluskë me verë në dorë ku kishin lidhur borzilokun, qarkullonin në tërë fshatin, shtëpi me shtëpi, që të ftonin miqtë për dasëm. Simbolika në këtë rast është vera dhe borziloku. Në traditën e besimit ortodoks, së cilës i përket popullsia e Dardhës, kjo simbolikë ka një domethënie. Borziloku jo vetëm që ka aromë të mirë, por është edhe përbërës i vajit ortodoks. Vaji përdoret për të lyer të sapo pagëzuarit. Vera e cila ndodhet në plluskat që mbajnë fëmijët në dorë merr pjesë në përgatitjen e Hirit Hyjnor. Pra, midis bukës, ujit dhe vajit, vera është pjesë e përgatitjes. Kështu, natyra merr pjesë në shpëtimin e njeriut dhe elementet tokësore bëhen bartës të fuqisë së Perëndisë. Natyra dhe Fryma bashkohet në shpëtimin.

Kur lexon për këtë rit, ndjen emocion, jo vetëm për mënyrën, por për faktin se thirrësit janë fëmijë. Fëmijët janë shpresa e të ardhmes dhe vazhdimësi. Ata janë gëzimi i jetës. Është mjaft domethënës ky zakon. Në vetë përmbajtjen e ritit ka elemente estetike që e bëjnë edhe më të bukur ritin gjatë ceremonialit. Profesor Doja, ka ditur të japë me mjeshtri ritet e dasmës. Ai gjithashtu ka lidhur dhe harmonizuar të gjithë elementët e ritit dhe këtë e ka bërë mjaft mirë. Pikërisht këtë lidhje e harmonizim e ka bërë gjatë ceremonialit. Gjatë kremtimit të ceremonialit të dasmës ndodh edhe ritualizimi i pjesëmarrësve në ceremonial, nëpërmjet të cilit synohet përqasja sa më e plotë, përafrimi i realitetit me modelin e idealizuar. Ky proces nënkupton pikërisht veshjen me ngarëse të theksuar simbolike të çdo elementi të ceremonialit, duke bërë qëllim në vete simbolizmin. Simbolizimi përfshin të gjitha parametrat e shprehjes rituale, si personazhe, objekte, veprime dhe këngë. Në këto nivele kënga përmbush qëllimin pragmatik e simbolik. Pikërisht, nevoja për t'iu afruar modelit ideal përgjatë kohëzgjatjes së dasmës çon në estetizimin e realitetit. Harmonia dhe mjetet shprehëse bëjnë që çdo kremtim dasme të risjellë kuptimin e përvojave arkaike dhe të vetë riteve që konceptohen si një sistem unitar me njësitë e tij, me një strukturë të konsoliduar brenda sferës së besimeve në kohezion me sistemin e marrëdhënëve sociale.

Brenda kontekstit të ceremonialit një moment mbresëlënës është edhe ai i marrjes së nuses. Ky veprim është mjaft i bukur dhe me karakteristika të veçanta.

I pari është kali me arkën e pajës, që kishte të lidhur një shall në qafë. Pas tij ishin kuajt dhe mushkat e krushqve, samarët e të cilëve, ishin mbuluar me qilimka të kuqe. Në këtë rit, më kryesori ka qenë kali i nuses dhe dhëndrit. Këta zbukuroheshin me velenxe të kuqe dhe shalle me ngjyra në qafë. Ngjyra e kuqe është gëzim, hare, kurse ngjyrat e shallit shprehin natyrë të harseshme. Pasqyrimi estetik i këtyre zbukurimeve nxjerr në pah përjetimin e ndjenjave në atmosferën entuziaste dhe të bukur të krijuar gjatë marrjes së nuses<sup>3</sup>. E bukur është fenomeni estetik më i përhapur, më i pranishëm në këtë moment. Gjithashtu është fenomeni estetik më i kërkuari ndërmjet dukurive të tjera



Profesor Albert Doja

estetike, jo vetëm në dasëm, por gjatë gjithë jetës.

Në të gjithë atë ceremonial të madhërisëm, profesori nuk ka lënë pa përshkruar edhe natën e parë të martesës, apo natën e gjerdekut. Mbyllja e nuses me dhëndrin është finalja e dasmës. Pa dhënë shumë shpjegime për këtë rit, mënyrën e zhvillimit në zonën e Dardhës, profesori e shoqëron me një projektim poetik dhe tregon se si ky moment sublim shoqërohet nga këngët popullore të rastit.

Ky projektim poetik, i hedhur në vargje e i shoqëruar me muzikë, jep vlerat plastike të shtëpisë dhe të shtrojeve të saj si mjete figurative poetike, për të shprehur përjetimin estetik të ndjenjave dhe të gjendjes shpirtërore të tensionuar. Situata është e tensionuar dhe emocionale, të sapomartuarit të nesërmen e kësaj nate, marrin një status të ri në shoqëri. Ceremoniali i dasmës është një nga momentet më interesante për sa i përket vlerave estetike.

Në vallet, këngët e meloditë me vegla muzikore, në veshjet e stolitë, në gjithë përgatitjet për të bërë një dasëm sa më madhështore, dëshmoher temperamentin e banorëve të vendit, botëvështrimi i tyre mbi jetën, dashuria për të, dëshira për të filluar jetë të re. Struktura organizative e dasmës paraqet një shtrirje kohore, e cila, e vështuar në diakroni, ka relativitet të dallueshëm. Por edhe në sinkroni, dasma vijon të mbetet ngjarja më e bukur e jetës zakonore shqiptare, që zakonisht ka vëmendjen kryesore në ritualet shqiptare. Kjo është vlera e këtyre artikujve, që tregojnë ndërthurjen harmonike të elementeve të ndryshme të ceremonialit të dasmës (materiale, rituale, simbolike, poetike etj.).<sup>4</sup>

Në përfundim të kësaj analize do të vlerësoja dy artikujt e Profesor Albert Doja, të cilët nuk i gjeta të përfshirë në bibliografinë e plotë të botuar nga Instituti i Antropologjisë në ASA, në numrin e fundit nr. 5 2022, të revistës shkencore të titulluar "Antropologji". Artikujt duhej të ishin përfshirë, pasi nga viti 1980 deri në 1990, janë vetëm katër artikuj për dasmën dhe martesën në bibliografinë e botuar. Kjo sigurisht që e bën më të domosdoshme, pasi katër artikuj për dhjetë vjet janë shumë pak, që do të thotë se studimet në këtë fushë kanë munguar dhe ka nevojë për to. Përveç kësaj mendoj që, nga pikëpamja shkencore janë artikujt më të realizuar. Mungesa e këtyre artikujve në bibliografi tregon më së paku neglizhencë dhe më së shumti çensurim apo mungesë dëshire për t'i përfshirë, mbase pse jo edhe vetë profesorin apo emrin e tij. Përfshirja e tyre jo vetëm që do të shtonte informacionin dhe tregonte mënyrën e analizës për dasmën, por do i bënte nder bibliografisë dhe do i vinte në ndihmë edhe studiuesve të rinj. Ata do të mësonin.

Pse duhet të lexohen këta artikuj sot. Leximi dhe risjellja pas gati dyzet vjetëve ka arsye. Dhe arsyeja e parë është vështirimi i tyre në një kontekst të ri kohor. Sot në Shqipëri ka ndryshuar çdo gjë, qoftë në aspektin politik, ekonomik, social, apo kulturor. Shoqëria shqiptare është në një periudhë të përplasjes midis traditës dhe modernes. Gjithsesi, duket se këta artikuj i qëndrojnë kohës mirë edhe sot, madje edhe ballafaqimeve kulturore. Dhe kjo është mjaft për t'u vlerësuar. Profesor Albert Doja, dasmën Dardhare e ka dhënë në shumë dimensione, duke e parë si proces. Në këtë proces kulturor harmonik përfshihen njëherazi mediji ceremonial, ritet e ndryshme që kryhen gjatë saj, veshjen, stolisjen, lulet, këngët, vallet, urimet etj. dhe sidomos ndikimi që ka tek pjesëmarrësit.

Metodologjia e ndjekur është tërësisht e mbështetur mbi parime shkencore. Fillimisht mendoj profesori ka hartuar

skemën në të cilën do të mbështetej për të shkruar artikujt. Më pas është konsultuar me literaturën që ka ekzistuar dhe më kryesorja ka bërë kërkime në terren. Literaturën e ka parë në një qasje tërësisht shkencore. Kërkimet në terren janë bërë për periudha të ndryshme. Të gjithë këtë material të grumbulluar profesori e ka interpretuar në një qasje tërësisht filozofike, antropologjike dhe psikologjike. Gjithashtu ka bërë vlerësim të elementëve estetike të dasmës dhe ndikimin e tyre tërësisht pozitivë në jetën e njeriut.

Të gjitha këto, së bashku me interpretimin shkencor të dukurive në ceremonial i japin këtyre artikujve vlerë të padiskutueshme. I tërë punimi ka si bosht parimet filozofike, estetike, të bukurën në shoqërinë njerëzore. Asgjë nuk është rastësore, gjithshka e ka një shpjegim dhe një mesazh. Kjo e bën interesante dhe i shton vlerën artikujve. Për kohën kjo metodologji ka qenë mjaft e përparuar. Në studimet e tij është udhëhequr nga parimet shkencore të antropologjisë kulturore, estetike dhe poetike, pavarësisht kohës kur janë shkruar.

Elementi i parë në këtë shkrim është prezantimi me natyrën e Dardhës, që ndikon edhe në ceremonialin e dasmës. Bukurinë e natyrës e ka ndërthurur mjeshtërisht me këtë ceremonial duke i dhënë madhësi dasmës. Fshati Dardhë është i pasur me komplekse të bukura natyrore, atraktive dhe me natyrë magjepsëse. Gjithashtu ky fshat paraqet një thesar të pasur të trashëgimisë kulturore, materiale e shpirtërore gjatë periudhave të ndryshme historike.

Elementi i dytë i përshkruar në detaje është banesa e cila mbart ngarkesën kryesore në të cilën zhvillohet ceremoniali. Ajo jepet ashtu siç është, me të gjithë elementët përbërës të saj.

Pjesën kryesore në të dy artikujt e ze ceremoniali i dasmës, të cilën e zhvillon me aq dashuri dhe emocion. Këndvështrimi nga i cili e shihet këtë eveniment është ai estetik dhe poetik.

Edhe ritet përbëjnë një nga momentet e rëndësishme në ceremonial. Ato i japin realisht elemente të traditës dasmës që në thelb janë pjesë e identitetit.

Duhet të pranojmë se profesori ka pasur edhe vështirësi gjatë punës për shkrimet e tij. Periudha kur janë shkruar artikujt ka pasur mangësi të literaturës së huaj apo shqiptare. Literatura e huaj nuk lejohej, ose kishte fare pak, dhe jo e lehtë për t'u gjetur. Këtë mangësi është përpjekur ta plotësojë nëpërmjet gjetjeve në terren dhe interpretimit të tyre me aq mjeshtri dhe kulturë. Vështirësia tjetër qëndronte edhe në interpretimin e literaturës apo gjetjeve në teren, që kërkimin mjaft kujdes. Sa i takon studimeve shqiptare, për këto probleme ishin të pakta.

Atë literaturë që profesori ka patur në dispozicion e ka parë në një qasje tërësisht shkencore, i zhveshur nga ndikimet dhe paragjykimet politike të kohës. Nuk gjejmë asnjë referencë të literaturës politike apo dokumenteve të Partisë së Punës dhe udhëheqësit të saj. Ky qëndrim, jo vetëm ka qenë tejet i guximshëm, por flet edhe për formimin shkencor të autorit. Pra, nuk e ka ngatërruar shkencën me politikën. Në një nga këngët e përzgjedhura nga profesori tregohen edhe dallimet ekonomike midis personave që martoheshin. Ata mundet të vinin nga familje me diferenca në aspektin ekonomik. Këtë e ka bërë për të qenë i vërtetë dhe për të treguar dasmën dhe shoqërinë ashtu siç ishte. Konkretisht: "...un' do të marr se ke dyqan, e çdo muaj më bën fustan, un' do të marr se kam zili, më mban qostekne larë flori. Më mban unazë gur xhevahir, un' do të marr se ke shtëpi, e do më bësh shumë stoll"<sup>5</sup>. Vendorsja e këtyre vargjeve është guxim. Jemi në komunizëm ku supozohej se nuk kishte dallime klasore. Apo përmendja e qostekëve prej floriri dhe unazave me gurë xhevahiri, që ishin sinonim i borgjezisë, gjithashtu duhet vlerësuar. Partia trumbetonte se njerëzit ishin të barabartë, nuk ka pronë private (dyqan) etj. Kjo ishte kënga. Ajo nuk duhej dhe nuk u tjetërsua nga profesori.

Për të qenë të drejtëdrejtë në atë kohë gjejmë mjaft artikuj të profesorëve dhe autorëve të ndryshëm për këtë problem. Ka punime të cilat e shohin dasmën në të gjitha dimensionet, por ka edhe që shohin elemente të veçantë të saj. Gjithsesi këto janë zgjedhje personale. Krahas vlerësimit nuk mund të lemë pa përmendur edhe disa problematika, që bëjnë diferencën me artikujt e trajtuar. Në këto artikuj janë referuar dokumente të Partisë apo fjalime të Enver Hoxhës. Të krijohet bindja sikur orientimet në këto dokumente janë këndvështrimi nga i cili janë nisur për të trajtuar problemin. Konkretisht në një artikull të botuar në vitin 1980, shkruhet: "Tani nusja shkon në shtëpinë e burrit pa duvak, por fytyrëzbutume, e veshur thjesht e bukur. Madje, në ato krahina ku ka kostume popullore ajo vishet me to, duke ruajtur traditën pozitive të popullit tonë. Duke folur për këtë problem shoku Enver ka thënë: "Po çfarë na prish ne dëshira e një vajze, që kur martohet do të veshë një kostum të bukur popullor...?"<sup>6</sup> Pse duhej referuar Enver Hoxha, a nuk mund të shihej ky ndryshim si rezultat i emancipimit të shoqërisë dhe tendenca për të përkrahur të renë? Sigurisht që nuk dua të paragjykoj asnjëri, pasi ashtu ishte koha, duhej patjetër të kishë si referencë dokumentet e Partisë dhe shokut Enver në punimet shkencore, por ama vlerësoj edhe ata studiues që me kurajo dhe guxim nuk i referonin dhe i shmangën ato, gjë që mund të kishte edhe pasoja.

Mund që edhe redaksitë e revistës të mos e pranoin punimin pa këto referenca, por fakti tregon se, kur artikujt ishin të arrirë nga pikëpamja shkencore redaksia mund t'i pranonte. Niveli shkencor mund të shmange çdo përpjekje për politizim. Jo vetëm kaq, por në mjaft raste, janë paraqitur si zhvillime pozitive të dasmës gjatë periudhës së socializmit disa dukuri të reja. Tek këto dukuri përmendim, thjeshtësinë e

<sup>5</sup> Albert Doja, *Poetika e zbukurimit në ceremonialin të dasmës*, Kultura Popullore, nr.1, 1987, f. 142.

<sup>6</sup> *Dukuri të reja të ceremonialit të dasmës pas çlirimit dhe lufta kundër zakoneve të vjetra*, Kultura Popullore, nr. 2, 1980, f. 81.

<sup>3</sup> Albert Doja, *Pasqyrimi poetik i zbukurimit në ceremonialin të dasmës*, Kultura Popullore, nr. 2, 1986, f. 44.

<sup>4</sup> Albert Doja, *Poetika e zbukurimit në ceremonialin të dasmës*, Kultura Popullore, nr.1, 1987, f. 138.

# Botohet në arabisht romani "Dëmtuar gjatë rrugës" i Besnik Mustafajt

Përktheu dhe përgatiti:  
Fatrilit Beqiri

Botohet në arabisht romani i Besnik Mustafajt "Dëmtuar gjatë rrugës", fitues i çmimit të madh të panairit të librit të Tiranës në vitin 2019. Romani është botuar nga shtëpia botuese Dar Al-Hiwar me titullin "Në emër të amës dhe të birit", me përkthim të Adnan Mohamed nga frengjishtja.

Pas botimit të "Një sagë e vogël" dhe "Daulla prej letre" dhe pritjes shumë të mirë që gjetën si nga mediat edhe nga lexuesit arab, kjo është vepra e tretë në prozë e Besnik Mustafajt që shkon përkthehet në arabisht.

Ndërkohë, për romanin "Dëmtuar gjatë rrugës" (Në emër të amës dhe të birit) ky është përkthimi i parë në një gjuhë të huaj. Përkthimi i tij ka përfundur edhe në italisht dhe është në përgatitje botimi që parashikohet të dalë në prill po me titullin "Në emër të amës dhe të birit".

Botuesi Dar Al-Hiwar në kopertinën e pasme të botimit ka shkruar:

"Romani "Në emër të amës dhe të birit" (Dëmtuar gjatë

rrugës) i shkrimtarit të madh shqiptar Besnik Mustafaj na tëheq në thellësitë e shpirtit njerëzor në të gjitha shpërfaqjet e tij: të dashurisë, të shqetësismit dhe të privimit, të shpresës dhe të frikës që i kapërcen kufijtë e tmerrit, në një periudhë të gjatë të historisë moderne të Shqipërisë. Dhe këtu kam parasysh periudhën e sundimit komunist, e cila ka zgjatur nga fundi i luftës së Lufta e Dytë Botërore deri në fillim të viteve 1990.

Ky roman pasqyron transformimet e përjetuara nga heronjtë e rrëfimit: nëna, gjyshi, bashkëshorti që mungon, por që është i pranishëm pothuajse gjatë gjithë kohës dhe fëmija (rrëfyti). Këta njerëz të thjeshtë jetojnë në një qytet të vogël përgjatë kufirit shqiptaro-jugosllav.

Shkrimtari preferon që këta heronj të mos kenë emra, por rrjedhshmëria e rrëfimit, me intimitetin e vetës së parë njëjës, na bën të harrojmë nevojën për t'u njohur me emrat e tyre.

Ndoshta suksesi i shkrimtarit bëhet më i dukshëm në vazhdimësinë e rrëfimit pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri.

Fëmija rritet dhe bëhet zyrtar i lartë në regjimin e ri, dhe më e rëndësishmja, ai bëhet shkrimtar. Ndaj nëna e tij e ngarkon me detyrën e shkrimit të historisë së jetës së saj, për asgjë më shumë veçse të provojë identitetin e saj në sytë e të shoqit, që nuk e kishte vlerësuar siç duhet. Ne, lexuesit, nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta falënderojmë për këmbënguljen e saj, pasi kështu kemi përftuar një roman të paharueshëm me të gjitha standardet.

Në botimet Dar Al-Hiwar do të gjeni edhe romanin jashtëzakonisht të rëndësishëm "Daulla prej letre" të vetë romancierit Besnik Mustafaj.

(Vijon nga faqja 11)

ceremonialit, heqjen e disa riteve, duke u konsideruar si zakone prapanike etj. Gjithashtu nuk harrojmë disa risi në ceremonial, që nga ngritja e dollisë së parë për Partinë dhe udhëheqësin e saj, heqjen e fustanit të bardhë të gjatë të nuses, zvogëlimin e pajës, daljen menjëherë në punë të nuses etj. Këtyre fenomeneve madje edhe u është kënduar dhe të kundërtat janë quajtur mbeturina mikroborgjeze. Pikërisht këto "të reja" nuk i gjejmë të pasyruara tek artikujt e shkruar nga Profesor Doja. Ceremoniali i dasmës është përshkruar siç ishte. Kjo bën diferencën dhe sot ia rrit vlerën këtyre artikujve. Ajo është realitet i vërtetë.

Sot ka shumë punime, libra, artikuj që janë shkruar për rritet dhe traditat në dasmat në Shqipëri. Janë punime të cilat meritojnë të vlerësohen. Të tillë mund të përmendja monografinë e Dr. Albana Velianj, Rite e Simbole në Dasmën Tradicionale Shqiptare, botuar në 2017.

Pas viteve 1990 autorët kanë pasur lehtësira për të shkruar. Literatura si e huaj dhe shqiptare gjendet pa vështirësi. Gjithashtu ka ndryshuar edhe këndvështrimi i problemeve apo interpretimi i tyre. Liria akademike i ndihmon studiuesit. Në studimet e sotme, në jo pak raste vemë re se nuk trajtohen disa rite që u krijuan në kohën e komunizmit. Edhe këtu mendoj se ka shmangje nga e vërteta. Duam apo nuk duam disa gjëra kanë ndodhur dhe janë pranuar nga populli. Ato janë pjesë e historisë dhe kulturës sonë shpirtërore. Të tillë mund të vlersojë edhe artikujt e Genc Lekës<sup>7</sup>. "Doke të martesës në Bërzeshtë (Librazhd)", ku na jepet një informacion mjaft i bollshëm për disa zakone të martesës. Aty nuk analizohet dasma si ceremonial. Informacioni fillon me përpkjektet për lidhjen e krushqisë, kushtet midis familjeve, raportet midis të rinjve etj., deri tek dasma.

Ai jep disa zakone të cilat e shpesh-herw e bënin të pakëndshme martesën. Ja si shprehet autori: "Sidoqë në të kaluarën e largët zakonet e dasmës ishin të tilla që e bënin atë më tepër një ngjarje formale, sesa të gëzuar, nga që shtypja dhe ndrydhja ishin shumë të rënda, po të vërejmë këngët lirike të dasmës, kuptojmë se dëshira për fejesë dhe martesë të gëzuar ka qenë shumë e madhe tek të rinjtë"<sup>8</sup>. Autori ka tendencë, që të mbajë edhe qëndrim ndaj disa dukurive apo riteve tradicionale, të cilat po zhdukeshin dalëngadalë, madje pajtohet me ndryshimin. Ajo që të bie në sy është fakti që, autori i sheh disa rite si zakone të "vjetra", të cilat pengojnë frymën e re në procesin e martesës.

Ky është dallimi me shkrimet e profesorit, i cili na jep edhe rite të dasmës Dardhë, që kishin qenë para Shpalljes së Pavarësisë, apo Luftës së Parë Botërore, ashtu siç kishin qenë. Ai nuk vlerëson rite "të reja" apo "të vjetra" të dasmës. Profesori e sheh dasmën si ansambël ritesh dhe zakonesh, të cilat tregojnë kulturën materiale dhe shpirtërore të zonës së Dardhës. Gjithashtu e sheh dhe e vlerëson edhe në kontekstin historik

Shpjegimi i dukurive në disa nga këto punime të autorëve të tjerë ka qenë i mirë, por ka munguar vlerësimi estetik dhe poetik i ngjarjeve. Gjithashtu ka munguar analiza antropologjike e disa riteve të cilat nuk ndodhnin rastësisht në ceremonial. Kjo ka bërë që kur i lexon merr njohuri, por nuk kupton cila është domethënia e riteve që zhvillohen aty, si dhe nuk ndjen asnjë emocion. Mesazhet dhe ndjesitë, emocionet janë ato që përçohen gjatë leximit.

Me artikujt e shkruar nga Profesor Doja ndodh e kundërta. Aty merr dhe njohuritë dhe emocionin hap pas hapi për të gjithë ceremonialin. Kur i lexon ndjen një kënaqësi të brëndshme, përfshihet në ceremonial, madje të duket sikur i jeton ato çaste. Ndjen nostalgji.

Dasma e paraqitur është sa magjike aq dhe e fisme dhe këtë ai e ka bërë me pasion. Dasmën, me të gjithë elementët përbërës, e ka kthyer në institucion. Sipas përshkrimit, është dashuri, këngë, valle, bukuri, lule, nuse, dhëndër. Këto janë fjalë kyçe me të cilat parakuptohet dasma si ceremonial. Nga dasma tradicionale profesori nuk ka hequr asgjë, nuk ka bërë as më të voglin retushim. Aty shkruhet edhe për rite, të cilat pas 1967, në emër të revolucionarizimit të jetës, me vendim të Partisë, thuhet ishin hequr fare. Ai e ka dhënë dasmën me vërtetësinë dhe realitetin e saj në kohë dhe hapësirë, në të tërë përmbajtjen. Në atë periudhë të trazuar, të mpirë dhe të vështirë, leximi i këtyre artikujve krijonte një ndjenjë të bukur dhe të gëzuar, të jepte emocion, për të cilin kishte nevojë shoqëria jonë.

Dasma e paraqitur në artikujt e Profesorit, duhet të jetë pjesë e trashëgimisë kulturore të Dardhës e zonave përreth. Mënyra e paraqitjes së saj është sa filozofike aq dhe e thjeshtë për t'u kuptuar.

Në këta artikuj gjen koherencë dhe rrjedhshmëri në të shkruar. Ka fjali dhe frazë të plotë dhe melodioze. Janë punime tërësisht origjinale. Ato mund të shërbejnë si referencë për studiuesit e rinj. Artikujt janë shkruar të rreth 40 vjet më parë, por duket sikur janë shkruar me dijet dhe përvojën e sotme, me mendësinë dhe mundësitë e sotme. Këta artikuj tregojnë mënyrën se si organizohet një studim kërkimor mbi baza shkencore, por edhe si krijohet një vepër arti, apo krijimin e të bukurës nëpërmjet fjalës. Unë mësova.

Zhuljeta KADILLI

Diplomuar në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, dega Histori Gjeografi në vitin 1983. Në vitin 2008 ka marrë gradën shkencore "Doktor". Në vitin 2014 ka marrë titullin "Profesor i Asociuar". Nga viti 2000 deri në vitin 2022 ka qenë pedagogje në Universitetin "Aleksandër XHUVANI" Elbasan. Nga viti 2022 pedagogje në Kolegjin Universitar "BEDER" Tiranë.

<sup>7</sup> Genc Leka, *Doke të martesës në Bërzeshtë* (Librazhd), Kultura Popullore, nr. 1-2, 1993, 1-2, 1994.


<sup>8</sup> Po aty.

بسنيك مصطفى

.. باسم الأم والابن

ترجمة

عدنان محمد



Me Feim Ibrahimin jemi njohur herët, në vitin e largët 1967-1968, kur, edhe pse fëmijë apo të rinj, shijuan filmin e bujshëm *Ngadhënjim mbi vdekjen*.

E kujtoj filmin. Dy vajzat bukuroshe, por trime, në film kishin emrat e heroinave, por artistet në jetë ishin dy aktore të reja dhe të bukura: Edi Luarasi dhe Eglantina Kume. Skenat dhe skenari i filmit na trimëronin, por edhe ndienim keqardhje dhe dhembje për ata që dhanë jetën e tyre të re për lirinë e vendit tonë.

Nga fillimi e deri kur dolën titrat, skenat e filmit, episodet dramatike dhe vdekja e heroinave shoqëroheshin nga një muzikë ndër më të bukurat e dekadave të Kinostudios "Shqipëria e Re" dhe kompozitori ishte një djalë i ri, i sapodiplomuar, në të tridhjetat, i dashuruar me një studente shkodrane, Vera ishte emri i saj, si luleborë e oborreve të qytetit verior, që me Argjironë ishin si dy motra kështjellore.

Dhe vitet kaluan... kaluan.

Po tingujt ç'u bënë? Ata u shumuan, morën trajtën e një lumi që rrjedh sa në këngë sa në ligjërimi, sa në vepra madhore e sa në gjini të ndryshme të muzikës serioze, vokale e simfonike, në vepra skenike, në muzikë filmash e, jo pak, në vepra orkestrale, në muzikë dhome, në vepra pianistike. Me pak fjalë, çdo gjë që është muzikë në tabanin kombëtar e deri tek ajo që është e palëvruar te ne, muzika elektroakustike (1994).

Të gjitha këto ishin veprat e kompozitorit Feim Ibrahimit, i pari nga plejada e kompozitorëve të mëdhenj të vendit tonë që u diplomua në Konservatorin e Tiranës me pedagogun e tij, edhe ai i muzikës së epërme, Tish Daija. Miqësia e tyre në vijim do të ishte e gjithkohshme.

Po *Vikama e tingullit* muzikë është? Vërtet është muzikë e një letërsisë të paparë deri më sot, e shkruar në librin me të njëjtin titull nga e shoqja e kompozitorit, dedikuar, siç thotë ajo, për Etrin dhe Mattia-n, shkruar në dy kohë: *Bleni I* në kohë të trishta (1997-1999) dhe *Bleni II* në kohë kovidiane (2020-2022). E pikërisht *vikama*, një britmë nën zë shkruar në një libër jete, dedikuar jetës së saj me Feimin dhe për Feimin.

Ky zhanër i letërsisë njih shumë raste kur bashkëshortët e famshëm shkruajnë për jetët e tyre kur ata humbin para kohe njëri-tjetrin dhe ndajnë fatet e jetës së tyre me publikun për të cilin kontribuuan dhe u shkruanë me veprën e tyre.

Unë po shkruaj, pasi gjatë këtyre viteve, veçanërisht pas viteve 2000, kohë kur fatkeqësisht e patëm humbur kompozitorin Feim Ibrahimit dhe siç ndodh *postmortem*, shtohen aktivitetet për t'i rijetësuar veprat e tij edhe si homazh, por edhe si përgjegjësi qytetare dhe shtetërore, edhe si ridimensionim i vlerave mjeshtrërore kompozicionale dhe muzikore, njerëzit e vlerë pas vdekjes jetojnë jetën e dytë, atë të përjetshmen.

Kështu ndodhi e do të ndodhë gjithmonë me njerëzit e mëdhenj, me Feimin e me të tjerë të brezit të tij.


*Vikamën* e parë e pata humbur, të dytën e prita me padurim, edhe pse isha informuar se ajo do të promovohet në Panairin e Librit 2023.

Ishte 10 nëntor 2019, Katedralja Ortodokse, salla e bukur e saj, në hyrje një afishe e madhe "PEIZAZHI I PYLLIT TË RRALLUAR" (Romanca dhe këngë), portreti i bukur i Feim Ibrahimit dhe firma e tij, shkruar pjerrtas, që në sytë e mi erdhi si nota solfezhi, si shkallë në pentagram. Më çuditi kaligrafia dhe e ruajta në memoriën time pa e ditur se ai e përdorte gjithkund ku donte të vuloste fundin e kompozimit në fletët muzikore; nënshkruante letra dhe korrespondenca, artikuj shtypi, CV-në e vet, e mandej të gjitha i pashë te *Vikama*.

Unë isha në koncert, e dija se do të ishte festë, por nuk e dija se pas pak ditësh do të dridhej vendi ynë nga një termet i fuqishëm dhe pak muaj më pas një pandemi kovidiane do ta gjunjëzonte botën. Por Zoti është i madh, e deshi Feimin në atë koncert, për publikun dhe për vete.

# Vikama e tingullit – një kreshendo dashurie

Nga Leonard Qyteza



Në sallë, pas shumë vitesh, takova një burrë të bukur, të veshur shik si gjithmonë, një nëpunës të lartë shteti – kryetarin e dikurshëm të Shkodrës në vitin 1983, kohë kur e njoha unë dhe ai më promovoi në detyrë. Ishte Nesip Ibrahimit, kushëriri i parë të Feimit. Aty bëra lidhjen pse këta dy burra, në ato vite, visheshin shik, me modë jo të ndaluar, me flokët e zinj që dukeshin se i kishin të njëjlojtë, krehur lart, jo kaçurrelë, gjirokastroit të fisëm, nga familje me zë të madh, të edukuar e të shkolluar.

Te *Vikama* mësova se të atin e Feimit fëmijët e thërrisni me fjalën "zotërote", çka tregon një rregull gati aristokratik të kohës së paraluftës.

Sa i përket koncertit, për mua, i gjithë programi ishte një manifestim artistik, një punë e përkushtuar, një impenjim i të gjithë artistëve, por ajo që më "goditi" në një mënyrë befasuese ishte vepra e Feimit *Dialogo per violoncello e pianoforte*, interpretuar nga Etrita dhe një violonçelist i ri plot talent.

Nuk e dija kohën e kompozimit dhe frymëzimin e autorit, por Etri tregoi klasin e saj të lartë interpretativ, një lojë virtuoz, me shpirt, me nerv, me zemër, me gjithë trupin, në stol dhe duke "picikatur" kordat e pianos, duke na dhënë tinguj ibrahimianë që rrallë mund t'i kapë veshi.

Atë natë nuk kisha dijeni për *Vikamën*, por tani pas leximit e mësova dhe e kuptova lojën e "birit". Vepra ishte shkruar enkas për Etrin, kur ajo u bë nuse, ishte dhuratë e babait për bijën, e kishte titulluar *Dhuratë martese* dhe mbeti vepra e fundit e tij, mbeti

dhuratë gur i çmuar.

Librin *Vikama e tingullit* e mora me dedikimin nga Vera: "Teutës dhe Leonardit, për respektin dhe dashurinë e gjithmonshme ndaj Feimit – Tiranë, 10.12.2023" dhe siç ndodh me librat e bukur, që i pret me kureshtje dhe vetëdije se do të plotësojnë dëshirat dhe dituritë e tua, vura ditën kur ta mbaroj. Në fletën e fundit, që ka numrin 278, shënova: "Fundit i leximit, 25 dhjetor 2023 – krishtlindje."

Pas kësaj, mora kohë për të vendosur edhe një datë tjetër: "6 janar 2024 – Dita e Ujit të Bekuar."

Feim Ibrahimit, si artist dhe muzikant, nuk e pati të lehtë Kryqin e Jetës.

Nga biseda dhe takime me Verën, e dija përmbajtjen e librit, linjat e tij dhe disa gjëra publike në kohë të ndryshme, por qysh në faqen e parë, ku shkruhej: "Nga t'ia filloj?" m'u kujtua i bukur shkrimtar shkodran Zija Çela në librin kushtuar djalit të tij, Dritanit, *Për dashurinë shkruhet pas vdekjes*.

Dhe ka një datë nga filloi *Vikama*, ishte 29 korrik 1997, 30-vjetori i martesës së tyre. Në të tretën ditë pushoi zemra e atij kolosi të muzikës shqiptare dhe mbeti 2 gushti 1997 ditë përkujtimore, ende pa mbushur 62 vjeç.

Libri është një manifest dashurie, ndoshta një manual se si duhet shkruar bukur shqip, se si duhen shkruar kujtimet, se si duhen ruajtur dokumentet, se si duhen shfletuar arshivat personale dhe të tjerëve. Me pak fjalë, libri duhet mbajtur në bibliotekën e gjithkujt që do muzikën shqiptare, ka respekt për ata krijues që në vite e mbushën jetën

tonë me krijimet e tyre të bukura. Mjafton pak ta heqësh dhe aty do të jetë Feim Ibrahimit, në shtëpinë tënde, në kujtesën tënde.

Në faqet e librit i kam nënvizuar me laps ato pasazhe që duhet t'i kesh edhe si referenca personale, si bukurshkrim stilistik, që të kujtojmë data, personazhe, analiza të ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën 50-vjeçare, sepse ne, në njëfarë mënyre, ishim në dijeni se çfarë ka ndodhur në vendin tonë. Duhet t'i njohim nga një retrospektivë disa personazhe me peshë baballarësh, disa pseudo dhe shumë të tjerë të vërtetë, shih e shkruaj, siç thotë populli.

Në libër ka disa bukurina që nuk i ndesh kund tjetër në letërsinë tonë. Janë, siç duket, stil i autores, përvojë e saj e gjatë si mësuese gjuhe e letërsie, si redaktore në shtëpi botuese, si lexuese e apasionuar e letërsisë sonë dhe asaj të huaj.

Ajo, ndryshe të tjerëve, kur shkruan për Feimin, i cili është kryepersonazh i librit, përdor dendur dhe jo pa qëllim për të përemrat, si Ai, Atij, Tij, Atë (me germë të madhe), një zgjedhje letrare-artistike e autores për nderim dhe veneracion ndaj të shoqit. Si gjete tjetër artistike ndeshet në libër edhe përdorimi i shumë togfjalëshave që i japin fjalisë ngjyrë dhe ëmbëlsi, e ledhatojnë.

Libri ka faqe të tëra me procesverbale të mbledhjes së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë të para nëntëdhjetës. Dihej se Lidhja ishte edhe një paradhomë për më tej dhe dihej vendi, por Feimi kishte atë peshë në krijimtari, saqë tek Ai të padrejtat bëheshin lak.

Duke e lexuar librin me vëmendje, si letërsi, si narrativë, si strukturë shkrimore, erdhi e m'u soll në mendje diçka si rrjedhojë: ashtu siç është shkruar ky libër, ai fare mirë është edhe skenar për një film artistik kushtuar Feimit. Pse jo?

Bota ka plot filma për kompozitorët e vet, Italia, Rusia, Franca etj. Natyrisht, ato janë shtete të mëdha, i dhanë botës kompozitorët klasikë, por gjithkush ka të tijtë, ka muzikën e vet.

Sot kësaj toke nuk i ka ngelur kush të marrë nishta të tilla, për Jakoven, Teftën, Marijen, Krantjen, ndonëse disa përpjekje janë bërë me filmat, si *Concert në vitin '36, Udhëtim në pranverë* etj.

Kineastët tanë, të rinjtë, ja ku e kanë skenarin, ja ku kanë personazhin me emër dhe vepra të mëdha. Mjafton të gjenden ato të shkretra para dhe mbi të gjitha shpirt e vullnet. Historia do t'i çmojë!

Në historinë e letërsisë botërore ka shumë vepra – romane, tregime dhe monografi – të shkruara për shkrimtarë, artistë, kompozitorë, qoftë edhe histori personale, kur njëri nga bashkëshortët që mbetet shkruan për shokun e jetës që është njëkohësisht edhe personazh publik me emër të madh.


Shembull është ky libër. Vera shkruan kah fundi i librit: "Shpirti m'u shkallmua, duart dhe këmbët s'më bindeshin, sytë përsëri nuk nxorën lot. A do të vajtoj ndonjëherë?"

Feimi kah fundi, që nuk e mendonte kurrë, kish kompozuar *Simfoninë tragjike* për mua, shkruan Vera, ai e kishte shkruar për vete. Ai Feimi tragjik në vetminë e tij krijuese.

Dhe zgjodha t'i përgjigjem Verës me një "kolege" të saj që fatin e kishin disi të përbashkët, me Anni Filip, gruaja e Zherar Filip, artist i madh i kinemasë franceze. Ajo shkruan: "Po çfarë përfaqëson një jetë njerëzore në krahasim me përjetësinë? Kohën e një psherëtime. E di çdo të thotë kur vdekja i troket te porta një çifti, kur ajo rrëmben njërin nga të dy në lulen e moshës, duke lënë tjetrin në zbrazëtinë e shtëpisë."

Dhe shton: "...vdekja është asgjë, mjerë ai që mbetet."

E të dyjave u përgjigjet një tjetër njeri i madh, prof. Gjovalin Gjadhri: "...të vdekunit kanë një ndikim të madh te ne. E gjithë kultura e ka zanafillën tek ata. Toka asht djepi i të vdekuarve. Të vdekunit jetojnë nëpërmjet mbasardhësve dhe veprave që kanë lanë, ne s'mund të mos e përfillim ekzistencën e tyre e duhet t'u ngrehim përmendore."



**TI E DI VESIN TIM**

Shumëçka në jetë përsërisim  
mësimin, klasën, gabimin  
na duket nganjëherë sikur jemi përsëritës të  
përhershëm  
pa dashur,  
veçse kur duam ta përsërisim vetë jetën  
shpirti na thotë: këtu fillon mbretëria tjetër  
duke lënë pengun buzëplasur.  
...dhe, sërish erdhi ditëlindja jote  
këtu, atje, seku të gjeti  
në ç'hapësira të kësaj bote  
duke shaluar aligatorë, elefantë, deve a Chevroleti?  
Veçse vesin tim ti e njeh tashmë:  
të mos uroj njeri për ditëlindje,  
pa çka se shpirtin rob e lë  
në itineraret e tua, në arratitë e shëtitjet.  
S'ka gjë, malli le të përsëritet  
me gjithë peshën e vuajtjes sa një tren a avion  
Rëndësi ka që me zogun e blertë e zemërak  
të kujtoj e më kujton.

**ME TË DASHTË**

Ti ishe afër, aq afër sa deti me valë,  
aq afër sa afër qe dita  
si një nuancë e emrit tënd.  
Tani ike larg,  
aq larg sa pamundësia  
dhe nuk ma the  
pse zura ME TË DASHTË?  
Ike larg duke tundur dorën:  
Mirupafshim!  
Në këtë botë gjithçka mund të ndodhë  
siç këndon dhe zogu i këngës  
në ëndërr,  
i lirë.  
Se, për t'u thënë,  
vetëm një herë thuhet:  
Lamtumirë!

**NJI TJETËR ANDËRR**

dimën asht e ftohti ka ra bashkë me natën  
lodh gjymtyrësh e hutue mendjet  
dhe gjumi ka ardhun  
mos m'thoni se nuk kini pa andërr  
tue pa andërr  
ma s'paku një herë palue vitet n'palë t'jorganit  
e kur n'ferkun e mjesit gjumi ka firue  
i kini thanë vedit:  
ardh kenka koha m'u zgjue  
bashk me borën dimni ka ra  
e n'mashtrim na ka xanun të tanëve  
pa e diktue se po hyjmë në një tjetër andërr.

**DUHET TË VIJË SONTE NJË LAJM**

Duhet të vijë sonte një lajm, një letër a fjalë në erë  
Duhet të vijë,  
Në mos deteve të njelmët, tokës djerrë  
Sipër qiejsh gri do të vijë.  
S'është besëtytni, e di  
po mendjeshkreta më vajti te ti.  
Do të vijë,  
Se trazimi i oqeanit të vetmisë  
Orën time, orën tënde dridh  
Rrathëve të ajërt ku gjëllinjë shpirtrat.  
Dhe mos thuaj s'të ndjeva, dhe mos thuaj s'të pashë!  
Dashuria është qerthull i lashtë  
Sa vetë fillësa.

# Adem Gashi

## ME TË DASHTË

poezi

**TI DO TË VISH, DO TË KTHEHESH NJË DITË**

Ti do të vish, do të kthehesh një ditë  
një ditë do të ikim bashkë për s'di seku  
seku mund të na shohin vetëm perënditë  
perënditë hutuar mrekullie tutje-tehu  
Epilog hakmarrës që s'merr hak asku'.

**DASHURIA KËRKONTE FLI...**

tashmë ata të dy duhet të jenë të vjetër  
ai plak dhe ajo plakë  
rrojnë a s'rrojnë në një përmasë tjetër  
u fikën a u dogjën flakë

jo, nuk e di

njëherë e një kohë qenë bërë legjendë  
ai dragua ajo kuçedër  
as në tokë as në det nuk u lanë vend  
mërguan tutje në një përmasë tjetër

dashuria kërkonte fli

...dhe qenë të bukur dhe qenë të rrallë  
ah, mos i zëntë shikimi sykeq  
dashuri e tyre na bëri përrallë  
paj, tash edhe mund të jenë pleq

paçka që s'e dimë, pa çka që s'e di.

**KUR VETMON PËRMALLSHËM ME HIJET**

lotët m'janë b'qelqezash  
(edhe liget burri pa çka)  
e m'edel përpara f'tyra  
të tanë e mbulueme n'përla  
f'tyr'e njasaj pra  
qi kjë lule, pemë e u b'flatër  
e muer një erë qiellnash e s'di ku e la  
nashti u kthye shpirtshkëndijë oxhakut  
pa çka  
burri edhe liget  
kur vetmon përmallshëm me hijet.

**SHTRATI BOSH**

kur bie mbrëmja terri shtron çarçafët e bardhë  
me petale trëndafilash hedhur në nënkresë  
dhe vjen ti nuse me hap të lehtë si një sorkadhë  
dhe vjen ti (figurë nga folklori) si lule me vesë  
e përzihen ëndrra e shpresa si një herë e një mot  
diçka prej ferri diçka prej parajse diçka si lojë  
t'i puthë buzët e epshta e syçkat e bukura me lot  
e njëkohshëm më shfaqesh vajzë, grua, zonjë  
lëre tani, kohën e moshën i kemi harruar kaherë  
dhe mos më bëj sikur, dhe mos më bëj rreng  
jam ai, ai djali pra, që dikur në një stinë me erë  
mizorisht ia more zemrën e shpirtin peng  
kur vjen agu symavijosur ti ikën në punë, në spital  
unë shoh, ëndërritës si gjithnjë, shtratin bosh  
dhe anktshëm them: është shtrat a sarkofag  
pa ty jam i harruar kohërash, me ty jam riosh.

**PARA TRUPIT TË NJË GRUAJE**

papritmas mori qielli flakë,  
mori zjarr majëmali e fusha  
zjarr mori qyteti e katundi e gëmusha  
në zjarr u përzjarr ajri, udha  
e morën nga zjarri lumenjtë, liqenet  
pemët, perimet dhe shelgjet  
ra zjarr pra  
edhe në hapësirën e zhveshur të shpatit,  
në trupin tënd e timin  
u ndez dhe shtrati dhe oxhaku  
u dogj gjithçka, dhe deti, dhe oqeani...  
ah, harrojini të gjitha,  
i paskam këmbyer sytë padashur  
me sytë e një piromani  
para trupit të një gruaje

**VJERSHË E HARRUAR PËR LADY-N**

(Rekomandohet të lexohet paralelisht me  
"Makbethi"-n e Shekspirit)  
kur ra nata, dikur vonë, shumë vonë  
erdhe e trokite në portën që veç ti e di  
dhe më the se nuk të pa njeri

(...këtu papritur ra perdja  
në skenën me seks dhe erotikë,  
të padenjë për të parritur e fëmijë...)

pastaj na çeli agu  
ah,  
kishte lëvizur Pylli i Dyshimit drejt Pyllit të Fjalëve  
dhe ne u gjetëm në Kështjellën e Makbethit  
rrethuar skëterrshëm nga ushtarët  
pa vvarë as princin as mbretin

Lady  
e vetmja ambicie jotja, imja  
në mbretërinë e dashurisë ta merrnim pushtetin  
tash presim  
penën a shpatën  
e atij që nuk ka lindur prej gruaje, nëne:  
të vritemi o të falemi.

# Arbër Selmani

## E PREMTE, SULM NË ZEMËR

Tregim

**B**ërtima e tmerrshme më hyri atë ditë në kokë e nuk ka dalë më kurrë jashtë saj.

Banjoja e banesës sonë është e vogël por i jep mundësi jete secilit objekt brenda saj. Pesë kolonat e pllakave janë të ndara: pllakat e sipërme që nisen kah tavana janë të bardha me një nuancë të një luleje që zbërthehet por vërehet shumë pak, pllakat e poshtme janë një e kaltër deti e pastër. Në mes, dy botët e banjos i ndanë si me thikë një pllakë katërkëndëshe me një figurë trëndafili. Figurinat e tilla janë tash e disa vite në këtë banjo. Dritësimi është më i vobektë, nuk i duroj dritat e forta, gjithmonë kam dashur që në banjo të ketë një ndriçim më të lehtë. Në fakt, krejt jeta ime është një dritë më e zbehtë.

Ditë e bukur në Prishtinë. E premte, pasdite, të premtet vonohen por vijnë të pushueshme, të freskëta, vijnë siç vjen vala e vonuar e rekës, siç vjen aeroplani i të fundmëve, fati i të pastrehëve, poezia e gëzuar, vonë, shumë vonë. E mallkuar erdhi.

Në banjo, qetësia para stuhisë. Po pastrohësja në atë vaskën tonë të vjetër, ku duhet të ulesh këmbëkryq e ta rrudhësh çdo tul brenda perimetrit. Një këngë në prapavijë më vjen prej telefonit tim të cilin e kam lënë mbi lavatriçe, prapa shpinës sime, kamufluar në një formë që të mos laget prej ujit. Kurrë nuk kam mundur ta dëshifroj këngën e atij momenti, e nuk dua të gënjej kot këtu për hatrin e tregimit. Unë nuk kam flokë, si leshatuki i parë mes shokësh minutat e pastrimit i kaloj në leshra tjerë, në qime tjera. Meqë ajo ditë më kujtohet si kalimthi, do ta kem dashuruar ujin shumë derisa prekte lëkurën time të thatë.

1 prill 2016.

Prej dhomës tjetër e dëgjoj një çirrije të tmerrshme, të padurueshme. Në fraksion sekonde mendoj që motra po qesh me diçka, ose zëri vjen prej televizorit, vajza e vogël fqinje po zgërdhiet në korridor apo ndoshta babai e ka rrëzuar ndonjë vazo a objekt me vlerë dhe dikush është lënduar.

"Ndihi, Arbërrë. Babi. Ndihi, Arbër". Më kap lukthi, moliset trupi, dal prej vaskës dhe me shpejtësi vendos çka gjej në trup e drejt në sallonin e banesës



sonë. Këmbët kishin nisur të më lëshonin përtoke ende pa dalë prej banjos, parandjeja tmerr. Cilat janë sinonimet më të rënda për fjalën tmerr? Ashtu i lagur dukej sikur po kapërceja dy terrene të ndryshme: prej një fushe të lagur me ujë e gjeta veten në një pamje therrëse. Hihët.

Motra kishte humbur të folurit dhe fytyra e saj ishte e mbytur në një të vjollce të lehtë, nëna lante fytyrën e babait, e prekte kudo se nuk dinte kah vinte mundimi, babai ishte në dhomë por edhe kishte dalë prej dhomës. Nuk e gjeja në dhomë, mu rrotullua dhoma. Sulm në zemër. Nuk vinte në vete, nuk këndellej dot, diçka diku në kanalet e zemrës së tij ishte bllokuar. Më mbeti në fyt jeta ime, atij i mbeti në fyt zemra e vet.

"Thirr ndihmën e shpejtë, ose dil kërko ndihmë te kojshitë" – më tha nëna, mendoj, e cila tash mu duk edhe më e vjetër. U plak nëna në çast. Nuk e di saktë a ishin këto fjalë e saj, i përhumbur, se dija a të rrija e të ndihmoja ta qetësoja një burrë që donte ta mbante zemrën me zor brenda vetes, apo ta shpërndajta panikun ose te fqinjët ose te ndihma e shpejtë. Këmisha e lagur e babait ende më vjen si mirazh, ishte dita e parë e muajit dhe unë e kisha dorëzuar te ai rrogën time, siç bëja përherë. 300 e disa euro, të lagura qull. Edhe me sulm në zemër, Zoti të shet kapitalizëm.

"Prit, le ta shtrijmë këtu edhe shohim nëse qetësohet, ndoshta veç është shqetësu ose është lodhë shumë këtyre ditëve. Bab, a je ma mirë? Bab, a t' kaloj? Bab, a je ma mirë?"

Si fletet me një njeri që po përjeton sulm në zemër, cilat fjalë duhet përzgjedhur, cilat gjeste duhet performuar, ku drejtin është një aspirin që ndoshta e ulë goditjen, cilat rroba duhet hequr prej trupit?

Çdo skenar kalon para syve të mi: gëzimi kur para disa muajsh i tregova këtij burri që kisha fituar një bursë studimi për në Amerikë, ekzaltimi i tij, dita kur më zgjoi në gjashtë të mëngjesit të ecnim bashkë në parkun e madh të qytetit dhe e cila më nuk u përsërit kurrë sepse prishja e gjumit është shoqe e blasfemisë, dita kur kuptova që babait tim i duheshin stenda për ta mbajtur në jetë zemrën e tij të krisur, çdo lodër e blerë në kohë të vështira, një mindil vallëzimi që ai e nëna ma blenë kur u bëra vallëtar, konkursi i parë i punës time si një copë gazete e zbuluar prej tij, një pushim vetëm mes ne të dyve në Ulqin... Babai im po pësonte sulm në zemër e unë po pësoja sulm në tru, mpakje në këmbët e mia.

Gjithçka ndërroi ngjyrë. Çka kish çelë para njëzetë minutash, tash nisi të thahej. Çka e ndërtoam me përkujdesje, po binte përtoke. Çka isha gati ta lindja, e abortova. Çka ishim gati të lindnim, si familje, po merrte fund, po vdiste. Kurrë nuk e kuptuam kah depërtoi sulmi, prej cilës birë të poshtër. Mobiljet e kuqe dukeshin si gjak, e më i gjaktë dukej babai im në to. Provoja t'ja gjeja një grimë fryme e t'ja zgjatja si shirit projektori veç ta mbaja ende gjallë.

"Më mirë jom, më mirë jom". Shkronjat që i lidhte me atë gojë të shtrembëruar nuk bënin sens. Nuk ishte mirë. Mbushej frymë por sikur kaloi në derën e parafundit. Si emërohet skena ku pret me ankth të të ftojnë në vdekje? Babai ishte aty.

Hoqëm rrobat e trupit dhe e vendosëm poshtë një batanije, në një prej këndeve të dhomës, në njërën prej shtretërve ku edhe flinin edhe rrimin. Babai u bë i vogël, i imët, *petite*, u struk brenda batanijes, ose donte të vdiste ose diku kërkonte një ilaç të mos ndihej më ashtu. Nuk e di saktë ndjenjën e tij. Unë krejt çka bëj është të mërzitem. Më dhemb ta shkruaj këtë tregim: do t' i ketë pëlcitur gjoksi, do ta ketë shtrënguar ndonjë arterie, mund t' i jetë shtangur krahu i djathtë, i majti ndoshta është kursyer, çka nëse e dëmtoi nofullën, qafën, barkun, djersën e tij nuk e kujtoj, më dhemb shumë ta shkruaj këtë tregim. Qaj.

'Shko laje fytyrën në banjo, shko'. Këto fjalë mi tha Zoti, se nëna ishte në shok e nuk nxirrte zanore. Motra, e stepur, gati u kthye në memce.

U futa në banjo, mbylla derën, u përplasa në tokë. Fytyrën nuk e lava kurrë atë mbrëmje, as të nesërmen, për ditë me radhë, as trupin nuk e lava, nuk guxova, nuk pastrohësja dot pa e dëgjuar klithmën prej dhomës kryesore. Babai vdiq dy orë më vonë, na gënjeu, 'ma mirë jom, ma mirë jom'.

Në familjen time, askush nuk guxon të bërtasë kur unë pastrohëm në banjo. Për vite e vite me radhë kam mbledhur, larje pas larje, copëzat e mia që u ndrydhën në skutat e kësaj banjoje. Isha në banjo para një vdekjeje, gjatë saj, pas saj.

Bërtima e tmerrshme e vdekjes së babait më hyri atë ditë në kokë e nuk ka dalë më kurrë jashtë saj.



## Klara Kodra

### KËNGË APO ELEGJI?

poezi

#### NË ATDHEUN E KRISHTIT

Pleq, gra, fëmijë të copëtuar - o vaj! -  
Në atdheun e Krishtit endet Satanai.

Zjarr nga qielli si breshër, zjarr edhe tmerr  
Ato vise parajse janë shndërruar, në ferr.

Mesazhi i Jezuit është harruar - o vaj -  
Në atdheun e Krishtit endet Satanai.

Hebrenj, palestinezë, tërë kombet e shpërndarë  
Ngjizi me afsh krijues Zoti ndër mijëvjeçarë.

Levë e Arkimedit, s'është urrejtja aspak  
Dashuria është që Krishti e shkruajti me gjak.

#### KËNGË APO ELEGJI?

Musa Vyshkës

Kënga jote sfiduese e këngës së kumurisë  
Hodhi rrënjë thellë në gjirin e dheut,  
Në pemë u shndërrua  
Që t' i fliste me aromë kaltërsisë.  
Po të qan mëmmedheu,  
Po të qan me ligje sipas zakonit të lashtë,  
Që të ta shuajë shqetësimin që derdhe në vargje,  
Që gjumin e fundit ti ta bësh të qetë,  
Ti që e deshe aq shumë jetën.

## SAPA, HESHTJA...

Eci përmes heshtjes së qëndrueshme të Sapës,  
Në përvlimet e zhegut, mes fushave që ia kthejnë kurrizin vetë maleve;  
Rrathët e ankthit nuk flasin me za,  
Dhe as Zotat e lashtë,  
Shoh gratë me flokët si në gravurat meksikane  
Të qytetërimit Maya dhe Aztec. Stuhitë e pafré bien në kanale  
Si qent e zbutun që u fshehen kujave të ujçërve;  
Heshtja ka lind para ditëve të krijimit,  
Përpara shkundullimeve polifonike të rrufeve,  
Para daulleve oratorike që duan të trembin ca fantazma brenda nesh,  
Përpara se bota të shpallej me britma të dhëmbshme ekzistencash.  
Gjëmimeve të moteve në Sapë askush s'ia vuni veshin;  
Heshtja i bani gratë dhe ma të bukura se ç'janë, dhe burrat  
Me heshtje përbuzin dëshprimin dhe vdekjen.

Në Sapë heshtja kacavirret e pa vënë re nga askush,  
Në lartësi qiellore, ku as avionët modern nuk arrijnë, dhe as raketat.  
Burra flasin me heshtjen larg kësaj Toke;  
Thonë lutje nën za, me një shpirtin si tymtajë  
Që sapo ka lanë, pa u vu re nga askush, zjarrin e ndezun në votër!

Jam kthy pas shumë vitesh në Sapë.  
Askush nuk më njih,  
Sepse njohja asht zhurmë dhe vorbull shurdhuese; Shpirtat drithëmuës  
Të atyne që kanë vdekë  
Ma tregojnë kohën prej thellësi guvash  
Nga një orë diellore e moçme!

2023

## TRISHTIMI

Është e kotë të shohësh kalendarët,  
Është e kotë t'i kërkosh biletën e avionit a të trenit të shpejt,  
Askush nuk e di nga vjen-e marr me mend se ka ardh nga larg,  
Nga pesë mijë vite larg,  
Vjen i përpikt, i parashikuar nga orakujt lart.  
Më thërret me emër si një mik të vjetër,  
Më siguron se jemi miq të njohur në një jetë tjetër,  
Se fëmijë kemi lozur bashkë. Edhe mua më kujtohet turbullt fëtyra e tij;  
E mbuluar si nga një maskë e ishujve të Pelonezisë  
Ecim rrugëve të Tiranës, në Skenderbeg Square,  
Grataqielët modern ka kohë që janë ngritë në eter;  
Trishtimi këtu është i sigurt, si të thuash, në shtëpinë e vet.  
Përpiqem t'i largohem me takt,  
- Më duhet të largohem se dikush më pret, më fal,  
Dhe largohem pa kthyer kokën sado pak;  
Por ai ka mbërritë në shtëpinë time para meje,  
Dhe është ulur në dhomën me libra përplot, dhe më pret  
Madje më fton të ulem pa asnjë siklet,  
Dhe e kuptoj se jam unë mysafiri i tij,  
Mysafir në pallatin presidencial të Trishtimit,

Atje ku rojet e rreptë kontrollojnë butonat e teknologjisë më të fundit të Harrimit.

2023

## KAM LINDUR NË BRIGJET HOMERIKE

Cikël poetik nga Rudolf Marku

## ULURIMË UJÇERISH

Ti më shkruan se jeni ngjitur me burrin tënd në male,  
Dhe keni ndezur zjarr për të trembur ujçerit që ulurijnë,  
Ti vetë nuk është se trembesh nga ujçerit e vetmuar,  
As atëherë kur mes ulurimave të ujçërve të shfaqet profili im

Dhe vetë kalimtarët sot, në Kings Road të Chelsea-t,  
Dëgjojnë po atë ulërimë ujku që shumë vetë e marin si alarm,  
Dy gra të bukura në turmë më hedhin një vështrim gjithë mirëkuptim,  
Ëndërrojnë, mijëra kilometra larg, për majat e maleve në Ballkan.

Chelsea, Korrik 2023

## NJË NATË

Të jesh në Londër, buzë Lumit Thames, pa kohë, pa hapsirë-  
Duke ecur në një hap me rrjedhën e ujrave pa ndalesë  
Dhe të gjëndesh në rrugicat e Korçës,  
Në kërkimin e një shtëpie pa emër rruge, pa numër shtëpie pa adresë,

E prapë them se duhet të jeshë mes ikonave mesjetare,  
Pikturuar nga murgjërët bizantinë që nuk shënuan as emrat e tyre.  
Mes engjëjve të trishtuar duhet të jesh;  
E nuk më lejohet as emërin tënd ta them;  
Gjithmonë vjen një kohë që emërat tanë është më mirë me i tretë.

Duhet të jetë një kopësht me ngjyren e trëndafilave të kuq të ikonave në Mesjetë,  
Mes murgjërve asketikë të kohës Bizantine,  
Adhures të largët, por jo të tunduar, të sharmit tënd,  
Dhe mua më duhet të mësoj mjeshtërinë e vetëpërbajtjes së murgjërve të mënçur,  
Në kohën tonë të ngutjeve moderne;  
Mes engjëjve të trishtuar duhet të jeshë.  
Pa kohë, pa hapësirë. Dashuria për ty ka lindur diku në qiej,  
Mes murgjërve, mes engjëjve që ma kuptojnë trishtimin tim  
Një shtëpi pa adresë që ndoshta kot përpiqem me e gjetë,



Mes engjëjve që më thonë se dashuria është diku larg, vetë një yll, në Univers.

Maj, 2023, Korçë.

## ISHTE A NUK ISHTE TETOR...

Ishte a nuk ishte Tetor?  
Plazhistët kishin ikur pa u parë  
Në planetet e panjohur e të largët;

Ishim si dy njerëz e parë.  
Qielli ngjante si një mëkat i madh,  
Edhe pse nuk kishte asnjë pemë-molle pranë.

U çveshëm -pa rroba në trup, pa turp, në ranë  
Dhe u shtrimë mbi njëri-tjetrin si alarm  
Vetë Deti nxitonte të na vinte pranë.

Malet na rrinin përreth si kunorë  
E dinim-ne ishëm padyshim mbretëror,  
Pa rroba mbretërisht, pa skeepër, oborratë

Veç kujtesa e largët na sillej vërdallë  
O ditë vjeshte, me një diell si shegë e vdarë,  
Që hidhte ngjyrë gjak-epshi mbi trupat tanë

Dita ishte seks, puthje dhe mallë,  
Zemra e Detit shpërdante një trishtim valë-valë  
Veç për një burrë e një grua në këtë botë të pa-anë!

Do na njihnin, në qytete, sapo t'kthenim prapë,  
Nga kokrrizat e ranës që do shkundeshin ngadalë  
Prej trupave tanë, një terror i gjallë,  
Do qemë për Qytetet që det s'kishin parë!

Shengjin, Rana e Hedhun, Vjeshtë e Vonë, 2023

## KAM LINDUR NË BRIGJET HOMERIKE

Kam lindur në brigjet e Detrave Homerikë  
Fëmijë lozrim me kafkat e ushtarëve grekë, romakë  
Që i gjenim mes mureve të gurëve ciklopike  
Poshtë mureve të Kalasë  
Dhe kujtesa jonë ishte një udhëtim i largët,  
Në dhëmbjet pa spjegim që shfaqej në muzgjet e ndezura flakë.

Nënat tona lindnin fëmijë të shëndetshëm pa njohur gjenetikën,

Pa na mësuar askush, notonim në rrymat e fuqishme të Lumenjëve  
Në shoqërinë e gjarpërinjëve të ujit, të lundëzave, breshkave të mëdha ujore, troftave dhe ngjalave,  
Dhjetë vjeçarë, shihnim filma të ndaluar me seks, krim dhe dhunë,  
Dhe ktheheshim në shtëpi të përpiktë në mesnatë,  
Më të mirësijellshëm dhe më të mire se kurr.  
Baballarët me ballin e rrudhur dhe duart tërë plasa  
Na thonin të lozrim me qent e vegjël të sapo lindur, i nxirrnim në rrugë  
Duke ia mësuar ligjet e mbijetesës mes njerëzve,  
Shmangien e makinave, biçikletave, karrocave, fshehjen nga Policët  
Armiq të qenëve të rrugëve, maceve dhe lypsarëve zhel e mel.

Sokol Luli na jepte këlyshë ujçerish që t'i rritnim- dhe na thoshte si sekret.  
Se ujçerit janë engjëj në krahasim me shumë njerëz.

Kurse tani ata vijnë me avionë modernë me çanta të mëdha me libra psikoanalitësh  
Na thonë se fëmijë jonë ishte e gabuar plot urrejtje dhe dhunë,  
Na thonë se na duhet të harrojmë, të harrojmë, të harrojmë  
Që të mund të bëhemi qytetarë të nderuar të qytetërimit të vonë,  
Ndersa shpikësit e tyre më të fundit hedhin bombat  
Mbi fëmijët që lozrin si ne dikur buzë lumenjëve, me qen dhe ujç.

Dhe kush do t'u jap atyre përgjigje  
Tani që kafkat e baballarëve tanë ka kohë  
Janë përzier me kafkat e ushtarëve të lashtë grekë e romakë  
Poshtë gurëve të lashtë ciklopike, në heshtjen e tyre solemne dhe të zyrtë?

Janar, 2024

## MARRËVESHJE

...Dhe si t'i bëj bashkë  
Yjet që ndriçojnë në qiej të largët  
Dhe shpirtin që e humb qetësinë ?

Flokët e një gruaje pranë, shpurrpurishur në erë,  
Antena që kapin sinjalet qiellore,  
Të sjellin ty në shtratin tim!

Janar, 2024

## ISHIM GJASHTËMBËDHJETË VJEÇARË

Ishim gjashtëmbëdhjetë vjeçarë  
Të dy të ndronjtur. Takoheshim në muzg, Ndonjëherë shtëngonim duart me njëri-tjetrin  
Edhe pse e dinim se nuk ishte e mjaftë.

Shikonim nga njëri-tjetri, kush do ta bënte hapin e parë?  
Oh, ndjenim peshë e yjeve që na vështronin me ngulm,  
Na pëshpërisnin në vesh: Bëhuni guximtarë,  
Jeni bërë për njëri-tjetrin o të marrë!

Ishte koha kur anijet kozmike nuk kishin shkuar në qiej,  
Dhe s'kishte as kompjuter, as tek- fb-tiktok-celularë,  
Prisnim prapë mbërmen të shtëngonim





Romani "Dritarja e Marin Shkreli" i Ndue Ukajt

## Një mimesis i fuqishëm i kujtesës

Nga Elsa Skënderi



Romani "Dritarja e Marin Shkreli" është një *mimesis* i fuqishëm i kujtesës për të djeshmen e luftës në Kosovë, që trysnoi, shtypi e përçudnoi ëndrrat e një të riu, duke ia mohuar atributet më domethënëse të qenies, *lirinë* dhe *vullnetin*, atij vetë dhe rrethinës së tij. Me këtë vepër Ndue Ukaj lëvront shembullin tipik të asaj letërsie që etablohet si kujtesë kulturore, ku transfigurohet e djeshmja e afërt historike dhe ankthi post-traumatik i gjetjes së kuptimit të ekzistencës së të sotmes.

Subjekti i romanit është ndërtuar duke ndërthurur rrëfimin përmes *flashback*-ut të personazhit kryesor, Marin Shkreli, nga njëra anë, me përzierje sa të personazhit kryesor, aq edhe të rrëfimitarit, nga ana tjetër, përzierje këto të një natyre eseistike. Të tillat bëjnë të mundur hapjen e diskutit në plan më filozofiko-politik, duke përvijuar qartë individualitetin e shkrimtarit, N. Ukaj, që shenjë të personalitetit të vet shkrimor e ka etikën dhe argumentin.

Sapo nis rrëfimi i ngjarjeve të së shkuarës, ndihet karakteri personal e *melodramatik* i tij, por dramatikja në kufijtë e tragjikes nuk synohet nga rrëfimtari, i cili i ikën makabritetit të skajshëm të ngjarjeve të luftës, për të cilin shkruan historia dhe kujtojnë dëshmitarët; këtu rrëfihen situata të rënda e varra të thella, që kallëzojnë çfarë i ndodh njeriut, kur i grabitet liria, i përdhoset dinjiteti dhe mbyllet në zhguallin e errët të qenies së dhunuar brenda kufijve, që s'bën të kapërcehen.

Ëndrrat e bardha për të ardhmen, që ka njeriu në të ri, përbëjnë mënyrën e tij të natyrshme të të ekzistuarit, por teksa i thur këto ëndrra bashkë me përjetimin e dashurisë së parë, Marin Shkrelin me përdhunë e ndërballin në një pezulli frike e ankthi, ku diktati politik kish shtyrë të gjithë shqiptarët e Kosovës. I riu i qashtë, i dëlirë, i pamëkat, "përzihet prej Edenit të vet" dhe "përballet me ushtrinë gjigante të frikës" për një mollë mëkati që s'e ka ngrënë, për një faj që s'e ka bërë as ai, as askush prej të tije. Fatumi i mëkatis fillstar ngjan se e ndjek atë, siç, me gjasë, ka ndjekur të gjithë ata, të cilët janë gjendur në një moment të

caktuar të jetës të përfshirë në luftëra, trazira e terror.

Në kapërcyell të të pesëdhjetave, Marini përballë pasqyrës së vetvetes, nis të kujtojë përpjekjen për t'i shpëtuar së keqes së sprovave dje dhe ta ndjejë dhe më fort klithmën e psikës së vet të ngarkuar, teksa nuk arrin të bëjë paqe as me zhgëndrën e hidhur të së sotmes, kur lirisë i është bjerrë kuptimi i ëndërrt, i dikurshëm. Në këtë shestim, Marin Shkreli mbetet njeriu, që në luftën për dinjitet mëton të kuptojë identitetin e vet. Përballja e dy kohëve shndërrohet në përballje me vetveten e *pafaj* dhe me plagët që i janë shkaktuar: "Fundja Njeriu është krejt i vogël, një foshnjë që të tjerët përherë e marrin përdore, e mbajnë ashtu duke e shtrënguar dhe e çojnë kah të duan, sepse Ai kurrë s'është rritë aq shumë sa të kuptojë pse erërat e çojnë andej dhe jo dika tjetër. Sepse foshnjëria e tij është njëfarë fataliteti, një gjendje konstante, një gjendje të cilën ai duket sikur lufton ta tejkalojë pa sukses, tash e miliona vjet mbi tokë".

Kryepersonazhi i romanit, *Marini*, mund të jetë secili, që e ka një segment të jetës së vet të lidhur me luftën e pasluftën, me një histori dashurie të lënë përgjysmë prej një ikjeje të shtrënguar, me ngjarje të rënda, ku politika, ajo e egra dje dhe meskinia sot, ka diktuar rrjedhat e fatet njerëzore, me çaste të forta pikëpyetjesh ekzistenciale për lirinë, lumturinë, të ardhmen... Në *dritaren kah Perëndimi* mund të ketë dalë secili, që e ka përjetuar shtypjen, pamundësinë për t'i ikur robërisë, që e ka ndërjerë ankthin e pezullisë, frikën e humbjes. Ndaj rrëfimi në këtë roman arrin ta zgjojë krejt vetvetishëm ndjeshmërinë e lexuesit, veçanërisht në pasazhet lirike të dashurisë dhe në pasazhet e dhimbjeve shpirtërore të personazheve. Me ndjenja të zgjuara, lexuesi diku në rrethinën e vet do ta pikasë medoemos Marin Shkrelin - të *ngjashmin* e tij dhe fill sapo kjo të ndodhë, çdo përvojë leximi do të tregojë që romani i Ndue Ukajt ia ka dalë do të dëshmohej si letërsi e mirëfilltë, sepse ia ka dalë ta përmbushë *gjasmimin* letrar, jo duke e dubluar historinë, por duke e pasuruar memorien kulturore të letërsisë sonë.

Në rudinën linguistike të romanit "Dritarja e Marin Shkreli" gjuha është e gjallë, e pasur, e pashtershme njëjtë si idilet e natyrës, që aty-këtu përshkruhen në roman. Ndërsa shprehia e arrirë artistike e Ukajt nuk mbetet brenda një rrjeti tipik të stilemave e të metaforave, por mëton të gjuhësojë më së pari virtuozeitetin e *mendimit* e më tej të sugjerorë *mësimin etik*. Veçanërisht te mendimi që shfaqet në formë të përzierjeve rreth motiveve biblike, filozofike, politike, historike, vërehet më së miri mjeshtëria e shkrimtarit, sepse falë *enciklopedisë* së vet të gjerë dhe prirjes krijuese, Ukaj ia ka dalë ta kryejë me sukses kapërcimin cilësor të zhanreve të veta: nga tregimi e novela, të botuara prej tij më herët, te kjo vepër romanore, e cila, nëse do t'i nënshtrohej sfidës së përkthimit në gjuhë të huaja, nuk do t'i rrinte e paktë, horizontit të pritjes të lexuesit bashkëkohor evropian. Përkundrazi, për nga procedeu artistik - tematikat letrare e lënda jetësore, lufta, shtypja dhe kujtesa, dilemat ekzistenciale e identitare, elementet psikologjike të traumës e posttraumës - ajo do t'i rezononte lexuesit të huaj *letërsinë* dhe *letraren* bashkëkohore evropiane, të ndërthurur me koloritin e letërsisë shqipe e të botës shqiptare.

# W. H. Auden

## 1 SHTATOR 1939

poezi

Poezia u botua së pari në numrin e *The New Republic*, të datës 18 tetor 1939 në Nju Jork dhe pastaj është përfshirë në përmbledhjen e Auden "Another time" (Njëherë tjetër), 1940. Kritikët kanë theksuar se autori mbështetet në modelin e strofave të poezisë "Easter 1916" (Pashkët 1916) të W.B. Yeats. e cila evokon Luftën I Botërore.

Përktheu Kujtim Morina

*Kjo poezi është shkruar për fillimin e Luftës II Botërore që shënohet më 1 shtator 1939, me pushtimin e Polonisë nga Gjermania.*

I ulur në një nga baret  
e Rrugës Pesëdhjetë e Dy  
I pasigurt dhe i frikësuar  
Ndërsa shpresat e pritshme shuhen,  
Të një dekade të ulët dhe të pandershme  
Valë zemërimi dhe frike  
qarkullojnë mbi vende të kthjellëta  
dhe të errësuar të globit  
duke pushtuar jetët tona private;  
kundërmimi i paemër i vdekjes  
shkel mbi natën e shtatorit.

Dijet e sakta mund të nxjerrin  
në dritë të gjithë keqbërjen  
nga Luteri deri në ditët tona  
çfarë e ka bërë një popull të çmendet,  
gjej çfarë ndodhi në Linz!<sup>1</sup>  
Një megaloman i shndërruar  
Në një zot psikopat.  
Unë dhe publiku e dimë  
Ashtu si edhe fëmijët e shkollës  
Atyre që ju është bërë e keqja  
Me të keq do të ta kthejnë.

Tukiditi i mërguar e dinte  
Çdo të thotë një fjalim populist  
për demokracinë  
Dhe çfarë bëjnë diktatorët.  
Gjepurat e vjetra që flasin  
Për një varr apatik,  
I gjithi i analizuar në librin e tij.  
Iluminizmi i hedhur tutje,  
zakonet që krijon dhimbja,  
keqeverisja dhe brenga  
duhet t'i vuajmë të gjitha përsëri.

Në këtë vend asnjans  
Ku grataçelat e verbëra përdorin  
Të gjithë lartësinë për të shpallur  
Forcën e Njeriut Kolektiv  
Secila gjuhë derdh shfaqjesimin  
e saj të ethshëm, të kotë  
Po kush mund të jetojë gjatë  
në një ëndërr euforike  
Nga pasqyra ata sodisin  
Fytyrën e imperializmit  
dhe të së keqes së botës.

Fytyrat e njerëzve në bar  
Kapen në ditët e tyre të zakonshme  
Dritat kurrë nuk duhet të fiken  
Dhe muzika kurrë të mos pushojë.  
Të gjitha zakonet synojnë  
Ta bëjnë këtë gjendje të duket  
Sikur asgjë s'ka ndryshuar.  
Që të mos shohim ku jemi  
Të humbur në një pyll të fanitur  
Fëmijët që kanë frikë kur vjen nata,  
që s'kanë qenë kurrë të lumtur apo të mirë.

Plehrat militantë, më dredharakët,  
Personat e Rëndësishëm gërthasin  
Nuk është aq e pastër sa dëshira jonë  
Çfarë shkroi Njinsky i acaruar  
për Diaghilev<sup>2</sup>,

<sup>1</sup> Linz, Austri, vendlindja e Hitlerit.

<sup>2</sup> Valltari i baletit Njinsky për të dashurën Diaghilev.

është e vërtetë për zemrën normale.  
Sepse gabimi i mbrujtur në kockë  
i çdo gruaj dhe çdo burri  
Digjet për atë që s'mund ta ketë,  
Jo për dashurinë universale  
Por vetëm për t'u dashur vetë.

Nga errësira konservatore  
Në jetën e moralshme  
Kalimtarët e ngjeshur përsërisin  
zotimin e tyre të mëngjesit  
"Do të jem i sinqertë me gruan  
Do të përqendrohem më shumë në punë"  
Dhe guvernatorët e pakrahë të  
provincave zgjohen  
Për të rifilluar lojën e tyre të  
detyrueshme;  
Kush mund t'i lirojë ata tani;  
Kush mund t'i kuptojë të shurdhërit  
Kush mund të flasë me memecët?

E gjitha çfarë kam është një zë  
Për të zhbërë gënjeshtren e palosur  
Gënjeshtren romantike në trurin  
E një njeriu të ndjeshëm në rrugë  
Dhe gënjeshtren e Autoritetit  
Ndërtesat e të cilit prekin qiellin  
Nuk ka ekzistuar diçka e tillë si Shteti  
Dhe askush nuk ekziston më vete.  
Uria nuk të jep zgjedhje  
Për qytetarët apo policinë  
Duhet të duam njëri-tjetrin ose të vdesim.

I pambrojtur në këtë natë  
Bota jonë në gënjeshtër të trullësura,  
Megjithatë, shquhen gjithandej  
Pikëla drite ironike,  
Vetëtimin kurdo që të Drejt  
Shkëmbejnë mesazhe  
A mundem unë, i krijuar si ata  
Nga Erosi dhe pluhuri  
I dërmuar nga i njëjti  
Mohim dhe dëshpërim  
Të tregoj një flakë afirmuese.



Kur erdhi në shtëpi, i gjeti të dy në dhomë të ditës duke lozur në dyshe. Olti po mësynte me Shaon, pokimonin tullac që ish mjeshtër në kung fu, ndërsa Indriti qe mishërim i lemerisë. Olti po mekej gazet. Babi kish kaq frikë nga mjeshtri shaolin. Kjo skenë familjare e këndelli, e bëri të harronte për pak kohë gjithçka. Sa vari rrobat, u ul bashkë me ta. Ishte ritual i tyre i përditshëm kjo lojë, mbasi merrnin Oltin nga kopshti, dhe sot kishte vërtet nevojë për të. Indriti i hodhi një shikim zhbirues. Por Shaolin po godiste rrufeshëm, kish nisur të bëjë edhe salto, hopa, dhe babi e mami mund të shpëtonin vetëm duke puthur Oltin. Bisedat e zorshme mund të prisnin ca kohë.

Pak më vonë, kur Shao i lodhur kish rënë që të flejë dhe Olti po e mbulonte me një plaf, Indriti u ngrit për të gatuar darkë. Ajo e mori djalin në grykë. Ai ia hodhi doçkat rreth qafës me sytë te lodra, duke bërë tinguj të gërhitjes. Shao tullac ma, tha ai, Shao fle gjumë. Po shpirt, tha ajo. Shao tullac fle gjumë. Aroma e tij kish gjithmonë një efekt mirëbërës, ia shtronte fjetet, e qetësonte. Para sysh iu shfaq sërish kuvoza blu e inkubatorit të akusherisë, ku e kishin mbajtur Oltin një javë rresht se kish lindur para kohe. Për ndonjë arsye, ai inkubator po i fanitej në kujtime e në ëndrra kohëve të fundit. Kish qenë lindje e vështirë, tridhjetegjashtë orë në dhimbje, epidurale e gaz anestetik, mami pa pikë empatie, tmerr. Indriti kish ndenjtur me të gjatë tërë kohës, por ç'dobi ke nga një burrë në sallë akusherie? Që atëhere, xhindosej sa herë që lexonte shkrime rozë këtej e andej për lindje të mrekullueshme. Mbas lindjes, kur kërthirin e vocërr e kishin vendosur në kuvoze, atë e kish pllakosur një si mpirje e mjegullt prej boshllëku gri, pa fund e pa mbarim. Vetëm nënkresat e lagura i tregonin se qante herë mbas here, por ajo vetë s'ndiente asgjë, as vajin e vet. Kishte një si ndjenjë tëhuajësimiti, thujse dikush tjetër e jo ajo kish rënë në dashuri, kish ngelur shtatzënë, ish grindur me prindërit e vet, ish martuar, kish bërë fëmijë, e tashti qante herë pas here, e shtrirë në një sallë të ftohtë akusherie. Indriti nuk dinte si t'i ndihmonte. Vetëm vuante aty, besnikërisht, bashkë me të. Infermieret i thanë më vonë se paskësh pësuar një episod të depresionit post-natal: çfarë nocioni i tmerrshëm. E kish gjetur gradualisht rrugën për të dalë nga mjegullnaja vetëm kur kishin nisur t'ia japin djalin për ta mbajtur në grykë. Përditë e nga pak, ai, kërthiri i vocërr e i pambrojtur që i flinte ndër krahë, i kish dhënë fuqinë për të gjetur e mbledhur veten si njeri. Olti kish qenë, që në krye të herës, bekim i saj i ndritur. Indriti thirri nga kuzhina se darka ishte gati dhe ajo e përqafoi të birin fort, para se të ngruhej me të në grykë.

Darka ishte joceremoniale, si Indriti më. Spageta boloneze me një sallatë të lodhur anash, kjo e dyta më fort për dekor. Por Olti adhuronte spagetat, e ajo dhe Indriti adhuronin Chiantin që shkonte me boloneze. Chianti shkonte edhe me Oltin, sangiovese dhe Olti



## Shqiptar Oseku

# KUNG FU LONA

tregim

kishin të dy natyra hyjnore, plus që Chianti pihet si verë e re, fëmijë ende, ashtu si Olti. Chianti ishte bekimi i dytë atë mbrëmje. Indriti, i dashuri Indriti, qe i treti. Ia hodhi vjedhas një sy, zdapit të gjatë verior që kish shtuar ca peshë, me dredhka bionde që kishin nisur t'i rrallohen, me tuta gri e bluzë V të zezë dy numra më të madhe. Olti kish trashëguar kaçurrelkat e tij. Gjindja ishin tallur gjithmonë se si ishin ata kundërshti diametrale të njëri-tjetrit, ajo vetë ezmere e krehur, imcake e pedante, jugore e veshur me fund e gete edhe në pikë të dimrit. Ai e quante kukull. Zdapi e kukulla, si titull i një filmi romantik. Një si therje dashurie, zije e dhembshurie bashkë e sëmboi rrëmbyeshëm në kraharor, sa s'i pushoi zemra. Po të mos ishte Olti aty, do të shkrihej në vaj. Gëzuar çuna, tha, e ngriti gotën për dollinë e mbrëmjes. Zëri i doli i sforcuar. Olti mbaronte për këto dollitë e darkës, stërpikat mbulonin tryezë e dyshe. Hareja e djalit arriti prapë që të shmangë e të tretë tensionet. Thuaj ç'të duash për spagetat e vona, por pjatat mbaruan. Chianti qe perfekt. Pak i thartë, me nënton herbal, tanine të qarta. Mbrapashije vishnjash nga qershorë plot diell.

Shao tullac u çua ma, tha Olti, e zgjati duart kah lodra e vet që kish ngelur në dyshe. Shao do kungfu. Kjo darkë s'mund të zgjaste më në pafundësi, mendoi ajo. Indriti u ngrit, e nisi të heqë pjatat e almiset. Ajo u zgjat dhe fshiu me nge fytyrën e djalit, që ish pis me salcë. A është i fortë Shao tullac, e pyeti. Po ma, tha ai, Shao është kung fu! A është edhe babi i fortë? Po ma, edhe babi është kung fu. Po mamaja a është e fortë, thirri Indriti nga kuzhina. Pooo, edhe mami është kung fu. Vërtet, e fortë jam vërtet? Ajo nisi ta guduliste. Olti vdiste për gudulisje.

Befas u ndal, sikur iu kujtua diçka. Prit, a jam aq e fortë sa të bëhem edhe unë shaolin? Olti hapi gojën, i stepur nga ideja e papandehur. A mundem? A bëhem dot si Shao? Djali u ngazëllye. Po ma, mundesh, ti je kung fu. Indriti u shfaq në dalje të kuzhinës. Kësaj radhe s'iu shqit dot shikimit të tij. Olti, ta ndihmojmë mamane që të bëhet e fortë si Shao tullac? Olti nisi të duartrokasë. Ta ndihmojmë! Ta ndihmojmë!

Indriti e mori Oltin në krahë, e shkuan që të tre në banjë. Mbi komodinë ishte aparati i qethjes, me tiketën e çmimit ende në të. Ajo e hapi ngadalë, duke vënë re nga një largësi e mendjes se si i dridheshin duart. Iu bë sikur ishin duar të huaja, të dikujt tjetër. Olti po duartrokiste në një tjetër botë. Ajo shikoi veten në pasqyrë, e nisi të qethë flokët. Fillimisht ngurrueshëm. Thuajse kish dyshime. E mandej në mënyrë përherë e më të prerë, pa e zgatur më. Fije flokësh i ranë mbi supe, mbi krahë, bënë shtjella në ajër e ranë ngadalë mbi këmbët e saj, mbi qilim të banjës, mbi dyshe, mbi jetën e saj, mbi këta dy muaj të fundit që kishin qenë ferr i gjallë. Kjo punë duhej bërë patjetër. Pse ta shtysh kot?

Kur hoqi flokët e fundit, në vesh i mbërritën thirrjet gjithë gëzim të Oltit. Ma tashti je e fortë si Shao! Ajo vazhdoi të shikonte veten në pasqyrë, për të mos parë në sy askënd nga ta. Ngriti krahët e tregoi bicepsët. Jam e fortë si Shao tullac, ha!! Mama është kung fu, tha Olti. Edhe zëri i Indritit i erdhi si nga largësi. Mamaja tash është kung fu. Kung fu Lona.

Atë natën ndenji me Oltin më gjatë se herët tjera. Ai mbante në një dorë Shaon dhe prekte me dorën tjetër

vazhdimisht kokën e saj tullace, si për t'u siguruar se ish vërtet si e pokimonit. Ndërsa ajo po rrinte me të birin, Indriti u mbyll gjatë në banjë. Kur doli, flokët e prerë s'ishin më. U shtrinë që të tre bashkë në shtratin e madh, gjersa Oltin e zuri gjumi midis tyre, me një doçkë ende mbi krye të mamasë. Djali merrte frymë qetë, si kerub. Biri im, mendoi ajo, biri im. Befas ndjeu një si lagështi në nënkresë. Kish qarë sërish, si atëhere kur kish lindur Oltin, lotët i kishin rrjedhur pa e vënë re fare. Por i dashuri, i kthjellëti, i miri Indriti, e kish vënë re nga matanë. Zgjati dorën dhe i fshiu sytë. Ajo s'guxoi që ta shohë, nga frika se do të niste nga dënesët.

Kur nis terapinë, pyeti ai. Të hënën, u përgjigj ajo, me sytë tek i biri. Na lanë edhe këtë fundjavë të fundit kështu, që të jemi bashkë. Nuk është e fundit, tha ai, nga ana tjetër e shtratit. Do të jemi bashkë gjatë Lona, ti do ta mposhtësh këtë gjë. A s'e dëgjove Oltin? Ti je tash kung fu Lona.

Nuk tha ai, deshi të përgjigjej, the ti. Por ishte tepër vonë, ajo vetë qe tepër e kapitur, kish pirë tepër verë, thjesht iu duk vonë për gjithçka. S'u përgjigj. Preku lehtë dorën e tij, një si përgjigje memece në errësirë, mandej mbylli sytë. Do të kalojë edhe kjo.

Atë natë, Indriti u çua disa herë për në banjë. Ajo u mundua të flinte, por i doli gjumi disa herë, nga ecejaket e tij, nga ëndrra të këputura në mes. I fanitej sërish salla e akusherisë. Kuvoza blu ishte po aty, inkubatori gjithashtu. Por ajo e Indriti flinin në shtrat spitalor me Oltin në mes, e infermiere pa fytyra hynin në dhomë herë mbas here për të kontrolluar kuvozen bosh.

"Në fillim ne u japim formë ndërtesave tona; por më pas janë ato që na japin formë neve."  
– Winston Churchill

Arkitektura flet me një gjuhë tejet të veçantë e specifike. Ndryshe nga gjuha e letërsisë, muzikës, skulpturës dhe pikurës, e cila kërkon përfshirje të vetëdijshme individuale, që do të thotë: njeriu përkushtohet vullnetarisht për të lexuar një libër apo të shkelë brenda një galerie arti, arkitektura përfshin aspektin konjitiv të pavetëdijshëm individual e kolektiv, dhe është një sistem i organizimit funksional të hapësirës, shpalosjes artistike të formës, simbolizmit dhe imazhit me një ndikim jashtëzakonisht të fuqishëm ndër-breznor. Arkitektura formëson ndërgjegjen e një shoqërie si edhe modelon standardin e së bukurës. Gjithashtu, ajo përcakton rendin shoqëror pasi, siç është tashmë e provuar nga një mori hulumtimesh, ndikon në respektimin apo mos-respektimin e ligjit nga qytetarët, nxit apo privon imagjinatën krijuese, stimulon apo dëmton fertilitetin, stabilizon apo trazon gjendjen mendore dhe ndjesitë emocionale, e madje, përmes fuqisë së simbolizmit dhe formave gjeometrike, shpalos gjininë, përkatësinë, botëkuptimin dhe ideologjinë e një qendre urbane apo edhe sentimentin e një kombi të tërë, për shembull: përmes formave falike dhe kontureve vertikale qiellore qytetet e shtetet transmetojnë mesazhin mashkullor të forcës dhe pushtetit, ndërsa përmes gjeometrisë rrethore e harkore, e linjave horizontale, atë të feminitetit, elegancës, traditës dhe hijeshisë.

Arkitektura është i vetmi medium që formohet prej nesh e më pas formaton tërësisht mënyrën tonë të jetesës. Ajo na formëson vetë ne. Kësisoj, kjo e vërtetë na nxit të mendojmë se çfarë po ndodh me rendin e sotëm arkitekturor në vendin tonë, i cili prej tre dekadash ka mbijetuar pa një rend të mirëfilltë urbanistik e pa një logjikë të shëndoshë konceptuale si promotore e së bukurës dhe artit të kulluar.

Çdo qytet ka atlasin e vet mendor për banorët dhe vizitorët. Ashtu si atlas i yjor ndihmon për t'u orientuar me qiellin, qendrat urbane kanë objekte ikonike që shërbejnë për harmonizimin e jetës qytetare dhe koordinimin e komunitetit. Vitet e fundit është vënë re një shtim i godinave impresionuese në qytetet apo rrethinat e tyre në mbarë vendin dhe arkitektë shqiptarë po flasin me një gjuhë të re e moderne, me projekte e koncepte arkitekturore novative, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Dhe për këtë progres në fushën e arkitekturës duhen duartrokur një mori profesionistësh, të cilët me krijimet e tyre e kanë përmirësuar sentimentin e hapësirave publike duke injektuar art në perceptimin e përbashkët shoqëror.

Në fillim të vitit 2023 u njoftua në media se "Presidenti më i ri i Forumit të Arkitektëve të Ballkanit është një shqiptar dhe ai quhet Indrit Hamiti," i cili disa muaj përpara kishte përfunduar vendin tonë në Bienalen Ballkanike të Arkitekturës, e mbajtur në Beograd, si edhe me studion e tij "Inceptio shpk" u shpall fitues i konkursit ndërkombëtar "Art në Hapësira Publike" për vitin 2022 së bashku me artistin e njohur kinez Liu Ruowang me projektin "Wolves Coming" tashmë të vendosur në hyrje të Koplikut. "Art në Hapësira Publike" përfshin skuadra artistësh dhe arkitektësh vendas e të huaj për të realizuar vepra arti që do të përmirësojnë imazhin e hapësirave publike të shtrira nga veriu e deri në jug të vendit.

Vendlindja e këtij arkitekti është Durrësi, qyteti ndaj të cilit tre dekadat e fundit kanë qenë më të pamëshirshmet urbanistikisht se sa qytetet e tjera të vendit. Ndërtimet e shumta, qoftë ato rezidenciale ashtu edhe ato publike, u bazuan mbi shfrytëzimin në kosto dhe përfitime, pothuajse pa asnjë

## INDRIT HAMITI, ARKITEKTI I GODINAVE IKONIKE!

Dr. Bledar Kurti

gjurmë bukurie apo ngjyrimi artistik. Kësisoj Durrësi u shndërrua në një zurmë urbanistike e rëndë dhe e padëshifrueshme për banorët dhe vizitorët. Plot arna tullash e betoni mbi një rrobë fisnike të bukur të trashëguar nga të parët tanë dhe nga vetë historia.

Përveçse ka krijuar projekte të rëndësishme në mbarë vendin e më gjerë, deri në Francë, për shembull me objektin *Notre Dame de Niege* në komunën Aix-lens-Bains, ai njihet edhe si autori i objekteve ikonike të Durrësit të sotëm, duke e rikthyer bukurinë arkitekturore përmes disa godinave që njihen e konsiderohen si pika referimi për banorët dhe janë tejet tërheqëse për vizitorët e huaj, duke përmbushur atë që arkitekti i njohur Frank Lloyd Wright e përshkruan si "Një ndërtesë nuk është thjesht një vend për të jetuar, por një mënyrë për të jetuar."

Projektet arkitekturore bazohen gjithnjë mbi disa parime të panegociueshme, sado imagjinative të jenë ato, si: kontrasti, lëvizja, proporcioni, ritmi, hierarkia, motifi, simetria, boshti, hapësira, theksimi, qendrueshmëria, përsëritja, bashkimi, bardhësia, radhitja, lidhja, varieteti, harmonia, simbolizmi, efekti urban e shoqëror dhe ndikimi konjitiv mbi individin. Por si në çdo art, dhe arkitektura, përveçse është shkencë e aplikuar është edhe art, e duhet t'i përgjigjet thirrjes epokale të trashëgimisë artistiko-historike dhe të rindezë ndjesitë kombëtare apo lokale të harruara, të pluhurosura, apo edhe ekzistuese e të dukshme.

Thënë thjeshtë: arkitekti ka përgjegjësinë e pasimit të stafetës së dijes së marrë si trashëgimi nga e kaluara, por edhe duhet të nderojë gjënë më të vyer mbi të cilën ai ndërton projektin e tij, që është toka. Çdo

pëllëmbë tokë ka një histori për të treguar. Kësisoj, narrativa qytetare e kombëtare që bart ajo tokë, çmimi i gjakut, i sakrificave dhe i përpjekjeve të mundishme të figurave e mendjeve të lavdishme që paguan për lirinë e atij dheu, që edhe pse në shumë raste mund të jenë pronë private, ajo gjithësesi jeton me ajrin e komunitetit dhe me frymën e identitetit historik.

Shembulli më i mirë i kësaj sinestezie, është *Vila VIII*, një prej godinave të projektuar nga ky arkitekt. Me një fasadë të bardhë e të stilit neogotik *Vila VIII* është dritë në një rrugicë pa diell.

### Vila VIII

Me vendodhje në rrugën "Dom Nikoll Kaçorri" një figurë e shquar e Rilindjes Kombëtare të Shqipërisë, firmëtar i Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë, klerik dhe zëvendëskryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Shqipërisë, pas pavarësisë, objekti shërben si një urë lidhëse midis bulevardit kryesor të qytetit "Rruga Epidamn" dhe zonës së vjetër e patriotike, pas bashkisë, ku kanë qëndruar figura të shquara të historisë së vendit tonë si Ismail Qemali, Fan Noli, etj. E kjo lidhje është arritur mrekullisht nga referimi që autori i projektit i ka bërë stilit të Andrea Aleksit (1425-1505) arkitektit durrsak i cili la gjurmë të rëndësishme në periudhën e rilindjes evropiane, me vepra që gjenden kryesisht në Itali dhe Dalmaci, por i harruar nga historia dhe kritika shqiptare. Ky homazh ndaj Andrea Aleksit e ka rikthyer në vendlindje arkitektin dhe artistin e madh të rilindjes evropiane të shekullit të 15-të.

Te *Vila VIII* dallohet fryma arkitekturore



e *Loggia dei Mercanti ad Ancona* të Aleksit, dhe qysh në ballinë vërehen motifet e *Katedrales së Shën Lorencit* në Trogir, Kroacia e sotme. E gjithë struktura është e stilit dalmato-venecian, me elementë të dukshëm te motifet e përsëritura me elegancë. Edhe interiori i vilës është tejet impresionues përmes ornamenteve, formave dhe ngjyrës së drunjtë, me atmosferë të thellë ndër-shekullore. Një sy i stërvitur kupton që korniza e portës përmban elementë bizantin të Kapelës së Shën Dhimitrit në Patriarkanën e Pejës ndërsa tavanet janë të stilit venecian. Gurët i përkasin zonës së Krujës dhe mjeshtrit gurëvënës janë lokalë. Ka ripërdorim të gurëve të vjetër si edhe risjellje motifi të pllakave ekzistuese të godisë së vjetër. I gjithë projekti shpaloset rrjedhshëm në formë duke përçar bukurin, por edhe duke respektuar parimin arkitekturor të formës në shërbim të funksionit, pasi *Vila VIII* është ndër godinat më të frekuentuara dhe tërheqëse në qytetin e Durrësit.

Ekziston një parim themeltar në artin pamor, një provë e krijuesve por edhe e kritikëve, sipas së cilës, mjafton të formosh një rreth me gishtin e madh dhe atë tregues e më pas shiko në çdo vend të pikurës apo skulpturës, qoftë në qendër apo edhe në cepat fundore të telajos apo te elementët më periferik të statujës, dhe nëse ajo pjesë nuk është art në vetvete atëherë artisti nuk e ka arritur qëllimin e vet. Te *Vila VIII*, çdo fragment, i matur edhe me centimetra, është art dhe plot detaje të cilat flasin vetë më shumë se një mijë fjalë, duke e bërë të gjithë godinën të jetë një plotësi mesazhesh të harmonizuara që bashkohen në një narrativë kuptimplote. Një narrativë sharmante dhe e mrekullueshme që komunikon drejtëpërdrejtë me shikuesin dhe vizitorin.

### Kisha Katolike e Shën Luçisë

Pak hapa larg *Vila VIII* ndodhet Kisha Katolike e Shën Luçisë me kabanore, e vitit 1909, e tjetërsuar në teatër kukullash gjatë regjimit komunist, e restauruar gjatë viteve të fundit nga Hamiti. Përveç rëndësisë fetare që ka kjo kishë, si edhe asaj patriotike, pasi në qelën e saj mbledheshin patriotët durrsakë për të marrë vendime të rëndësishme që çuan në ngritjen e flamurit më 26 nëntor 1912, elementët arkitekturor janë me vlerë e rëndësi të veçantë, kësisoj ruajta e orgjinalitetit dhe e identitetit si një kompleks ipeshkvik, *prezervimi i pjesëve të dëmtuara tërësisht, si për shembull, këmbanorja kërkonte një punë kërkimore shteruese, si edhe gërmime për të nxjerrë në dukje strukturat e nëndheshme. Sot, pas restaurimit të Hamitit, kjo kishë konsiderohet si një prej objekteve më ftuese të qytetit, pasi çdo kalimtar spontan ajo e kthen në vizitor dhe cilindo vizitor e kthen në admirues të kapelës, kolonave e afreskeve, nefeve, tavanit dekorativ, dyshemesë me mozaik, rrëfenjtores, si edhe të tre varreve që gjenden në sakristinë. Sot në këtë kishë dëgjohen lutjet dhe këngët ndaj Hyjit, por edhe muzika klasike apo fjalët poetike e letrare të recituara nga shkrimtarë të ndryshëm pasi ajo është zgjeruar në funksion edhe në një hapësirë komunitare e artistike.*

Së fundmi, kësaj kishë i është shtuar edhe një relief i bazuar mbi një skenat e poliptikut të titulluar *Santa Lucia e storie della sua vita*,



nga Quirizio da Murano, piktor venedikas i shekullit të 15-të, realizuar nga skulptori durrsak Qazim Kërtusha e cila i është dhuruar kishës nga vetë arkitekti Hamiti.

Ky arkitekt i ka kushtuar shumë vëmendje e punë vlerave historike e arkitekture të Durrësit. Në vitin 2014 ai realizoi një video rikonstrukcion virtual të qytetit të fillim shekullit të 20-të, punuar mbi harta dhe fotografi të vjetra. Për herë të parë, objekte si Kisha e Shën Spiridhonit, Xhamia e Bardhë ose Kai Hamn, Konaku, Porta e Jallisë, Fari, etj, u shfaqën në vendndodhjen e tyre origjinale. Ky video rikonstrukcion do mbetet një burim themeltar për hulumtuesit dhe për referencat e historisë së qytetit.

Për Durrësin ka një rëndësi të pandashme edhe shtrirja gjeografike me plazhin e madh ku një seri objektesh, kryesisht hotele e vila, kanë autorësinë e Hamitit. Hoteli *Bleart*, i projektuar me dritare në Alfabetin Mors që transmetojnë mesazhin “*Teza, Sinteza, Antiteza,*” është shembull i një qasje të re arkitekture. Po ashtu janë edhe projektet e tjera të frymës rrethore e ambientale si *Kodra e Kuajve* të Shkëmbi i Kavajës apo *Blerina Farm* në dalje të Tiranës, një projekt i prezantuar në Bienalen e Shkupit dhe të Beogradit.

### Vila Trinity

Vila *Trinity* është intriguese qysh në emërtim. *Trinity*, trinia, koncepti i *tre-në-një*, plotësi përmes treshit, etj, është një koncept që daton sa vetë njeriu. Trinia njihet gjerësisht si referencë hyjnore, si numër i plotësisë dhe i shenjtërisë pasi I referohet Atit, Birit dhe Frymës së Shenjtë, përmendet 467 herë në Bibël, respektohej në kulturën babilonase si qarku i përmbushur i treshes *lindje, jetë* dhe *vdekje*, në Egjiptin e lashtë dhe kulturat e lindjes i referohen si syri i tretë, pra perceptimi, në qytetërimet e hershme evropiane konsiderohej si numri i përsosur i harmonisë, mençurisë dhe mirëkuptimit, ndërsa në mesjetë nisi të shpalosej edhe në formën e stilizuar si “Giglio Fiorentino” zambaku i Firences apo “Fleur-de-lis” si emblema e Francës, e madje edhe në tablotë e pikturave triptike, kryesisht në vendet flamande, më e njohura prej të cilave është *Kopshti i Kënaqësive Tokësore* e Hieronymus Bosch. Studime psiko-linguistike kanë zbuluar se mendja e njeriut kupton e memorizon më mirë nëse dëgjon fjalë që përsëriten tre herë, ndërsa studimet neuro-konjitive kanë arritur në përfundimin se mendja e njeriut i perception më mirë objektet në treshë.

Vila *Trinity* e projektuar nga ky arkitekt, duket si një ilustrim i prekshtëm futurist i këtij koncepti tejet të lashtë. Objekti ndodhet në Tiranë dhe është i konceptuar si një triptik me tre volume të lidhura me një cilindër qendror transparent. Ashtu si ndërtesat gotike të kishave mesjetare projektosheshin për t'u parë nga lart, nga ku dukej forma e kryqit, nga optika qiellore Vila *Trinity* duket si një lule ornamentale e përsosur tri-petalëshe me rrethin që shërben si karpelë e pikë gravitacionale. Cilindri është edhe një atrium për shpërndarjen e lëvizjes në vertikalisht dhe horizontalitet dhe njëkohësisht shërben si kolonë drite, që e përçon atë deri në katin e nëndheshëm me anë të një dyshemeje transparente.

Në pjesën e sipërme të atriumit është vendosur në një kat të ndërmjetëm një kapsulë me funksion studioje e cila shërben edhe si belvedere në analogji me kullën, si element i rëndësishëm i ndërtesave në zonën e Mesdheut e më gjerë.

Planet e pjerrëta trekëndore të godinës shpalosin lojëra volumore si nga përbrenda ashtu edhe nga jashtë. Kjo strukturë arkitekture është një kombinim i formave vëllimore dhe hapësinore, me një ndërveprim artistik. Simbolet grafike



të saj – si rrethi, trekëndëshi, katrori, drejtkëndëshi, etj - kanë simbolikë të lashtë. Karakteristikat figurative të këtyre formave të thjeshta “të përditshme” gjenden në të gjitha gjurmët e hapat e historisë njerëzore ndaj të vëllimet anësore të Vila *Trinity* dallohen lehtësisht piramidat, dhe te cilindri kuptohet pasqyrimi i tempujve të diellit, hënës, perëndeshës së tokës Vesta, me format e tyre të rrumbullakëta, por objekti i krijuar nga Hamiti shpaloset me një frymë të re arkitekture, me një pozicionim sfidues ndaj busullës, e flet një gjuhë ikonike përtej kohës. Ajo integrohet butësisht me panoramën e gjerë, me siluetën pemore dhe me vargmalet e Dajtit, e megjithatë lëshon një britmë therëse ekzistenciale që tërheq vëmendjen e çdo kalimtarit e vizitorit, e mbetet në kujtesë në mënyrë të pashlyeshme, pasi me tre helikat prej guri të lidhura nga cilindri qendror transparent duket sikur e bëjnë godinën të pluskojë në natyrë e në ajër, e të pëshkrojë çdo dimension gjeografik dhe kohor.

### Blerina Farm

Me vendndodhje në fshatin Laknas, në dalje të Tiranës, ky plan kompleks arkitekturor është një dirigjurë e kulluar në harmonizimin e elementëve tradicional, hapësinor dhe konceptual të lidhura thellësisht me mjedisin. Në zemër të kompleksit ndodhet godina qendrore e cila përmban elementë ndërtimi si gurë dhe lëndë druri të zonës lokale. Kjo përzgjedhje materialesh krijon një atmosferë unike që bashkon sharmin e fshatit me ndjesinë e elegancës. Çdo njësi brenda kompleksit shërben si një homazh ndaj trashëgimisë



mishërim i mrekullueshëm i konceptit të harmonizimit të natyrës me arkitekturën. Frymëzuar nga fasadat e njohura të shtëpive të shpendëve, prezantohet një element dinamik në pjesën e jashtme të ndërtesës.

Në thelb, *Blerina Farm* shërben si një testament i qëndrueshëm i mjeshtërisë arkitekture, një manifestim i homazhit kulturor dhe një shkrimi fluide e traditës dhe inovacionit, duke ofruar një udhëtim transcendent në kohë, hapësirë dhe kulturë.

### Arkitektura e Hamitit si art, utopi, empati, moral dhe nevojë sociale

Marrdhënia e individit me qytetin apo shtetin e tij apo të saj është një marrëdhënie dashurore. Pikat e lidhjes janë kujtimet, historia, tradita, atmosfera, dhe pasioni i brendshëm i përkatësisë. Qyteti apo vendbanimi është një utopi racionale dhe një univers moral. Këto tipare janë edhe më të rëndësishme te shqiptarët pasi jemi një popull që lëngojmë dëshpërimisht në kërkim të bukurisë dhe harmonisë, si brenda vetes, si me njëri-tjetrin, ashtu edhe me identitetin tonë kombëtar dhe me mjedisin e përditshëm urban përreth nesh. Urbanisti i njohur Kevin Lynch, ishte pioner i koncepteve të imazherisë dhe lexueshmërisë urbane, referuar deshifrimin të peizazhit urban në nivelin individual. Sipas tij, çdo qytet ka një imazh urban që duhet të jetë i lexueshëm e i deshifrueshëm. Kjo siguron kuptim, empati, moral dhe nevojë sociale. E njëjta gjë vlen edhe për objektet arkitekture. Ato jo vetëm japin mesazhin e shpalosin shpirtin, imagjinatën dhe vizionin e arkitektit por edhe lexohen e deshifrohen në mënyrë individuale. Objektet e arkitektit Indrit Hamiti janë tejet komplekse në projektim, pasi lidhin vertikalisht dhe horizontalisht të gjitha elementet stilistike, historike, artistike, hapësirore e imagjinative, e megjithatë janë qartësisht të zëshme te individit e shërbejnë si pika fokale në urbanistikën e qytetit apo të rrethinave.

Edhe një sy i pastërvitur e dallon motifin e shtëpive beratase apo gjirokastrite te *Blerina Farm*, të ndërthurrur me stilin e sarajeve tradicionale shqiptare e të ngjyrosura me konceptin e oborreve mesdhetare që ndërthurin funksionalitetin dhe vlerësimin gjeometriko-hapësinor. Te *Marinaj Hotel* në Tiranë, ky arkitekt ka ndërthurrur monumentalen me magjepsjen dhe artin si tipare që i shërbejnë rëndësisë së hapësirës urbane. Kjo godinë duket qartazi si e dalë nga tabloja “La Musicienne,” e Georges Braque ose shumë vepra kubiste të Pablo Picasso. Të gjitha projektet e tij kanë zë unik artistik por mbi të gjitha përçojnë ndjenjën e empatisë kolektive dhe nevojës së bashkimit dhe zhvillimit shoqëror, kaq shumë të domosdoshme në kulturën e sotme.

Ekzistojnë tre lloje njerëzish në këtë botë: ata që i bëjnë gjërat të ndodhin, ata që i shikojnë gjërat teksa ndodhin, dhe ata që pyesin veten se çfarë ndodhi. Duke parë projektimet dinamike e *avant-garde* të arkitektit Indrit Hamiti, ambientet ku do donte të banonte e t'i vizitonte çdo njeri, mund të thuhet me siguri se ai hyn te njerëzit që i bënë gjërat të ndodhin me efekt të jashtëzakonshëm në shoqëri, duke frymëzuar brezat e rinj të arkitektëve, duke nxitur dëshirën e përbashkët për të bukurën e duke transformuar jetën urbane.

Njerëzit i injorojnë godinat që injorojnë njerëzit, ndaj godinat ikonike të këtij arkitekti novativ, të ndërtuara anëmbanë Shqipërisë janë të mbushura plot me frymë njerëzore pasi janë projektuar si mesazh, qëllim, e dashuri për njerëzit. Dhe ky ka qenë, është e do të mbetet, qëllimi i artit të vërtetë.

Propozimi i fundit i Ismail Kadaresë në anglisht është një ndërthurje e një loje telefonike dhe hetimit të vendit të krimin. Krimi: një telefonatë e hamendësuar midis udhëheqësit të frikshëm sovjetik Jozef Stalin dhe shkrimtarit të famshëm Boris Pasternak, në të cilën Pasternaku ose mbështet me guxim ose mohon me frikë çdo lidhje me mikun dhe kolegun e tij shkrimtar, poetin e rrezikuar Osip Mandelshtam. Te "Një diktator telefonon", Kadare është në rolin e hulumtuesit themelor i cili analizon dhe u rikthehet pareshtur këtyre tri minutave që në dukje janë shembull i luftës mijërvjeçare midis artistit dhe pushtetit tiran të cilit duhet t'i shërbejë.

Telefonata, e dhënë si gati mitike nga Kadare, ndodh në vitin 1934. Ngjarjet kryesore të jetës së Pasternakut - burgimi i të dashurës dhe muzës së tij Olga Ivinskaya, trajektorja e ankthshme e botimit të *Doktor Zhivagos* dhe përdorimi i tij si armë në Luftën e Ftohtë kulturore - ishin ende në të ardhmen. Kjo pjesë e biografisë së tij është shqyrtuar më parë në letërsi (*Sekretet që kemi mbajtur* nga Lara Prescott) dhe në botim joletrar i Peter Finn-it dhe Petra Couvée-s, *Çështja Zhivago: Kremlini, CIA dhe Beteja mbi një Libër të Ndaluar*, libri i Anna Pasternakut, *Lara: Historia e patreguar e dashurisë dhe frymëzimit për Doktor Zhivagon*), por këndvështrimi i Kadaresë qëndron midis trillimit dhe joletrares. Në botën shqipfolëse, me titullin "Kur sunduesit grinden" u botua në vitin 2018 si ese, ndërsa përkthimi në anglisht tani është rititulluar dhe botuar si vepër artistike. Çfarë është reale dhe çfarë është trillim mbetet pyetje e vazhdueshme e provokuar nga jeta nën totalitarizëm, por ndoshta kalimi gjuhësor nga jo-letrarja te letrarja është më pak çështje metafore dhe më shumë çështje marketingu (jashtë Shqipërisë dhe Kosovës, Kadare është i njohur më shumë si romancier). Por sa më shumë që Kadare flet për Pasternakun, Stalinin dhe Mandelshtamin, aq më shumë duket se flet për veten dhe pozitën e tij brenda regjimit stalinist të Enver Hoxhës në Shqipërinë e tij.

E parë prej kohësh si një çudi e Luftës së Ftohtë, e çuditshme edhe për standardet e komunizmit global dhe më gjerë vetë diktaturave, Shqipëria nën Hoxhën u izolua nga perëndimi kapitalist dhe nga pjesa tjetër e Lindjes socialiste shtetërore. Shqipëria u nda për herë të parë nga Jugosllavia e Titos në vitin 1948 - Tito, ndryshe nga Pasternaku, mëtohej se nuk i kishte zbutur fjalët në letërkëmbimin me Stalinin - më pas u nda nga Bashkimi Sovjetik i Hrushovit në vitin 1961, duke e quajtur tokën e Leninit si jo aq sa duhej marksiste dhe më në fund me Republikën popullore të Kinës, pasi kjo e fundit filloi flirtin e saj të ngadaltë me Shtetet e Bashkuara në vitet 1970. Në fillim të viteve 1980, Shqipëria qëndronte e vetme, një ishull shembullor i marksizëm-leninizmit në një det dekadence borgjeze dhe tradhtie revizioniste.

Regjimi i Hoxhës u karakterizua gjithashtu nga paranoja e tij qesharake, por vdekjeprurëse, e shembullzuar nga vdekja misterioze e krahut të djathtë të Hoxhës, Mehmet Shehut, e letraruar hollësisht nga Kadare në romanin *Pasardhësi* (2003). Në një vend ku edhe i besuari më i afërt i diktatorit nuk ishte i sigurt nga vetëvrasia e diktuar nga shteti, si mund të lulëzonte arti dhe kultura? Si mundi kjo mbretëri eremite e mes - shekullit të nxirrte shkrimtarë dhe poetë? Si i krijoi Kadareja disa nga veprat e tij më të mira - *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* (1963), *Kronikë në gur*, *Pallati i ëndrrave* (1981) ndër të tjera - në kushte të tilla?

Shënime për botimin në anglisht të librit  
"Kur sunduesit grinden"



# Shtëpia e pasqyrave të Kadaresë: ankthet e një titani letrar

Nga Bronwyn Scott-McCharen

Përktheu: Granit Zela

Me Kadarenë, i cili mbetet i njohur në mbarë botën si shkrimtar shqiptar, është thuar se pamundur të ndash jetën nga arti. Si i tillë, kalimi nga jo-letrarja te letrarja në *Një diktator telefonon* që bëhet në përkthim është i dukshëm, i pritshëm, ndoshta edhe i mirëpritur; çdo diskutim i librit do të përfshijë dhe duhet të përfshijë në mënyrë të pashmangshme detaje nga biografia e vetë autorit. Në kohën e Hoxhës, biografia - sfondi klasor i familjes së dikujt si shfrytëzues ose i shfrytëzuar nën rendin e

vjetër - ishte themeli i shoqërisë pa klasa. Një biografi e mirë, së bashku me anëtarësimin në parti, të jepte privilegjin e një pune me status të lartë, një diplomë universitare dhe qëndrimin në kryeqytetin e Tiranës, ndërsa një biografi e keqe nënkuptonte një jetë në zgrip, në mos me burgim të përjetshëm ose dëbimin në mërgim të brendshëm në një zonë të largët. Por si e ndriçon biografia e Kadaresë, si në kuptimin hoxhist ashtu edhe në kuptimin bashkëkohor të fjalës, pikëpamjen e tij për Bashkimin Sovjetik



në vitin 1934? Dhe çfarë na thotë për *Një diktator telefonon*?

Komunizmi i Evropës Qendrore dhe Lindore i shekullit të 20-të prirej të krijonte dhe eksportonte një shkrimtar shumë të veçantë: mashkull në gjini dhe mashkullor në stilin dhe këndvështrimin letrar, statusi i të cilit brenda sistemit nuk ishte kurrë aq i qartë sa do të donte audienca perëndimore. Shkrimtarë që nuk ishin as disidentë të dehur nga moralizmi dhe as zëdhënës kulturor të regjimit. Ky panteon i letrarëve kryesorë të Lindjes me Perde të Hekurt, me biografi të ndërlikuar dhe bibliografi mbresëlënëse, përfshin Milan Kunderën e ndarë nga jeta kohët e fundit, Boris Pasternakun dhe vetë Kadarenë. Kandidatura e përhershme për Nobelin është një tjetër karakteristikë e përbashkët e këtij grupi, megjithëse ndryshe nga Kundera dhe Kadare, Pasternakut në fakt iu dha çmimi i madh në vitin 1958. Megjithatë, fitorja ishte jetëshkurtër, pasi Pasternakut iu bë presion i famshëm nga Bashkimi Sovjetik për të refuzuar çmimin; vetëm në vitin 1989 i biri përfundimisht e pranoi në emër të tij. Duke reflektuar mbi reagimin ndaj Nobelit të Pasternakut nga shokët e tij studentë në Institutin Gorki të Moskës, Kadare shkruan: Shumica e studentëve, teksa ulërinin në kor për të denoncuar çmimin, nuk ëndërronin gjë tjetër veçse ta fitonin atë. Megjithatë, pyetja nuk ishte për ata, por për veten time. A duhet të them se çmimi Nobel nuk më kishte shkuar kurrë në mendje? Sigurisht që jo. E kisha menduar shpesh, por sidomos vite më vonë kur u pëshpërit se unë vetë... mund të isha në atë listë.

Çështja nuk kishte të bënte me ta, por me mua. E njëjta gjë mund të thuhet për *Një diktator telefonon*. Si në botime edhe në jetë, Kadareja është edhe Pasternaku shqiptar edhe Mandelshtami shqiptar, njëkohësisht i mbrojtur dhe i dënuar nga regjimi i Hoxhës. Telefonata tri-minutëshe e Stalinin dhe Pasternakut zbulon një anë të kësaj marrëdhënieje mes këtyre "monarkëve të dyfishtë", siç thotë Kadare, që edhe kundërshton edhe plotëson presionin dhe persekutimin me të cilin u përball Pasternaku gjatë gjithë karrierës së tij. Një telefonatë nga vetë Stalini në vend të një vizite të befasishme nga policia sektrete nënkupton një shkallë të caktuar pranimi - ose të paktën tolerancë - për Pasternakun nga autoritetet sovjetike, një butësi që pesëmbëdhjetë vjet më vonë do të shihte Olga Ivinskaya-n të përfundonte në gulag, në vend të tij. Kadare, po kështu, pranon se ka marrë të paktën një telefonatë lavdëruese nga Hoxha; ndoshta kjo shpjegon idengulitjen e tij prej dekadash pas temës që



Karikaturë nga Arben Mexsi



Arben Mexsi